



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2014

P R I S H T I N Ě , Q E R S H O R 2 0 1 5

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2014

PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetarit të Bordit.....	11
Fjala hyrëse e Guvernatorit.....	13
Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit.....	15
Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2014.....	19
1. Përmbledhje ekzekutive.....	21
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik.....	23
2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor.....	23
3. Ekonomia e Kosovës.....	25
3.1. Sektori real.....	25
3.2. Sektori fiskal.....	27
3.3. Sektori i jashtëm.....	28
3.4. Sektori financiar.....	29
3.5. Projektionet makroekonomike për vitin 2015.....	43
4. Mbikëqyrja e Institucioneve Financiare.....	44
4.1. Korniza rregullative dhe procesi i licencimit.....	44
4.2. Licencimi.....	49
4.3. Mbikëqyrja bankare.....	55
4.4. Mbikëqyrja e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare.....	58
4.5. Parandalimi i pastrimit të parave.....	59
4.6. Mbikëqyrja e sigurimeve.....	60
4.7. Mbikëqyrja e pensioneve.....	63
5. Shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun.....	65
5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme.....	65
5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive.....	68
5.3. Sistemi i Pagesave.....	71
5.4. Menaxhimi i Mjeteve.....	76
5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës.....	80
5.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar.....	83
5.7. Aktivitetet në fushën e statistikave.....	83
6. Zhvillimet e Brendshme.....	86
6.1. Auditimi i Brendshëm.....	86
6.2. Burimet njerëzore.....	87
6.3. Aktiviteti ligjor.....	87
6.4. Teknologjia Informative.....	87
6.5. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut.....	87

7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar	89
7.1. Marrëveshjet, promovimi dhe përfaqësimi ndërkombëtar.....	89
7.2. Asistenca teknike	90
8. Pasqyrat financiare të BQK-së	92
9. Shtojca Statistikore.....	128
10. Referencat.....	145

LISTA E SHKURTESAVE

AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përmirësimin e Ambjentit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimve
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio)
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (angl. Consumer Price Index)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DSFAE	Departamenti për Stabilitet Financiar dhe Analiza Ekonomike
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
ECB	Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank)
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeastern Europe)
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
EUROSTAT	General Directorate of European Statistics
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GBR	Great Britain Pound
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman (angl. Herfindahl-Hirschman Index)
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (angl. Imports Price Index)
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës

KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMB	Komercijalna Banka
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MF	Ministria e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTPL	Sigurimi i Auto-Përgjegjësisë
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NPL	Kreditë Joperformuese (angl. Non Performing Loans)
OJSHEF	Organizata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PCB	Procredit Bank
PNI	Pozicioni Ndërkombëtare i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përçindje
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (angl. Producer Price Index)
PPP	Pariteti i Fuqisë Blerëse (angl. Purchasing Power Parity)
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RBK	Raiffeisen Bank of Kosovo
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate)
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity)
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Riskut (angl. Risk Weighted Assets)
SEBQ	Sistemi Evropian i Bankave Qendrore
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
SEPA	Zona e Përdorimit të Euros si Njësi e Vetme Pagese (angl. Single Euro Payment Area)
SFR	Swiss Franc
SRK	Sistemi i Regjistrimit të Kontabilitetit
SWIFT	Society for Worldwide International Financial Telecommunication
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (angl. United Nations Mission in Kosovo)
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
USD	United States Dollar
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale

LISTA E FIGURAVE

1.	Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e refinancimit të ECB-së -----	23
2.	Çmimi i naftës "brent crude"-----	24
3.	Rritja reale e PBB-së-----	25
4.	Norma e inflacionit-----	25
5.	Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve -----	26
6.	Indekset e çmimeve të konsumit-----	26
7.	Regjistrimi i bizneseve-----	26
8.	Eksportet, importet dhe bilanci tregtar-----	28
9.	Remitancat -----	28
10.	Struktura e investimeve të huaja direkte-----	29
11.	Struktura e aseteve të sistemit financiar -----	29
12.	Asetet e jashtme neto sipas institucioneve-----	30
13.	HHI për asete kredi dhe depozita-----	31
14.	Struktura e aseteve të sektorit bankar-----	31
15.	Rritja vjetore e aseteve të sektorit bankar -----	31
16.	Struktura e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm-----	32
17.	Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve-----	32
18.	Kreditë sipas sektorëve ekonomik-----	33
19.	Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik -----	33
20.	Struktura e maturimit të kredive-----	33
21.	Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale -----	34
22.	Struktura e depozitave në bankat komerciale -----	34
23.	Struktura e depozitave sipas maturimit-----	35
24.	Struktura e depozitave të afatizuara -----	35
25.	Mesatarja e normave të interesit-----	36
26.	Normat mesatare të interesit në kredi për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -----	36
27.	Norma mesatare e interesit në depozita për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -----	36
28.	Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve-----	37
29.	Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve-----	37
30.	Struktura e shpenzimeve -----	37
31.	Treguesit e profitabilitetit-----	38
32.	Kreditë joperformuese dhe provizionet për humbjet nga kreditë -----	38
33.	Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit-----	38
34.	Asetet e kompanive të sigurimit-----	39
35.	Primet e kontraktuara dhe dëmet e paguara -----	39
36.	Asetet e institucioneve mikrofinanciare -----	39
37.	Struktura e aseteve të IMF-ve -----	40

38.	Normat e interesit në kreditë e IMF-ve -----	40
39.	Raporti shpenzime/të hyra-----	41
40.	Struktura e aseteve të FKPK-së -----	42
41.	Struktura e aseteve të FSKP-së -----	42
42.	Numri i ankesave ndaj institucioneve financiare -----	54
43.	Furnizimi me para të gatshme-----	65
44.	Pranimi i parave të gatshme -----	65
45.	Furnizimi me kartmonedha euro sipas denominimeve -----	65
46.	Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve -----	65
47.	Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve-----	66
48.	Monedha euro të pranuar sipas denominimeve-----	66
49.	Eksporti i parave të gatshme -----	66
50.	Importi i parave të gatshme -----	66
51.	Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi -----	67
52.	Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi -----	67
53.	Furnizimi me kartëmonedha euro-----	67
54.	Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim-----	67
55.	Paratë euro të falsifikuara të konfiskuara në nivel të Kosovës -----	67
56.	Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse -----	69
57.	Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse-----	69
58.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	69
59.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	69
60.	Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së -----	70
61.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	70
62.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	71
63.	Numri i transaksioneve në SEKN -----	71
64.	Vlera e transaksioneve në SEKN -----	72
65.	Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN -----	72
66.	Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN -----	72
67.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre -----	72
68.	Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre -----	74
69.	Numri i kartelave të debitit sipas llojit të tyre -----	74
70.	Numri i kartelave të kreditit sipas llojit të tyre -----	75
71.	Numri i terminalëve ATM-----	75
72.	Numri i terminalëve POS-----	75
73.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	75
74.	Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	76
75.	Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së -----	77
76.	Shuma e përgjithshme e mjeteve në portfolio e investimeve -----	77

77.	Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit	77
78.	Norma e kthimit të investimeve në portolio dhe rreziku gjatë vitit 2012	78
79.	Horizonti kohor mesatar i shprehur në ditë deri në maturim për dy kategoritë e plasmaneve	78
80.	Struktura e Letrave me Vlerë sipas afatit të maturimit	79
81.	Struktura e pjesmarrësve në ankande	79
82.	Normat mesatare vjetore të kthimit sipas afatit të maturimit	80
83.	Ankandet e bonove të Thesarit dhe obligacioneve qeveritare	80
84.	Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së	80
85.	Numri i kredive të reja	81
86.	Struktura e kredive sipas klasifikimit	81
87.	Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve	81
88.	Struktura e kredive joperformuese	82
89.	Numri i i kërkesave për raporte kreditore	82
90.	Struktura sipas edukimit	87

LISTA E TABELAVE

1.	Numri i institucioneve financiare	30
2.	Struktura e asetëve në sektorin bankar	32
3.	Struktura e detyrimeve të sistemit bankar	34
4.	Numri i ankesave sipas institucioneve	54
5.	Numri i ankesave sipas viteve	55
6.	Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave	68
7.	Niveli i depozitave sipas llojeve të llogarive	72
8.	Niveli i depozitave të klientëve kryesor	70
9.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara dërguara në SEKN	73
10.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e pranuar/hyrëse në SEKN	73
11.	Numri i llogarive	76
12.	Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave	76
13.	Rangimi i vendeve të rajonit bazuar në indikatorin "Getting Card"	82

Fjala e Kryetarit të Bordit

Kam kënaqësinë e veçantë që në emër të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës përmes Raportit Vjetor 2014 t'iu prezantoj tendencat e ecurive kryesore ekonomike gjatë vitit 2014 në sektorin real, fiskal, financiar, të jashtëm si dhe aktivitetet e BQK-së drejt nxitjes dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar përmes funksionit të saj rregullativ dhe mbikqyrës. BQK e konsideron publikimin e Raportit të saj Vjetor më shumë se sa përmbushje të një detyrimi ligjor dhe institucional, si një element thelbësor të transparencës i cili kontribuon në avancimin e komunikimit me lexuesit, dhe i cili ndihmon në edukimin financiar të publikut. Raporti Vjetor i vitit 2014, për nga struktura përmbajtësore veqohet me spektër të gjerë të informacionit të prezantuar me një shtrirje të gjerë në sektorët ekonomik dhe financiar, që janë konsideruar se janë të rëndësishme për lexuesit e të gjitha profileve, si publik i gjerë, pjesëmarrës në tregun financiar, bartës i interesit në pronësi apo investitor potencial.

Në vitin 2014 u pasurua më tej sistemi qeverisës i institucionit me një qasje profesionale dhe gjithëpërfshirëse të të gjithë mekanizmave qeverisës dhe llogaridhënës, duke ruajtur rolin e integruar të licencimit, mbikqyrjes dhe rregullimit të mbarë sektorit financiar brenda ombrellës së BQK-së si dhe duke forcuar kapacitetet e saj kërkimore, analizuese dhe parashikuese.

Fokus i veçantë në angazhimet e Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në vitin 2014, ka qenë avancimi i kuadrit rregullativ, duke aprovuar 11 rregullore të reja, në fushën e rregullimit të sektorit financiar, atë të pagesave dhe të bankingut qendror. E gjithë kjo ka rezultuar në rritje të performancës së institucioneve financiare duke rritur cilësinë e menaxhimit të rreziqeve, ruajtur mjaftueshmërinë e kapitalit, likuiditetit, cilësinë e përgjithshme të portofolit kreditorë, të investimeve dhe mbi të gjitha duke racionalizuar koston e ndërmjetësimit financiar. Avancimi i kuadrit rregullativ ka pasur për synim mbështetjen e integritimit evropian dhe përafrimin ligjor e rregullativ me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian në domenin e bankingut qendrorë.

Bordi i BQK-së ka pasuruar edhe më tej kornizën e përgjithshme qeverisëse të BQK-së duke e mbështetur atë me një buxhet të përshtatshëm, duke mbikëqyruar vazhdueshëm ekzekutimin e tij, si dhe duke ruajtur pavarësinë financiare dhe operative të BQK-së. Avancimi i kuadrit rregullativ intern në BQK-së ka qenë i orientuar drejt krijimit të një mjedisi efektiv të kontrollit të brendshëm, në përmbushjen e përgjegjësive për sa i përket menaxhimit të rrezikut të institucionit, kontrolleve, qeverisjes, besueshmërisë së raportimit financiar të BQK-së, rritjes së analizave, statistikave, dhe publikimeve tjera në funksion të një transparence më gjithëpërfshirëse.

Ruajtja e stabilitetit financiar në vend, ka qenë dhe mbetet, pika më e rëndësishme në agjendën e aktiviteteve të BQK-së. Sektori financiar i Kosovës, në vitin 2014, ka reflektuar rritje dhe qëndrueshmëri. Qëndrueshmëria e sektorit financiar është e evidente në të gjithë komponentët përbërës të kapitalit, profitabilitetit, likuiditetit dhe cilësisë së menaxhimit të rreziqeve. Gjithësejt asetet arriten në nivel prej 4.54 miliardë euro, apo rritje vjetore prej 7.4 përqind. Kjo rritje reflekton kryesisht rritjen e asetëve të bankave komerciale që përkon me një rritje vjetore prej 4.2 përqind, përderisa gjithësejt asetet në sektorin pensional u rritën për 19.1 përqind. Sektori bankar ka vazhduar të zvogëlojë normat e interesit si në kredi ashtu edhe në depozita. Norma mesatare e interesit gjatë muajit dhjetor 2014 ishte 9.2 përqind, ndërsa mesatarja e interesit në depozita ishte 1.1 përqind. Sektori bankar vazhdon të ketë cilësi të mirë të portofolit kreditor me një normë të kredive joperformuese prej 8.3 përqind në dhjetor 2014, e cila ishte më e ultë se sa norma prej 8.7 përqind në dhjetor 2013.

Theksoj se tërë aktiviteti dinamik përgjatë vitit 2014, që shprehet përmes këtij raporti, është refleksion i përkushtimit të lartë të punonjësve të BQK-së dhe organeve të saja vendimmarrëse në drejtim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë së BQK-së.

Do të doja ta mbyllja fjalën time në këtë fjalë hyrëse të raportit vjetor të BQK-së për vitin 2014, duke shprehur mirënjohje të thellë, për të gjitha institucionet financiare për përkrahjen dhe kontributin e tyre të vazhdueshëm dhënë BQK-së, si Thesari Amerikan, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Fondi Zhvillimor Gjerman, Banka Qendrore Evropiane dhe Bankat Qendrore të Rajonit.

Prof. Dr. Bedri Peci



Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore
të Republikës së Kosovës

Fjala hyrëse e Guvernatorit

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2014 shënoi normë pozitive të rritjes, përdersa vazhdoi të reflektojë nivel të kënaqshëm të stabilitetit në rrafshin fiskal, financiar dhe atë të çmimeve. Rritja e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik gjatë këtij viti u bazua kryesisht në rritjen e konsumit privat, i cili është përkrahur nga rritja e pagave për shërbyesit civil, rrjedha e qëndrueshme e remitencave si dhe përsheptimi i rritjes së kreditimit nga sektori bankar. Kosova vazhdon të ketë nivel mjaft të ulët të deficitit buxhetor dhe borxhit publik, përdersa çmimet ndoqën zhvillimet e tregjeve globale duke u karakterizuar me normë mjaft të ulët të inflacionit. Sistemi financiar i Kosovës vazhdoi të zgjerojë aktivitetin dhe të ruaj nivelin e lartë të qëndrueshmërisë, duke i shërbyer kështu zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik të vendit. Kjo, mes tjerash, paraqet punën e suksesshme të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) në përmbushjen e objektivave të saj që dalin nga Ligji për Bankën Qendrore.

Gjatë vitit 2014, për herë të parë në dy vitet e fundit, sektori bankar përsheptoi ritmin e rritjes së kredive duke rritur kështu financimin për ekonominë vendore. Përsheptimi i rritjes së kreditimit reflekton lehtësimin e standardeve dhe kushteve kreditore nga ana e bankave dhe, në të njëjtën kohë, rritjen e kërkesës për kredi. Sidoqoftë, në raport me madhësinë e ekonomisë, kreditimi bankar në Kosovë vazhdon të jetë më i ulët krahasuar me vendet tjera të rajonit, duke qëndruar në rreth 35 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto. Ky tregues mund të shërbejë si indikacion se ka hapsirë të mëtutjeshme për zgjerimin e kreditimit bankar në vend, që do të nënkuptonte edhe përmirësim të mëtejshëm të mundësisë së individëve dhe bizneseve për të rritur qasjen në financa.

Përveç rritjes së vazhdueshme të kreditimit, sektori bankar i Kosovës ka vazhduar të përmirësojë edhe kushtet e financimit, duke zvogëluar kështu në masë të konsiderueshme normën e interesit në kredi. Në vitin 2014, norma e interesit në kredi për herë të parë që nga fillimi i funksionimit të sektorit bankar të Kosovës zbriti në nivel njëshifror, duke i'u ofruar kështu nivelit të normave të interesit të aplikuara në vendet tjera të rajonit. Sektori bankar i Kosovës ka vazhduar të ruaj nivel të lartë të qëndrueshmërisë, duke mbajtur shkallë të lartë të kapitalizimit, cilësi të mirë të portofolit të kredive dhe pozicion të fortë të likuiditetit.

Performancë të mirë gjatë kësaj periudhe kanë treguar edhe sektorët e tjerë të sistemit financiar të Kosovës. Për dallim nga vitet paraprake, kur kishim zvogëlim të kreditimit nga institucionet mikrofinanciare, në vitin 2014 ky sektor shënoi rritje të kreditimit, duke rikuperuar kështu rolin e tij në mbështetje të ekonomisë së vendit. Zhvillime të favorshme karakterizuan edhe sektorin e sigurimeve dhe sektorin pensional, të cilët regjistruan rritje të aktivitetit dhe përmirësim të performancës financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2014 ishte mjaft aktive në zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës ligjore të sistemit financiar. Në këtë aspekt, vëmendje e veçantë i është kushtuar avancimit të legjislacionit sekondar përmes nxjerrjes së rregulloreve të reja dhe plotësimit të atyre ekzistuese. Përveç rregulloreve që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar, BQK ka trajtuar për së afërmi edhe çështjen e mbrojtjes së të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare, duke avancuar kornizën rregullative si dhe duke trajtuar me efikasitet të lartë ankesat e konsumatorëve financiar. Avancime të rëndësishme janë bërë edhe në fushat tjera të operimit, përmes së cilave BQK në vazhdimësi po i ofrohet arritjes së standardeve të bankave qendrore të vendeve të zhvilluara. Për të projektuar sa më qartë shtegun e zhvillimit të mëtutjeshëm, në vitin 2014 BQK përpiloi Planin Strategjik për periudhën 2015-2019, i cili përcakton qartë objektivat zhvillimore dhe planin e detajuar për avancimin e mëtejshëm të çdo fushe të veprimtarisë së BQK-së gjatë periudhës pesëvjeçare që fillon në vitin 2015.

Për vitin 2015, BQK mbetet e përkushtuar të zbatojë planin e veprimit që rrjedhë nga plani strategjik dhe, në këtë mënyrë, të vazhdojë së avancuari kapacitetet e saj për realizimin e objektivave që dalin nga Ligji për Bankën Qendrore. Bazat e shëndosha të sistemit financiar dhe prospektet pozitive për zhvillimet në këtë sistem dhe në ekonominë në përgjithësi, na bëjnë që të presim se viti 2015 do të karakterizohet me aktivitet të shtuar ekonomik dhe me shkallë të kënaqshme të stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik.

Bedri Hamza



Guvernator i Bankës Qendrore
të Republikës së Kosovës

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit

Bordi i Bankës Qendrore

Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore kanë qenë të orientuara në përmbushjen e suksesshme të kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat është informuar dhe është diskutuar lidhur me ecuritë e përgjithshme të sistemit financiar në Kosovë. Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur gjithsej 14 mbledhje.

Bordi ka shqyrtuar dhe ka aprovuar nxjerrjen dhe plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar sipas kërkesave dhe propozimeve të cilat janë propozuar nga Bordi Ekzekutiv si në vazhdim:

- Rregulloren mbi raportet dhe informatat që kërkohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
- Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime
- Rregulloren për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave
- Rregulloren për Licencimin e Kompanive të Sigurimit dhe Degëve të huaja të Sigurimit
- Rregulloren mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave
- Rregulloren mbi pagesën e pensioneve individuale të kursyera
- Rregulloren për licencimin e menaxhuesve të mjeteve për mjetet e Fondeve pensionale
- Rregulloren mbi Sistemin e Numrave Standard të Llogarive Bankare
- Rregulloren për Pagesat Ndërkombëtare
- Rregulloren për Licencimin e Fondeve Plotësuese Pensionale të Punëdhënësve
- Rregulloren për Licencimin e Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale

Bordi i Bankës Qendrore ka miratuar gjithashtu:

- Planin e punës për Departamentin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2014
- Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së;
- Statutin e Auditimit të Brendshëm të BQK-së
- Kodin e Etikës të Auditorit të Brendshëm të BQK-së
- Raportin vjetor të BQK-së për vitin 2013
- Pasqyrat Financiare të BQK-së për vitin 2013 dhe Raportin e Auditorit të jashtëm
- Raportin vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2013
- Raportet periodike të Departamentit të Auditimit të Brendshëm
- Statutin e Komitetit të Auditimit

Buxhetin e BQK-së për vitin 2015

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me ligj, Bordi i Bankës Qendrore me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

- Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin për BQK-në;
- Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të përmbushjes së stabilitetit financiar; dhe
- Çështje të tjera që janë në kompetencën e Bordit të Bankës Qendrore.

Bordi i Bankës Qendrore ka ushtruar edhe detyra tjera të cilat kanë qenë në harmonim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Më 31 dhjetor 2014 Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Bedri Peci, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore (nga 29 maj 2014)

Bedri Hamza, Guvernator dhe anëtar i Bordit të Bankës Qendrore

Fatmir Plakiqi, anëtar i Bordit të Bankës Qendrore (Drejtor i Thesarit të MF)

Më 31 dhjetor 2014, kanë qenë vakante dy pozita të anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore.

Bordi Ekzekutiv

Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 34 pika 3 Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori (kryesues i Bordit Ekzekutiv) dhe zëvendësguvernatorët.

Gjatë vitit 2014, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ka mbajtur 28 takime.

Më 31 dhjetor 2014, Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Bedri Hamza (Guvernator/Kryesues i Bordit Ekzekutiv), Lulzim Ismajli (Zëvendësguvernator për Operacione Bankare), Fatmir Gashi (Zëvendësguvernator për Funksiione të Përgjithshme) dhe Fehmi Mehmeti (Zëvendësguvernator për Mbikëqyrje Financiare).

Komiteti i Auditimit

Në kuadër të qeverisjes transparente në strukturën organizative të BQK-së, në pajtim me nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Kosovës dhe Statutin e Komitetit të Auditimit, vepron edhe Komiteti i Auditimit.

Objektivat e Komitetit të Auditimit janë që të asistojnë Bordin e Bankës Qendrore në lidhje me përmbushjen e përgjegjësisë në relacion me veprimin e auditimit të brendshëm, kontrollave të brendshme, etikën afariste dhe qeverisjen transparente si dhe për raportin financiar të BQK- së.

Komiteti Auditimit emërohet nga Bordi i Bankës Qendrore dhe përbëhet prej tre anëtarëve (dy anëtarë joekzekutiv të zgjedhur nga radhët e Bordit të Bankës Qendrore dhe një anëtar-ekspert i jashtëm nga fusha e kontabilitetit dhe auditimit).

Më 31 dhjetor të vitit 2014, Komiteti Auditimit përbëhej nga këta anëtarë:

Prof. Dr. Bedri Peci, Kryetar i Komitetit të Auditimit; dhe

Prof. Dr. Arben Dermaku, Anëtar i Jashtëm.


Pozita e një anëtari është e zbrazët për shkak të mungesës së dy anëtarëve joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore.

Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2014 ka mbajtur gjithësej 13 takime. Në takimet e Komitetit janë trajtuar çështje të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me përgatitjen e Statutit të Komitetit, shqyrtimin dhe aprovimin e Statutit të Auditimit të Brendshëm dhe Kodin e Etikës, shqyrtimin dhe propozimin për Auditorin e Jashtëm për periudhën 2014-2016 si dhe shqyrtimin dhe aprovimin e Raportit të Auditorit të Jashtëm për 2013.

Komiteti ka trajtuar çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me funksionimin e auditimit të brendshëm brenda BQK-së. Ndër çështjet kryesore me të cilat është marrë janë:

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit Vjetor të Punës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2014, i cili më pas është aprovuar nga Bordi i Bankës Qendrore; dhe
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Vjetor për vitin 2013 dhe raporteve tremujore të Auditimit të Brendshëm për vitin 2014 të dërguar nga Shefi i Auditimit të Brendshëm, të cilat më pas janë aprovuar nga Bordi i Bankës Qendrore.

Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2014



1. Përmbledhje ekzekutive

Aktiviteti ekonomik në eurozonë u rikuperua gjatë vitit 2014, kryesisht si rezultat i përmirësimit të besueshmërisë së konsumatorëve dhe përmirësimit gradual të kushteve në tregun e punës. Për dallim nga vendet e Eurozonës, vendet në Ballkanin Perëndimor u karakterizuan me ritëm më të ngadalshëm të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2014 kundrejt vitit paraprak.

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2014, sipas vlerësimeve të BQK-së, u karakterizua me rritje prej 2.7 përqind. Rritja për vitin 2014 bazohet kryesisht në vlerësimet për rritjen e konsumit, ndërsa investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë kontribuar negativisht. Konsumi i përgjithshëm ka pasur rritje të konsiderueshme që është nxitur nga remitencat, kreditë konsumuese të sektorit bankar, pagat e sektorit publik, etj. Në anën tjetër, investimet e përgjithshme janë karakterizuar me rënie për shkak të rënies së investimeve publike, ndërkohë që edhe investimet e huaja direkte kanë shënuar rënie. Po ashtu, bilanci tregtar gjatë vitit 2014 është karakterizuar me thellim të deficitit tregtar. Përkundër rritjes së eksportit të mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2014, niveli shumë më i lartë i importit ka bërë që neto eksportet të kontribuojnë negativisht në rritjen ekonomike. Viti 2014 ishte i favorshëm edhe sa i përket çmimeve të produkteve të importuara të cilat çuan në një normë të ulët të inflacionit. Norma e inflacionit në vitin 2014 ishte 0.4 përqind krahasuar me normën prej 1.8 përqind të shënuar në vitin 2013. Me zhvillime pozitive u karakterizua edhe sektori fiskal, pasi që të hyrat primare buxhetore shënuan rritje, përderisa shpenzimet primare buxhetore shënuan nivel të ngjashëm me vitin paraprak.

Vlera e gjithsej aseteve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.5 miliardë euro në vitin 2014, që paraqet një rritje vjetore prej 7.4 përqind. Rritja e aseteve të gjithsej sistemit financiar gjatë vitit 2014 kryesisht reflekton rritjen e aseteve të fondeve pensionale dhe bankave komerciale. Në vitin 2014, asetet e sektorit bankar shënuan rritje vjetore prej 4.2 përqind, duke arritur vlerën prej 3.2 miliardë euro. Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga bankat komerciale në vend u karakterizua me një rritje vjetore prej 4.2 përqind, duke arritur në 1.9 miliardë euro. Në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej depozitave arriti në 2.5 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.6 përqind. Në vitin 2014, treguesit kryesor të profitabilitetit të sektorit bankar u përmirësuan si rezultat i rritjes së theksuar të profitit. Gjithashtu, gjatë vitit 2014, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit arriti nivelin prej 17.8 përqind (16.7 përqind në dhjetor 2013), përderisa ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor u zvogëluar, shprehur përmes rënies së pjesëmarrjes së kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në 8.3 përqind (8.7 përqind në vitin 2013). Edhe pozita e likuiditetit të sektorit bankar gjatë vitit 2014 mbeti në nivel të kënaqshëm.

Sa i përket tregut të sigurimeve, numri dhe struktura e kompanive të sigurimit mbetën të pandryshuara nga viti i kaluar. Në vitin 2014, gjithsej asetet e kompanive të sigurimit që operojnë në vend arritën vlerën prej 140.4 milionë euro, një rritje vjetore prej 5.8 përqind. Sektori i sigurimeve gjatë vitit 2014 u karakterizua me humbje neto prej 318.8 mijë euro, që është dukshëm më e ulët në krahasim me vitin paraprak kur ky sektor kishte regjistruar humbje në vlerë prej 754.6 mijë euro. Zvogëlimi i humbjeve u mundësua kryesisht nga menaxhimi më i mirë i shpenzimeve.

Sektori mikrofinanciar në vitin 2014 ndërpreu trendin e tkurrjes së aktivitetit të ndjekur gjatë viteve të fundit. Vlera e gjithsej aseteve të IMF-ve arriti në 112.9 milionë euro në vitin 2014, një nivel i ngjashëm me vitin paraprak, përderisa vlera e gjithsej kredive shënoi një rritje vjetore prej 2.9 përqind dhe arriti në 74.4 milionë euro. IMF-të mbyllën vitin 2014 me fitim prej 1.3 milionë euro, krahasuar me humbjen prej 324.4 mijë euro në vitin paraprak.

Fondet pensionale u karakterizuan me një performancë pozitive në vitin 2014, me ç'rast gjithsej asetet e sistemit pensional shënuan rritje vjetore prej 19.1 përqind dhe arritën vlerën prej 1.1 miliardë euro. Gjatë vitit 2014, TKPK u karakterizua me rritje të çmimit të aksionit dhe rritje të kthimit nga investimet. Fondi i Kursimeve Pensionale gjatë vitit 2014 ka realizuar kthim pozitiv nga investimi i mjeteve në vlerë prej 66.7 milionë euro, përderisa edhe çmimi i aksionit ka qenë më i lartë në vitin 2014 krahasuar me vitin paraprak prej 6.5 përqind.

Gjatë vitit 2014, janë finalizuar dhe proceduar për shqyrtim dhe miratim pranë institucioneve kompetente dy projektligje me rëndësi të veçantë për sektorin financiar në Kosovë, të cilat përfshijnë projektligjin për sigurimet e përgjithshme dhe projektligjin për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Në funksion të një sistemi bankar stabil, gjatë vitit 2014 janë bërë ekzaminimet e bankave komerciale konform planit të paraparë. Konsistent me praktikën ndërkombëtare në fushën përkatëse, vëmendje e veçantë i është kushtuar rrezikut kreditor, likuiditetit, tregut dhe rreziqeve tjera, bazuar në qasjen e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. BQK-ja edhe gjatë vitit 2014 është angazhuar në adaptimin e praktikave më të mira të mbikëqyrjes së sigurimeve, duke u bazuar në parimet e Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrësve të Sigurimeve dhe mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, duke kontribuar kështu në rritjen e transparencës së operacioneve të siguruesve ndaj publikut. Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar, gjatë vitit 2014 janë bërë ekzaminimet e fondeve pensionale konform planit të paraparë.

Ngjashëm me vitet paraprake, edhe gjatë vitit 2014, BQK siguroi një ofertë kualitative dhe kuantitative të parave të gatshme për sektorin bankar për të mundësuar kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Në fund të vitit 2013 dhe në fillim të vitit 2014 u bë përmbyllja e të gjitha fazave të planifikuara të projektit të SWIFT-it dhe të gjitha pagesat ndërkombëtare u realizuan përmes rrjetit SWIFT duke shkurtuar kështu kohën dhe duke rritur efikasitetin e procesimit të pagesave. Gjatë vitit 2014, është shënuar rritje në vëllim dhe vlerë e transaksioneve në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN). Edhe Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK) ka shënuar progres gjatë vitit 2014, ku janë regjistruar 314 përdorues të ri, si rrjedhojë e kërkesave të paraqitura nga institucionet anëtare, përderisa hulumtimi mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditor arriti në 639,100 hulumtime.

Gjatë vitit 2014, është funksionalizuar zhvillimi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në vitin 2014, të gjitha mjetet nën menaxhimin e BQK-së janë investuar në instrumente financiare që hyjnë në kategorinë e instrumenteve të sigurta dhe likuide. BQK realizoi kthime pozitive nga investimet, me ç'rast kthimet ishin më të favorshme nga investimet në letrat me vlerë krahasuar me investimet në depozita bankare.

BQK-ja ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me institucione të rëndësishme ndërkombëtare duke përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankën Botërore (BB) si dhe me institucione të tjera financiare ndërkombëtare si Banka Qendrore Evropiane (BQE), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), bankat qendrore të vendeve të rajonit dhe me institucione tjera me të cilat BQK-ja ka marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë vitit 2014, ka nisur zyrtarisht programi i bashkëpunimit teknik të BQE-së me bankat qendrore të regjionit të Ballkanit Perëndimor, i cili ka për qëllim përgatitjen e bankave qendrore të vendeve të regjionit për inkuadrim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Programi pritet të forcojë kapacitetin institucional të BQK-së duke identifikuar kërkesat ligjore, organizative dhe të resurseve për të arritur përputhshmërinë me kornizën standarde institucionale dhe operacionale të SEBQ dhe BQE. Ngjarje tjetër e rëndësishme në fushën e marrëdhënieve me jashtë është edhe fillimi i programit të edukimit financiar dhe shënimi i Javës Ndërkombëtare të Parasë.

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Aktiviteti ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2014 është rikuperuar gradualisht, me përmirësimin e besueshmërisë së konsumatorëve dhe përmirësimin gradual të kushteve në tregun e punës. Megjithatë, rritja e aktivitetit ekonomik mbeti e koncentruar në ekonominë qendrore të eurozonës, gjegjësisht në Gjermani, përderisa pjesë të ndryshme të eurozonës vazhduan të karakterizohen me rritje të dobët gjegjësisht rënie ekonomike. Në vitin 2014, rritja ekonomike në eurozonë arriti në 0.9 përqind, kundrejt rënies ekonomike të shënuar në vitin paraprak prej 0.5 përqind. Megjithëse vazhdon të konsiderohet si një rritje ekonomike modeste, sinjalet për përforsim të mëtejme të aktivitetit në rajonin e eurozonës mbështeten kryesisht në rënien e mëtejme të çmimeve të naftës, gjë që pritet të reflektohet në rritje të besueshmërisë së konsumatorëve dhe rrjedhimisht në rritjen e shpenzimeve. Gjithashtu, rritja e aktivitetit ekonomik pritet të mbështetet nga rritja e vazhdueshme e eksporteve të eurozonës si rezultat i zhvlerësimit të euros si dhe nga fillimi i implementimit të programit të lehtësimit sasior nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Për vitin 2015, FMN parashikon një rritje ekonomike prej 1.5 përqind në eurozonë.

Sipas BQE-së, shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë në vitin 2014 zbriti në 0.4 përqind, nga 1.4 përqind sa ishte në vitin 2013. Rënia e vazhdueshme e çmimeve në tregjet ndërkombëtare ka rezultuar në një deflacion prej 0.6 përqind përkatësisht 0.3 përqind në janar dhe shkurt të vitit 2015.


Për të ju kundërvënë rrezikut të ngritur të deflacionit në eurozonë dhe për të rimëkëmbur ekonominë ende të brishtë në rajon, BQE ka vendosur që të lansojë programin e lehtësimit sasior që nga muaji mars i vitit 2015. Përmes këtij programi, BQE pritet të realizojë blerjen e letrave me vlerë të qeverive evropiane dhe agjencive e institucioneve evropiane në tregjet dytësore. Blerja e letrave me vlerë në sektorin publik dhe privat, në kuadër të këtij programi, pritet të arrijë vlerën prej 60 miliard euro në muaj.

Programi i lehtësimit sasior në shkallë të gjerë pritet të zgjatë deri në shtator të vitit 2016.

Në vitin 2014, BQE mbajti të pandryshuar normën bazë të rifinancimit, gjë që ndikoi në një rritje të lehtë të normave 1 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në vitin 2014, norma mesatare 1 mujore e Euribor është ngritur në mesatarisht 0.023 përqind nga 0.018 përqind në shtator 2014 (figura 1). Në anën tjetër, norma Euribor për periudhën 12 mujore ka shënuar rënie në mesatarisht 0.33 përqind në vitin 2014, nga mesatarja prej 0.36 përqind në shtator 2014.

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor gjatë vitit 2014 përgjithësisht vlerësohet të ketë qenë më e dobët krahasuar me vitin 2013. Rritja mesatare ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2014 vlerësohet të ketë qenë rreth 1.6 përqind. Rritjen më të lartë ekonomike në rajon shënuan Maqedonia (3.8 përqind) dhe Kosova (2.7 përqind), përderisa Serbia ishte vendi i vetëm në rajon që u karakterizua me rënie ekonomike në vitin 2014.

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së




Burimi: Euribor (2014) dhe ECB (2014)

Ngjashëm me vendet e eurozonës, vendet e Ballkanit Perëndimor janë karakterizuar me shkallë më të ulët të inflacionit, gjegjësisht deflacion në vitin 2014 kundrejt vitit paraprak. Norma mesatare e inflacionit në vendet e rajonit në vitin 2014 ishte 1.6 përqind. Serbia dhe Shqipëria u karakterizuan me shkallë më të lartë të inflacionit prej 1.7 përkatësisht 1.6 përqind, përderisa Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia u karakterizuan me deflacion.

Çmimet e naftës (brentcrude)¹ në vitin 2014 shënuan rënie mesatare vjetore prej rreth 9.1 përqind. Me rënie të çmimit gjatë vitit 2014 u karakterizua edhe ari. Në vitin 2014, çmimi i arit ishte për rreth 10.3 përqind më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Mallrat ushqimore në nivel global gjatë vitit 2014 janë karakterizuar me rënie të çmimeve krahasuar me vitin paraprak. Gjatë vitit 2014, krahasuar me vitin paraprak, mallrat ushqimore kishin një çmim më të ulët prej mesatarisht 3.7 përqind, përderisa drithërat kishin çmim më të ulët për mesatarisht 12.5 përqind.

Norma e këmbimit të euros kundrejt valutave kryesore është zhvlerësuar në vitin 2014. Ndaj sterlinës britanike dhe ndaj frankës zvicerane, euro ka shënuar rënie mesatare vjetore prej 5.0 përkatësisht 1.3 përqind, ndërsa ndaj dollarit amerikan vlera e euros është vlerësuar lehtësisht për 0.1 përqind. Sa i përket valutave të vendeve të rajonit, në vitin 2014, euro është vlerësuar kundrejt dinarit serb, kunës kroate dhe denarit maqedon për mesatarisht 3.7, 0.7 përkatësisht 0.1 përqind, përderisa është zhvlerësuar kundrejt lekut shqiptar për 0.2 përqind.

Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: World Bank, EIA (2014), dhe kalkulimet të BQK-së

¹ 'BrentCrude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Sektori real


Norma e rritjes ekonomike për vitin 2014, sipas vlerësimeve të BQK-së ishte 2.7 përqind, që është më e ulët se sa parashikimi fillestar prej 3.0 përqind. Ky revidim ka rezultuar pas përfshirjes së efektit të migrimit që karakterizoi fundin e vitit 2014. Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë për vitin 2014 bazohet kryesisht në rritjen e konsumit, përderisa investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë kontribuar negativisht.

Të dhënat për vitin 2014 paraqesin një rritje më të lartë të konsumit, i cili është ndikuar nga rritja e kredive konsumuese, rritja e pagave dhe mëditjeve të sektorit publik, pastaj subvencioneve dhe transfereve, etj. Gjithashtu, rritjen e konsumit e kanë përkrahur edhe remitencat, të cilat në vitin 2014 shënuan një rritje vjetore prej 11.7 përqind. Në anën tjetër, investimet publike në vitin 2014 kanë shënuar rënie prej 22.3 përqind, ndërkohë që edhe investimet e huaja direkte (IHD) janë karakterizuar me një rënie prej 46.0 përqind në të njëjtën periudhë. Rënia e investimeve publike ka bërë që rritja reale e PBB-së të jetë më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Aktiviteti i sektorit privat është përkrahur edhe nga kreditë e sistemit bankar të cilat në fund të vitit 2014 kanë përshpejtuar ritmin e rritjes.

Inflacioni në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: ConsumerPriceIndex: CPI), gjatë vitit 2014 është karakterizuar me normë dukshëm më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2014 ishte 0.4 përqind krahasuar me mesataren prej 1.8 përqind në vitin paraprak (figura 4).


Gjatë vitit 2014, komponentët e CPI-së si pijet alkoolike dhe duhani shënuan rritje për 4.3 përqind, energjia 4.1 përqind dhe veshmbathja 2.8 përqind. Ndërsa, rënie me e theksuar e çmimeve u evidentua tek shërbimet e arsimit për 7.0 përqind dhe shërbimet e transportit për 2.2 përqind (figura 5). Rënia e çmimit të shërbimeve arsimore i atribuohet vendimit të qeverisë për zbritjen e pagesës për 50 përqind për studentët e universitetit publik, ndërsa rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit i atribuohet rënies së çmimit të derivateve të naftës. Çmimet e produkteve të ushqimit dhe pijeve joalkoolike shënuan rënie prej 0.2 përqind. Pavarësisht që shënuan rënie të lehtë të çmimit, produktet e ushqimit paraqesin një rënie ndërkategoritë më me ndikim në zvogëlimin e inflacionit duke qenë se përfaqësojnë rreth 37.8 përqind të shportës së konsumatorit kosovar.

Figura 3. Rritja reale e PBB-së, në përqindje



* Të dhënat për vitin 2014 dhe 2015 paraqesin vlerësimet dhe parashikimet e BQK-së
Burimi: ASK (2015)

Figura 4. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2015)

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Kjo tregohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit me CPI-në (figura 6). Në vitin 2014, çmimet e importit u karakterizuan me rënie mesatare në 0.6 përqind, nga rritja e lehtë prej 0.2 përqind që shënuan në vitin paraprak. Në kuadër të çmimeve të importit, çmimet e produkteve bimore dhe këpucëve kanë shënuar rritjen më të lartë me 24.1 përkatësisht 17.0 përqind, pasuar nga metalet bazë me 12.1 përqind, ndërsa çmimet e tekstilit kanë shënuar rënien më të lartë me 24.0 përqind pasuar nga artikujt ushqimor me 7.2 përqind.

Indeksi i çmimeve të prodhimit në vitin 2014 shënoi rritje mesatare vjetore prej 1.6 përqind ndërkohë që në periudhën e njëjtë të vitit paraprak kishte shënuar rritje prej 2.4 përqind. Rritja e çmimeve ishte më e theksuar tek prodhimi i produkteve kimike me 39.9 përqind dhe prodhimi i drurit dhe i produkteve të tij me 12.9 përqind. Në anën tjetër, rënia e çmimeve të prodhimit më së shumti u shënuan te nxjerrja e xeheve me 15.2 përqind, pasuar nga rënia e çmimeve të prodhimit të pajisjeve elektrike me 17.1 përqind, prodhimt të letrës dhe produkteve prej letrës me 10.2 përqind, etj.


Gjatë vitit 2014 u regjistruan 9,404 ndërmarrje të reja apo 16 ndërmarrje më pak se sa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 1,671 biznese apo 163 biznese më shumë se sa në vitin paraprak (figura 7). Struktura e ndërmarrjeve të reja të regjistruara është e ngjashme me vitin e kaluar ku dominojnë tregtia, hoteleria, prodhimi, ndërtimtaria dhe bujqësia. Krahasuar me vitin paraprak, është shënuar rënie e numrit të bizneseve të regjistruara në tregun e patundshmërive (198 ndërmarrje) dhe ndërtimtarisë (140 ndërmarrje), ndërsa hoteleria dhe prodhimi kanë shënuar rritje për 123 përkatësisht 106 ndërmarrje të regjistruara. Rritje kanë shënuar edhe ndërmarrjet e regjistruara në sektorin e tregtisë.

Figura 5. Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2015)

Figura 6. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2015)

Figura 7. Regjistrimi i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2015)

3.2. Sektori fiskal

Të hyrat primare buxhetore² në vitin 2014 arritën vlerën bruto prej 1.37 miliardë euro. Nëse përjashtohen 33.5 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, atëherë të hyrat primare buxhetore shënojnë vlerën neto prej 1.33 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.5 përqind. Ky nivel më i lartë i të hyrave është arritur përkundër faktit se në vitin 2014 janë arkëtuar vetëm 15.0 milionë euro të hyra në formë të dividendës nga ndërmarrjet publike, ndërkohë që në vitin e kaluar ishin realizuar 43.0 milionë euro të hyra nga dividenda. Nëse përjashtohen të hyrat nga dividenda, atëherë të hyrat buxhetore në vitin 2014 shënuan rritje prej 3.8 përqind. Shpenzimet primare buxhetore³ në vitin 2014 arritën vlerën prej 1.5 miliardë euro që paraqet nivel të ngjashëm me vitin paraprak. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej rreth 131 milionë euro, krahasuar me deficitin primar prej rreth 150 milionë euro të shënuar në vitin 2013.

Ekzekutimi i shpenzimeve të planifikuara në vitin 2014 ishte pothuajse i njëjtë krahasuar me vitin paraprak (91 përqind e planit vjetor). Pagat dhe mëditjet si dhe subvencionet dhe transferet shënuan nivel më të mirë të realizimit krahasuar me planin, ndërsa shpenzimet kapitale u realizuan në masën prej 80.0 përqind të planit krahasuar me shkallën prej 84.4 përqind të realizimit në vitin paraprak. Në anën tjetër, realizimi i të hyrave buxhetore arriti nivelin prej 90.9 përqind të planit për vitin 2014, që është për 1.4 pikë përqindje më i ulët se sa shkalla e realizimit në vitin paraprak.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje e të hyrave të mbledhura në kufi të cilat shënuan rritje vjetore prej 4.0 përqind dhe arritën vlerën bruto prej 871.0 milionë euro. Të hyrat neto të cilat përjashtojnë kthimet e doganës prej 2.4 milionë euro arritën vlerën prej 868.6 milionë euro. Të hyrat e mbledhura nga tatimet vendore arritën vlerën bruto prej 303.7 milionë euro. Nëse përjashtohen kthimet e administratës tatimore prej 31.1 milionë euro atëherë të hyrat neto nga tatimet vendore shënuan rritje prej 0.7 përqind dhe arritën vlerën prej 272.6 milionë euro. Të hyrat jo-tatimore arritën vlerën prej 46.7 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 8.0 përqind. Gjithashtu, të hyrat vetanake (niveli qendror dhe lokal) shënuan rritje për 3.4 përqind duke arritur vlerën prej 98.2 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve, pagat e mëditjet dhe subvencionet e transferet shënuan rritje krahasuar me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet kapitale dhe mallrat e shërbimet shënuan rënie. Investimet kapitale, të cilat në vitin 2014 përfaqësuan rreth 28.1 përqind të gjithëj shpenzimeve, shënuan vlerën prej 411.4 milionë euro që paraqet rënie prej 22.3 përqind. Zvogëlimi i investimeve kapitale i adresohet përfundimit të projektit të autostradës R-7, e cila në vitin paraprak ka qenë në implementim e sipër. Përveç përfundimit të projektit të autostradës R-7, vonesa në krijimin e institucioneve pas zgjedhjeve të qershorit 2014 ndikuan në shtyrjen e realizimit të një pjese të projekteve kapitale. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rënie për 3.6 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 205.8 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje prej 17.3 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 485.2 milionë euro, që është kryesisht rezultat i vendimit të qeverisë për ngritjen e pagave. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 15.4 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 361.2 milionë euro.

Borxhi publik, në fund të vitit 2014, ka arritur në 582.9 milionë euro nga 476.3 milionë euro sa ishte në vitin paraprak, ndërsa si përqindje e PBB-së ka arritur në 10.6 përqind nga 9.1 përqind sa ishte në vitin paraprak. Në vitin 2014, borxhi publik shënoi një rritje prej 22.4 përqind kundrejt borxhit në vitin paraprak. Në vitin 2014, borxhi i brendshëm i qeverisë arriti vlerën

² Në kuadër të të hyrave primare nuk janë përfshirë të hyrat nga huamarrjet, pranimet nga grantet e përgjithshme të donatorëve dhe pranimet e depozitave.

³ Në kuadër të shpenzimeve primare nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe kthimet nga fondet e depozitave.

256.5 milion euro, një rritje vjetore prej 62.2 përqind. Në të njëjtën periudhë, borxhi i jashtëm i qeverisë shënoi një rritje vjetore prej 0.8 përqind, duke arritur vlerën prej 326.4 milion euro.

3.3. Sektori i jashtëm

Pozicioni i bilancit të pagesave në Kosovë është përkeqësuar në vitin 2014 krahasuar me vitin paraprak. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 419.8 milionë euro në vitin 2014, krahasuar me vlerën prej 304.7 milionë euro sa ishte në vitin paraprak. Ky përkeqësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse kryesisht i atribuohet rritjes së deficitit në mallra për 2.8 përqind, përderisa bilanci i llogarisë së tregtisë në shërbime u karakterizua me rritje prej 4.4 përqind. Në vitin 2014, llogaria e të ardhurave parësore dhe llogaria e të ardhurave dytësore u karakterizuan me zvogëlim të bilancit pozitiv (12.5 përkatësisht 4.4 përqind).


Deficiti i llogarisë së mallrave arriti vlerën prej 2.2 miliard euro deri në vitin 2014, që paraqet një rritje prej 2.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 8). Gjithsej eksportet në vitin 2014 arritën vlerën 324.6 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 10.5 përqind. Rritja e eksporteve gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së vlerës së eksporteve të metaleve bazë, si kategoria me peshën më të lartë në kuadër të gjithsej eksporteve të vendit, rritjes së eksporteve të makinerive dhe pajisjeve elektrike si dhe eksporteve të produkteve ushqimore.

Vlera e gjithsej importeve në Kosovë, në vitin 2014, arriti në 2.5 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.6 përqind. Në kuadër të gjithsej importeve, me rritje u karakterizuan kategoria e makinerive dhe pajisjeve elektrike, kategoria e mjeteve të transportit, si dhe importet e produkteve bimore, përderisa me rënie të vlerës së importuar u karakterizuan produktet minerale dhe produktet ushqimore. Si rezultat i rritjes më të shpejtë të vlerës së eksporteve në vitin 2014, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u rrit në 12.8 përqind, nga 12.0 përqind sa ishte në vitin 2013.

Tregtia në shërbime u karakterizua me rritje të bilancit pozitiv në vitin 2014. Bilanci i shërbimeve arriti vlerën prej 336.1 milionë euro në vitin 2014 (312.2 milionë euro në vitin 2013), përderisa rritjen më të madhe në kuadër të bilancit të shërbimeve e shënoi kategoria kryesore, gjegjësisht kategoria e udhëtimit.


Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të hyrat nga kompenzimi i punonjësve, gjegjësisht të hyrat nga të ardhurat e punonjësve Kosovar

Figura 8. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2015)

Figura 9. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

jashtë vendit. Të hyrat nga kompenzimi i punonjësve shënuan rënie vjetore prej 7.4 përqind në vitin 2014, duke zbritur në 206.5 milionë euro.

Remitencat, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, vazhdojnë të kontribuojë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Vlera e gjithsej remitencave të pranuar në vend në vitin 2014 arriti në 693.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.7 përqind (figura 9).

Komponentë tjetër e rëndësishme në kuadër të bilancit të pagesave është edhe kategoria e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Bilanci i IHD-ve në vitin 2014 ishte 123.9 milionë euro, që paraqet një rënie të konsiderueshme krahasuar me vlerën prej 250.2 milionë euro në vitin paraprak. Kjo rënie e IHD-ve mund t'i atribuohet kryesisht shitjes së aksioneve të disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë tek rezidentët kosovar si dhe shpërndarjes së superdividendës⁴ së disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë (figura 10).

3.4. Sektori financiar


3.4.1 Karakteristikat e përgjithshme

Në vitin 2014, vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.5 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.4 përqind (10.5 përqind në vitin 2013).

Rritja e asetëve të sistemit financiar gjatë vitit 2014 i atribuohet kryesisht rritjes së asetëve të fondeve pensionale dhe bankave komerciale. Sektori i sigurimeve, pavarësisht zgjerimit të aktivitetit, kishte kontribut të vogël në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit financiar. Ndërsa, asetet e sektorit mikrofinanciar dhe ndihmësve financiar kishin kontribut pothuajse neutral në rritjen e gjithsej asetëve.


Struktura e asetëve të sistemit financiar në vitin 2014 mbetet e dominuar nga asetet e sektorit bankar, pasuar nga fondet pensionale (figura 11). Sa i përket numrit të institucioneve, gjatë vitit 2014, tregut financiar në vend i është shtuar një degë e bankës së huaj (të cilës i është dhënë licenca preliminare), një institucion mikrofinanciar i themeluar me kapital të huaj, si dhe një kompani e sigurimeve me kapital të huaj (të cilës i është dhënë licenca preliminare). Po ashtu, gjatë vitit 2014 numri i ndihmësve financiar u rrit në 42 (39 në vitin 2013) (tabela 1).

Figura 10. Strukturat e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 11. Struktura e asetëve të sistemit financiar, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

⁴ Me superdividendënënkuptohetdividenda e cilështëmë e lartë se safitimet e kompanisëpërperiudhënpërkatëse. Shpërndarja e superdividendësndikonëzvogëlimin e kapitalitëhuajaksionar, gjë e cilaparaqetzvogëlimitë IHD-ve.

Tabela 1. Numri i institucioneve financiare⁵


Përshkrimi	2011	2012	2013	2014
Bankat komerciale	8	9	9	10
Kompanitë e sigurimeve	13	13	13	14
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	34	38	39	42
Institucionet mikrofinanciare	20	17	17	18

Burimi: BQK (2015)

Një pjesë e konsiderueshme e aseteve të sistemit financiar vazhdon të investohet në tregjet e jashtme. Vlera e Aseteve të Jashtme Neto (AJN) në vitin 2014 arriti në 1.4 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 32.4 përqind (6.4 përqind në vitin 2013) (figura 12).⁶ Pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej AJN-të vazhdojnë ta kenë fondet pensionale (rreth 75 përqind të AJN-ve), ndërsa pjesa e mbetur përbëhet kryesisht nga AJN-të e sektorit bankar.

Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm në vitin 2014 arritën vlerën 1.6 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të konsiderueshme prej 26.8 përqind⁷ (7.9 përqind në vitin 2013). Në të njëjtën periudhë, detyrimet ndaj sektorit të jashtëm arritën vlerën prej 243.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 2.4 përqind (15.4 përqind në vitin 2013). Rritja për vetëm 2.4 përqind e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm erdhi si rezultat i ngadalësimit të rritjes së kredive të marra nga jashtë prej bankave komerciale, të cilat shënuan rritje vjetore prej 6.5 përqind në vitin 2014 (63.9 përqind në vitin 2013).

Figura 12. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Ekspozimi i sistemit financiar ndaj sektorit të jashtëm vazhdon të mbetet më i theksuar në kuadër të aseteve, krahas ekspozimit më të ulët në kuadër të detyrimeve. Më konkretisht, asetet e jashtme ndaj gjithsej aseteve të sistemit financiar në vitin 2014 kishin një pjesëmarrje prej 35.5 përqind, ndërsa detyrimet e jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sistemit financiar kishin një pjesëmarrje prej 5.4 përqind. Sa i përket sektorit bankar, asetet e jashtme përfaqësojnë 18.3 përqind të gjithsej aseteve, përderisa vetëm 5.7 përqind e detyrimeve janë ndaj sektorit të jashtëm.

3.4.2 Sektori bankar

Struktura e sektorit bankar në Kosovë në vitin 2014 ishte e ngjashme me periudhat paraprake. Sipas pronësisë, struktura e sektorit bankar vazhdoi të dominohet nga bankat me kapital të huaj, asetet e të cilave përbëjnë 90.4 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, ndërsa pjesa e mbetur menaxhohet nga bankat me kapital vendor.

⁵ Numri i institucioneve financiare paraqet numrin e institucioneve që janë të licencuara të operojnë në tregun e Kosovës.

⁶ Në këtë kontekst, sektori financiar nuk përfshinë Bankën Qendrore.

⁷ Në kuadër të kërkesave të sistemit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm nuk është përfshirë kategoria "paraja e gatshme". Kjo për faktin se euro në statistikën monetare dhe financiare konsiderohet si aset i jashtëm (kërkesa ndaj jorezidentëve), mirëpo këto mjete janë në Kosovë.

Shkalla e koncentrimin të tregut në sektorin bankar ka vazhduar trendin rënës në asete dhe kredi, kurse ka shënuar rritje të lehtë në depozita. Rënia e koncentrimin në asete ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të aseteve të bankave më të vogla krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të aseteve të tri bankave më të mëdha. Ndërkaq, rritja e koncentrimin në depozita erdhi si pasojë e rritjes më të lartë të depozitave në tri bankat më të mëdha krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të nivelit të depozitave në bankat tjera (figura 12).

3.4.2.1 Bilanci i gjendjes i sistemit bankar


Asetet

Vlera e aseteve të sektorit bankar të Kosovës në vitin 2014 arriti në 3.2 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.2 përqind. Gjatë vitit 2014, ritmi i rritjes së aktivitetit bankar është ngadalësuar krahasuar me rritjen e përshpejtuar të shënuar në vitin e mëparshëm (figura 14). Kjo ishte rezultat i ngadalësimit të rritjes së depozitave të cilat edhe janë burimi kryesor i financimit të bankave.

Struktura e aseteve të sektorit bankar, në përgjithësi, mbetet e ngjashme me vitin paraprak. Në vitin 2014, vërehet të ketë pasur një rritje të lehtë të pjesëmarrjes së bilancit me bankat tjera, letrave me vlerë, dhe kredive, ndërsa paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rënie të pjesëmarrjes në gjithsej asetet. Kjo lëvizje tregon për zhvendosje të mjeteve të bankave drejt kategorive që sjellin interes dhe përmirësojnë performancën financiare të bankave.


Investimet në letra me vlerë arritën shumën prej 383.8 milionë euro në vitin 2014, duke shënuar rritje vjetore prej 8.3 përqind, një rritje dukshëm më e ulët se sa rritja prej 38.2 përqind e vitit paraprak.

Figura 13. HHI për asete, kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2015)

Figura 14. Struktura e aseteve të sektorit bankar, në milion euro



Burimi: BQK (2015)


Figura 15. Rritja vjetore e aseteve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2015)

Në kuadër të investimeve në letra me vlerë, bankat u orientuan më shumë në investime në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës, investime këto që rritën pjesëmarrjen e tyre në gjithsej portfolion e investimeve në 50.2 përqind (28.2 përqind në vitin 2013) (figura 16). Ndërsa, investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja kanë shënuar zvogëlim të pjesëmarrjes në gjithsej portfolion e investimeve, e cila në vitin 2014 qëndroi në 49.7 përqind. Kjo zhvendosje drejt investimeve në vend ishte kryesisht rezultat i normave më të larta të interesit në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës krahasuar me vitin paraprak, si dhe normave të ulëta të interesit që mbretëruan në tregjet e letrave me vlerë të qeverive të huaja.

Figura 16. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Tabela 2. Struktura e aseteve të sektorin bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2011		Dhjetor 2012		Dhjetor 2013		Dhjetor 2014	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	331.5	12.5%	425.7	15.0%	463.3	15.1%	447.1	14.0%
Bilanci me bankat komerciale	329.5	12.4%	287.9	10.2%	339.9	11.1%	390.8	12.3%
Letrat me vlerë	202.0	7.6%	256.6	9.1%	354.5	11.6%	383.8	12.0%
Kreditë bruto	1,698.1	64.1%	1,763.4	62.3%	1,805.8	59.0%	1,882.3	59.1%
Asetet Fikse	47.4	1.8%	57.7	2.0%	55.5	1.8%	53.7	1.7%
Asetet Tjera	41.3	1.6%	38.1	1.7%	40.3	1.4%	28.8	0.9%
Gjithsej	2,649.7	100%	2,829.3	100%	3,059.3	100%	3,186.6	100%

Burimi: BQK (2015)


Kreditë

Pas dy viteve të ngadalësimit të rritjes së kredive, viti 2014 u karakterizua me përshpejtim të rritjes së kreditimit nga sektori bankar. Gjithsej kreditë arritën vlerën prej 1.88 miliardë euro në vitin 2014, që paraqet rritje vjetore prej 4.2 përqind (2.4 përqind në vitin 2013) (figura 17).

Në kuadër të gjithsej kredive aktive, kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje të përshpejtuar prej 12.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 3.9 përqind në vitin 2013. Sidoqoftë, përshpejtimi i rritjes nuk vërehet edhe te kreditë për ndërmarrjet të cilat u karakterizuan me një normë të ngjashme të rritjes me vitin paraprak. Kreditë për ndërmarrje shënuan rritje prej 2.1 përqind në vitin 2014 (2.0 përqind në vitin 2013).

Përshpejtimi i rritjes së kredive për ekonomitë familjare mund të jetë nxitur nga rritja e pagave për shërbyesit civil, gjë e cila mund të ketë rritur kërkesën për kredi si dhe ka përforcuar kapacitetin e kthimit të kësaj kategorie të huamarrësve. Poashtu, gjatë kësaj periudhe bankat

Figura 17. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

raportuan edhe lehtësim të standardeve kreditore, të cilat u reflektuan pëshpejtimin e rritjes së kreditimit. Sa i përket ndërmarrjeve, bankat raportuan rritje të kërkesës për kredi, mirëpo jo dhe aq nga ndërmarrjet e mëdha.⁸ Kjo ndikoi që pavarësisht lehtësimit të standardeve kreditore për ndërmarrje, rritja e kreditimit për këtë kategori të mbetet e ngjashme me vitin e kaluar.

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarisë ekonomike vazhdon të dominohet nga kreditë e destinuar për tregti me pjesëmarrje prej 53.4 përqind, pasuar nga prodhimitaria me 12.0 përqind dhe ndërtimtarisë me 8.4 përqind. Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë çasje më të ulët në financimin bankar, me pjesëmarrje prej 4.0 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet (figura 19).


Në vitin 2014, rritjen e më të lartë prej 13.1 përqind e shënuan kreditë për sektorin e prodhimitarisë, pasuar nga kreditë për bujqësi dhe tregti që shënuan rritje prej 7.9 përqind përkatësisht 3.6 përqind. Ndërsa, kreditë për sektorin e ndërtimtarisë shënuan rënie vjetore prej 12.2 përqind (figura 19).

Sipas maturitetit, struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë me afat maturimi 'mbi 1 deri në 5 vite' (figura 19). Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2014 vihet re një rritje e pjesëmarrjes së kredive afatgjata 'mbi 5 vite' dhe rënie e pjesëmarrjes së kredive me afat më të shkurtër maturimi 'deri në 1 vit'.

Detyrimet


Në vitin 2014, struktura e detyrimeve të sektorit bankar vazhdoi të dominohet nga depozitat, që paraqesin burimin kryesor të financimit për bankat komerciale në Kosovë. Kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e gjithsej detyrimeve mbetet ajo e mjeteve vetanake të cilat në vitin 2014 arritën vlerën 323.1 milionë euro, duke shënuar rritjen më të theksuar në kuadër të strukturës së detyrimeve prej 16.3 përqind (2.6 përqind në vitin 2013)

Figura 18. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (dhjetor 2014)




Burimi: BQK (2015)

Figura 19. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2015)

Figura 20. Struktura e maturimit të kredive



Burimi: BQK (2015)

⁸ Bazuar në rezultatet e anketës për kreditimin bankar për vitin 2014.

(tabela 3). Rritja më e theksuar e mjeteve vetanake gjatë kësaj periudhe kryesisht është rezultat i rritjes së profitit të sektorit bankar gjatë vitit 2014.

Tabela 3. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2011		Dhjetor 2012		Dhjetor 2013		Dhjetor 2014	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	40.0	1.5%	6.0	0.2%	16.5	0.5%	31.8	1.0%
Depozitat	2,104.0	79.4%	2,279.1	80.6%	2,449.0	80.1%	2,537.0	79.6%
Huatë tjera	30.4	1.1%	18.9	0.7%	13.4	0.4%	14.9	0.5%
Detyrimet tjera	191.5	7.2%	223.6	7.9%	246.2	8.0%	232.7	7.3%
Borxhi i ndërvarur	31.0	1.2%	31.0	1.1%	56.3	1.8%	47.3	1.5%
Mjetet vetanake	252.8	9.5%	270.7	9.6%	277.8	9.1%	323.1	10.1%
Gjithsej detyrimet	2,649.7	100%	2,829.3	100%	3,059.3	100%	3,186.8	100%

Burimi: BQK (2014)


Në kuadër të strukturës së detyrimeve, borxhi i ndërvarur ka arritur vlerën 47.3 milionë në vitin 2014, duke shënuar rënie prej 16.0 përqind, krahasuar me rritjen e theksuar në vitin paraprak prej 81.5 përqind. Zvogëlimi i vlerës së borxhit të ndërvarur reflekton kryesisht përforsimin e nivelit të kapitalizimit të sektorit bankar në vitin 2014, përderisa rritja e theksuar borxhit të ndërvarur në vitin paraprak iu atribuua nevojës së bankave për të siguruar kapitalin e mjaftueshëm për të qenë në pajtueshmëri me ndryshimin e rregullores së BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit.

Depozitat

Gjithsej depozitat në sektorin bankar në vitin 2014 arritën vlerën 2.53 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.6 përqind (figura 22). Një faktor i rëndësishëm që mund të ketë ndikuar ngadalësimin e rritjes së depozitave është rënia e normës së interesit në depozita në vitin 2014. Poashtu, ndikim në ngadalësimin e rritjes së depozitave mund të ketë pasur edhe rritja e emigrimit nga Kosova në muajt e fundit të vitit 2014.


Struktura e depozitave në sektorin bankar vazhdon të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 72.8 përqind të gjithsej depozitave. Kategoria e dytë për nga pesha në gjithsej depozitat është ajo e depozitave të ndërmarrjeve që kanë një pjesëmarrje prej 22.1 përqind (figura 22).

Figura 21. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 22. Struktura e depozitave në bankat komerciale



Burimi: BQK (2015)

Në vitin 2014, depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 4.1 përqind (8.2 përqind në vitin 2013), ndërsa depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore prej vetëm 0.7 përqind (5.4 përqind në vitin 2013). Kategoria e depozitave tjera (depozitat e jo-rezidentëve, organizatave jo-qeveritare etj.) shënoi rritje vjetore prej 9.4 përqind në vitin 2014 (6.2 përqind në vitin 2013).


Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime gjatë vitit 2014 në krahasim me vitin paraprak kur struktura e depozitave dominohej nga depozitat e afatizuara. Në vitin 2014, pjesa më e madhe e depozitave ishin në formë të depozitave të transferueshme, të cilat përbënë 47.2 përqind të gjithsej depozitave. Depozitat e afatizuara përbënë 31.7 përqind, ndërsa ato të kursimit u përfaqësuan me 16.5 përqind (figura 23). Zvogëlimi i theksuar i pjesëmarrjes së depozitave të afatizuara në strukturën e gjithsej depozitave mund të jetë ndikuar nga rënia e theksuar e normave të interesit në depozita, gjë që mund të ketë dekurajuar afatizimin e depozitave nga depozituesit.

Në kuadër të strukturës së depozitave të afatizuara, pjesëmarrjen më të lartë prej 50.5 përqind vazhdojnë ta kenë depozitat me afat më të shkurtër maturimi, gjegjësisht depozitat me afat maturimi 'deri në një vit', megjithëse në vitin 2014 është vënë re një zvogëlim i pjesëmarrjes së kësaj kategorie të depozitave. Ndërsa, depozitat afatmesme dhe afatgjata, që bashkërisht kanë një pjesëmarrje prej 49.5 përqind, u karakterizuan me rritje të pjesëmarrjes në strukturën e depozitave të afatizuaranë vitin 2014 (figura 24).

3.4.2.1 Normat e interesit


Viti 2014 u karakterizua me rënie të përsheptuar të normës së interesit si për kreditë ashtu edhe për depozitat. Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 9.2 përqind krahasuar me 11.1 përqind në vitin 2013. Për depozita, norma mesatare e interesit u zvogëluar në 1.1 përqind në vitin 2014, nga 2.4 përqind sa ishte në vitin paraprak (figura 25). Rrjedhimisht, dallimi në mes të normës së interesit në kredi dhe depozita u zvogëluar në 8.1 përqind nga 8.7 përqind sa ishte në vitin 2013.

Figura 23. Struktura depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 24. Struktura e depozitave të afatizuara



Burimi: BQK (2015)


Rënia e theksuar e normës së interesit në kredi në radhë të parë reflekton zvogëlimin e kostos së financimit për bankat si rezultat i zvogëlimit të normës së interesit në depozita. Poashtu, ndikim mund të ketë pasur edhe presioni i konkurrencës si rezultat i të cilit bankat lehtësuan standardet kreditore. Ndërsa, rënie e normës së interesit në depozita pasqyron likuiditetin e mjaftueshëm të sektorit bankar, i cili ka bërë që kërkesa e bankave për depozita të jetë më e ulët.

Gjatë vitit 2014, trendi i rënies së normave të interesit në kredi është shprehur si te kreditë për ndërmarrje, ashtu edhe te ato për ekonomitë familjare. Norma mesatare e interesit te kreditë për ndërmarrje në vitin 2014 u zvogëlua në 9.4 përqind nga 10.9 përqind sa ishte në vitin 2013 (figura 26). Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, kreditë investuese u karakterizuan me normë më të ulët të interesit prej 9.7 përqind në vitin 2014 (10.9 përqind në vitin 2013), ndërsa kreditë tjera të biznesit kishin normë më të lartë të interesit prej 10.5 përqind (12.3 përqind në vitin 2013).

Në vitin 2014, norma mesatare e interesit për kreditë e ekonomive familjare u zvogëlua në 9.0 përqind nga 11.4 përqind sa ishte në vitin 2013. Në kuadër të normave të interesit për ekonomitë familjare, norma e interesit për kreditë konsumuese shënoi rënien më të madhe në 9.1 përqind (11.7 përqind në vitin 2013), përderisa interesi në kreditë hipotekare u zvogëlua në 8.2 përqind (9.7 përqind në vitin 2013). Zvogëlimi më i theksuar i normave të interesit për kreditë investuese në kuadër të ndërmarrjeve dhe atyre konsumuese për ekonomitë familjare u reflektua edhe në rritjen e theksuar të kredive të reja për këto dy kategori.


Sa i përket depozitave, norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare zbriti në 0.9 përqind nga 2.8 në vitin 2013 (figura 27). Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve në vitin 2014 ishte 1.9 përqind, krahasuar me 1.2 përqind sa ishte në vitin 2013.

Figura 25. Mesatarja e normave të interesit, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Figura 26. Normat mesatare të interesit në kredi për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 27. Normat mesatare të interesit në depozita për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


3.4.2.2 Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar i Kosovës shënoi rritje të theksuar të profitit gjatë vitit 2014. Neto profiti i realizuar gjatë këtij viti arriti vlerën prej 60.1 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 26.0 milionë në vitin 2013. Rritja e profitit në vitin 2014 erdhi si rezultat i menaxhimit më të mirë të shpenzimeve, që shënuan rënie të konsiderueshme krahasuar me vitin e kaluar, përderisa të hyrat shënuan rënie të lehtë.

Të hyrat e sektorit bankar në vitin 2014 arritën vlerën prej 244.2 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 1.9 përqind (figura 28). Zvogëlimi i të hyrave të sektorit bankar kryesisht i atribuohet zvogëlimit të të hyrave nga interesi, të cilat dominojnë gjithsej të hyrat me 80.2 përqind, dhe atyre nga jo-interesi që përbëjnë 19.6 përqind të gjithsej të hyrave (figura 29). Të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 1.2 përqind në vitin 2014, rënie kjo që kryesisht i atribuohet zvogëlimit të të hyrave nga interesi në kredi, që ndër tjerash u ndikuan nga normat më të ulëta të interesit gjatë këtij viti. Të hyrat nga jo-interesi u karakterizuan me rënie vjetore prej 3.6 përqind. Kjo rënie ishte kryesisht pasojë e zvogëlimit të hyrave nga tarifatat dhe komisionet.


Gjithsej shpenzimet e sektorit bankar në vitin 2014 arritën vlerën 184.2 milionë euro, e cila është për 17.4 përqind më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve u shkaktua kryesisht nga reduktimi i shpenzimeve të jo-interesit të cilat shënuan rënie vjetore prej 43.0 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të jo-interesit, rënien më të madhe e shënuan shpenzimet për provizione, të cilat u reduktuan për 55.4 përqind në krahasim me vitin paraprak. Ndarja më e ulët e provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë është rezultat i rënies së vlerës së gjithsej kredive joperformuese. Gjithashtu, në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve ndikoi edhe reduktimi i shpenzimeve të interesit që shënuan rënie vjetore prej 31.1 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të interesit, shpenzimet për interesin në depozita shënuan rënie vjetore prej 37.3 përqind, gjë që kryesisht reflekton zvogëlimin e normës së interesit në depozita.

Figura 28. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Figura 29. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve



Burimi: BQK (2015)

Figura 30. Struktura e të hyrave, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


Ndërsa, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej shpenzimeve (figura 30), u karakterizuan me një rritje vjetore prej 1.2 përqind, që nënkupton se zvogëlimi i shpenzimeve të sektorit bankar nuk është shumë i lidhur me përmirësimin e efikasitetit operacional.

Rënia e lehtë e të hyrave, krahasuar me zvogëlimin e theksuar të shpenzimeve, ka ndikuar që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit bankar të përmirësohet dukshëm duke u zvogëluar në 75.4 përqind në vitin 2014, krahasuar 89.6 përqind sa ishte në vitin 2013 (figura 31). Po ashtu, profiti i realizuar gjatë vitit 2014 ka ndikuar që Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) të përmirësohet në 1.9 përqind, nga 0.9 përqind sa ishte në 2013, përderisa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) u përmirësua në 20.2 përqind, nga 9.4 përqind sa ishte në 2013 (figura 31).

Në vitin 2014, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kredite u zvogëluar në 8.3 përqind nga 8.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 32). Shuma e kredive jo performuese shënoi rënie vjetore prej 0.2 përqind krahasuar me rritjen prej 18.6 përqind në vitin 2013. Kreditë jo performuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbjet e mundshme nga kredite. Në vitin 2014, mbulueshmëria me provizione ishte 114.4 përqind (110.5 përqind në vitin 2013).


Po ashtu, sektori bankar ka përfunduar edhe më shumë nivelin e kapitalizimit. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) arriti në 17.8 përqind në vitin 2014 nga 16.7 përqind sa ishte në vitin 2013 (figura 33). Përforsimi i nivelit të kapitalizimit kryesisht i atribuohet rritjes së profitit të sektorit bankar në vitin 2014. Sektori bankar i Kosovës gjatë vitit 2014 sikur edhe viteve të kaluara ka vazhduar të ketë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit. Në vitin 2014, raporti i kredive ndaj depozitave arriti në 74.2 përqind nga 73.7 përqind në vitin 2013. Për më tepër,

Figura 31. Treguesit e profitabilitetit




Burimi: BQK (2015)

Figura 32. Kreditë jo performuese dhe provizionet për humbje nga kredite, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 33. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtëra qëndroi në 43.6 përqind në vitin 2014.⁹

3.4.3 Kompanitë e sigurimit


Struktura e sektorit të sigurimeve, gjatë vitit 2014 mbeti e ngjashme me vitet paraprake. Sektori i sigurimeve vazhdon të dominohet nga segmenti 'jo-jetë' i cili përfaqëson 89.9 përqind të gjithsej sektorit, ndërsa pjesa e mbetur prej 10.1 përqind paraqet segmentin e sigurimit 'jetë' (figura 34).

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në vitin 2014 shënuan rritje vjetore prej 5.8 përqind, duke arritur vlerën 140.4 milionë euro. Në kuadër të gjithsej aseteve, sigurimet jo-jetë përfshijnë 126.3 milionë euro, ndërsa sigurimet jetë 14.1 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe arriti në 82.0 milionë euro, që krahasuar me vitin 2013 paraqet një rritje prej 3.7 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë kanë gjeneruar 79.6 milionë euro, ndërsa ato të sigurimit jetë 2.4 milionë euro. Vlera totale e dëmeve të paguara në vitin 2014 arriti në 33.4 milionë euro, një rënie vjetore prej rreth 17 përqind, prej të cilave 19.1 milionë euro ishin dëme të paguara në kuadër të sigurimit të përgjegjësive ndaj palës së tretë. Zvogëlimi i shumës së dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit rezultoi në rënien e raportit të dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara në 39.5 përqind krahasuar me 49.1 përqind sa ishte në vitin 2013, gjë që tregon për përmirësim të performancës së sektorit krahasuar me vitin paraprak (figura 35).


Në vitin 2014, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 318.8 mijë euro, krahasuar me humbjet prej 754.6 mijë euro vitin e kaluar. Sigurimi jo-jetë vazhdon të karakterizohet me humbje krahasuar me sigurimin jetë që rezultoi me performancë të mirë financiare. Sigurimi jo-jetë kishte humbje prej 806.3 mijë euro në vitin 2014, krahasuar me

Figura 34. Asetet e kompanive të sigurimit, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Figura 35. Primet e kontraktuara dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 36. Asetet e institucioneve mikrofinanciare, rritja vjetore



Burimi: BQK (2015)

⁹ Rregullorja përkatëse e BQK-së kërkon që raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të mos jetë më i ulët se 25 përqind.

humbjet prej 1.0 milionë euro në vitin paraprak. Sigurimi jetë u karakterizua me rritje të profitit në 487.5 mijë euro nga 287.4 mijë euro fitim në vitin e kaluar.


Zvogëlimi i humbjeve pati ndikim edhe në indikatorët e profitabilitetit si Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përmirësua në -0.23 përqind (-0.26 përqind në vitin 2013) kurse ROAE u përmirësua në -0.68 përqind (-0.74 përqind në vitin 2013).

3.4.4 Institucionet mikrofinanciare

Sektori i institucioneve mikrofinanciare (IMF) dominohet nga institucionet e themeluara me kapital të huaj, të cilat zotërojnë 92.4 përqind të gjithëj aseteve të sektorit. Në vitin 2014, 3 IMF-të më të mëdha në vend përfaqësuan 52.8 përqind të gjithëj aseteve të sektorit (46.4 përqind në 2013). Sektori mikrofinanciar në vitin 2014 ndërpreu trendin e tkurrjes së aktivitetit të ndjekur gjatë viteve të fundit. Në vitin 2014, vlera e gjithëj aseteve të institucioneve mikrofinanciare arriti në 112.9 milionë euro, që paraqet nivel të ngjashëm me vitin paraprak (figura 36). Në vitin 2014, IMF-të u karakterizuan me rritje të aktivitetit kreditues dhe lizingut, që së bashku përfaqësojnë 85.7 përqind të gjithëj aseteve të sektorit (figura 37). Në vitin 2014, vlera e gjithëj kredive arriti në 74.4 milionë euro, rritje vjetore prej 2.9 përqind (rënie vjetore prej 6.7 përqind në vitin e kaluar). Rritja e kreditimit gjatë vitit 2014 ishte rezultat i zgjerimit të aktivitetit kreditues për ndërmarrje, kurse kreditë për ekonomitë familjare u karakterizuan me rënie të lehtë. Në vitin 2014, kreditë për ndërmarrje shënuan rritje vjetore prej 10.0 përqind, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare shënuan rënie vjetore prej 0.4 përqind. Rënia e kredive për ekonomitë familjare mund të jetë ndikuar nga konkurrenca prej sektorit bankar duke marrë parasysh që kreditimi i ekonomive familjare nga sektori bankar gjatë të njëjtës periudhë u karakterizua me rritje të përsheptuar.


Sipas sektorëve ekonomik, të gjitha kategoritë e kreditimit gjatë vitit 2014 u karakterizuan me rritje. Kreditë për sektorin e shërbimeve të cilat përbëjnë 46.5 përqind të gjithëj strukturës, u karakterizuan me rritje vjetore prej 10.6 përqind në vitin 2014 (rënie vjetore prej 14.4 përqind në vitin 2013). Kreditë për sektorin e industrisë, të cilat janë kategoria e dytë për nga pesha në strukturë, shënuan rritjen më të theksuar vjetore prej 15.3 përqind në vitin 2014 krahasuar me rënie vjetore prej 16.7 përqind në vitin 2013. Lëvizje të ngjashme shënoi edhe kategoria e tretë që përbëhet nga kreditë për bujqësi të cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 3.6 përqind në vitin 2014 (rënie prej 22.6 përqind në vitin 2013).

Figura 37. Struktura e aseteve të IMF-ve



Burimi: BQK (2015)

Figura 38. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Vlera e lizingjeve në vitin 2014 arriti në 22.4 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 1.4 përqind (rritje vjetore prej 6.0 përqind në vitin 2013). Lizingjet për ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje vjetore prej 97.6 përqind në vitin 2014 kryesisht si rezultat i rritjes së lizingut hipotekar në 11.0 milionë euro nga 5.2 milionë sa ishte në vitin e kaluar. Ndërsa, lizingjet për ndërmarrje shënuan rënie vjetore prej 34.9 përqind në vitin 2014 kryesisht si rrjedhojë e zvogëlimit të lizingut financiar.

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel relativisht të ulët të kredive jo performuese dhe nivel

të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kësaj kategori të kredive. Në vitin 2014, raporti i kredive joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive ishte 4.8 përqind, që paraqet një rënie nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar, kur ky raport qëndronte në 5.2 përqind. Gjithashtu, edhe mbulueshmëria me provizione u përmirësua në 113.1 përqind në vitin 2014 krahasuar me nivelin prej 107.0 përqind në vitin 2013.

Sektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me norma të larta të interesit në kredi. Mesatarja e normës efektive të interesit për kreditë e lëshuara nga ky sektor në vitin 2014 ishte 23.3 përqind (22.6 përqind në vitin 2013). Mesatarja e interesit në kredi për ndërmarrje në vitin 2014 ishte 22.6 përqind (19.8 përqind në vitin 2013), kurse për kreditë e ekonomive familjare norma mesatare ishte 23.8 përqind (23.7 përqind në vitin 2013) (figura 38). Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, norma mesatare e interesit në kreditë për sektorin e bujqësisë dhe të shërbimeve në vitin 2014 u rrit në 25.5 përqind përkatësisht 21.7 përqind (25.0 përqind përkatësisht 20.4 përqind në vitin 2013). Kurse, norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit të industrisë u zvogëluar në 23.8 përqind nga 25.3 përqind në vitin 2013.


Në vitin 2014, sektori mikrofinanciar realizoi të hyra prej 19.3 milionë euro, që krahasuar me vitin e kaluar paraqet rritje prej 0.6 përqind (rënie prej 7.5 përqind deri në vitin 2013). Gjatë vitit 2014, të hyrat u dominuan nga të hyrat e interesit me pjesëmarrje prej 83.1 përqind, të cilat shënuan rritje vjetore prej 3.3 përqind (rënie vjetore prej 9.6 përqind në 2013). Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rënie vjetore prej 7.7 përqind, duke arritur vlerën 18.0 milionë euro. Kjo rënie ishte rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të jo-interesit për 12.5 përqind dhe shpenzimeve të personelit për 3.9 përqind. Treguesi i efikasitetit, i cili matë raportin ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave, në fund të vitit 2014 u përmirësua në 93.3 përqind krahasuar me 101.7 përqind, në vitin paraprak.

Sektori i institucioneve mikrofinanciare e mbylli vitin 2014 me fitim prej 1.3 milionë euro, krahasuar me humbjen prej 324.4 mijë euro në vitin paraprak. Operimi me fitim është reflektuar edhe në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit. Në vitin 2014, kthimi mesatar në asete (angl. Return on Average Assets: ROAA) u përmirësua në 1.1 përqind nga -0.3 përqind në vitin paraprak. Gjithashtu, kthimi mesatar në kapital (ROAE) u përmirësua në 4.3 përqind nga -1.1 përqind në vitin 2013.

3.4.5. Ndihmësit financiar

Vlera e aseteve të ndihmësve financiar, që përbëhen nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP), në vitin 2014 arriti në 9.0 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej

Figura 39. Raporti shpenzime/të hyra




18.6 përqind. Në vitin 2014, të hyrat e ndihmësve financiar arritën vlerën 6.6 milionë euro duke paraqitur rritje vjetore prej 17.0 përqind. Struktura e të hyrave dominohet nga kategoria e të hyrave nga transferet, me pjesëmarrje prej 73.4 përqind në gjithsej të hyrat. Në anën tjetër, shpenzimet arritën vlerën prej 3.4 milionë euro krahasuar me 2.6 milionë euro sa ishin në vitin 2013. Rrjedhimisht, të hyrat neto të ndihmësve financiar arritën vlerën 3.2 milionë euro në vitin 2014, që paraqet një rritje vjetore prej 7.6 përqind.

3.4.6 Sektori Pensional

Sektori pensional vazhdon të jetë sektori me normën më të lartë të rritjes së aseteve në kuadër të sistemit financiar të Kosovës. Vlera e aseteve të sektorit pensional, deri në vitin 2014, arriti në 1.1 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 19.1 përqind. Pjesa më e madhe e kursimeve pensionale në Kosovë vazhdon të administrohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), që menaxhon me 99.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit të pensioneve, ndërsa pjesa e mbetur administrohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Në vitin 2014, asetet e FSKP-së shënuan rritje vjetore prej 9.2 përqind, duke arritur vlerën prej 5.8 milion euro.

Figura 40. Struktura e aseteve të FKPK-së në vitin 2014, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Sa i përket FKPK-së, struktura e aseteve deri në vitin 2014 u dominua nga investimet në tregun e jashtëm me një pjesëmarrje prej 94.1 përqind (figura 40). Pjesa e mbetur e aseteve përbëhet nga investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës (5.0 përqind) dhe nga depozitat në BQK (0.9 përqind). Krahasuar me vitin e kaluar, FKPK ka tërhequr pjesën më të madhe të depozitave të mbajtura në BQK dhe ka investuar në fonde investuese në sektorin e jashtëm. Pjesa më e madhe e këtyre investimeve jashtë vendit janë në formë të aksioneve dhe bonove të thesarit të qeverive të huaja.

Investimet jashtë vendit dominojnë edhe strukturën e aseteve të FSKP-së. Deri në vitin 2014, jashtë vendit janë investuar gjithsej 79.6 përqind të aseteve të FSKP-së, ndërsa pjesa e mbetur prej 20.4 përqind paraqet investimet në Kosovë (figura 41).

Figura 41. Struktura e aseteve të FSKP-së në vitin 2014, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Sektori pensional gjatë vitit 2014 u karakterizua me performancë pozitive financiare. Të dy fondet shënuan ngritje të çmimit të aksionit dhe kthim pozitiv nga investimet. Vlera e çmimit të

aksionit¹⁰ të FKPK-së, në vitin 2014, arriti në 1.29 euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.5 përqind. Në vitin 2014, FKPK-ja ka realizuar 66.7 milionë euro kthim bruto nga investimet.

¹⁰ Vlera bazë e çmimit të aksionit për FKPK-në është =1, ndërsa për FSKP-në është =100.

Gjithashtu, edhe vlera e çmimit të aksionit të FSKP-së ka vazhduar me trendin rritës, duke arritur në 145.16 euro në vitin 2014, që paraqet rritje vjetore prej 4.8 përqind. Në vitin 2014, FSKP-ja realizoi kthimin bruto nga investimet në vlerë prej 371.9 mijë euro.

3.5. Projektionet makroekonomike për vitin 2015

Projektionet për rikuperim të aktivitetit ekonomik në nivel global, sidomos në vendet e Eurozonës, pritet të kenë implikime edhe në ekonominë e Kosovës gjatë vitit 2015. Në vitin 2015 eurozona pritet të shënojë një normë reale të rritjes së PBB-së prej 1.5 përqind krahasuar me 0.9 përqind sa ishte në vitin paraprak. Efektet e përmirësimit të ekonomisë në Eurozonë transmetohen në ekonominë e Kosovës nëpërmjet remitencave, investimeve të huaja direkte si dhe kërkesës së jashtme që pritet të ndikojë në eksportet e Kosovës. Përveç transmetimit të efekteve nga zhvillimet pozitive në eurozonë dhe partnerët kryesorë ekonomik, përforcimi i aktivitetit ekonomik në Kosovë pritet të vijë edhe nga zhvillimet në ekonominë vendore.

Projektionet e BQK-së për vitin 2015 sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me përshpejtim të rritjes ekonomike, e cila pritet të arrijë në 3.5 përqind. Ky përshpejtim i rritjes pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, veçanërisht nga investimet. Investimet publike pritet të shënojnë rritje, ndërkohë që projektet me rëndësi të veçantë, siç është koncesionimi i kompleksit turistik “Brezovica” dhe vazhdimi i punimeve në Autostradën Prishtinë-Shkup, pritet të ndikojnë në rritjen e investimeve private. Investimet private pritet të mbështeten edhe nga aktivitetit kreditor, i cili pritet të përshpejtohet për shkak të rënies së normave të interesit në kredi si dhe lehtësimit të standardeve për aprovimin e kredive nga ana e bankave.

Konsumi po ashtu pritet që të kontribuojë pozitivisht në rritjen ekonomike. Faktorët kryesor që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit janë rritja e pagave për shërbyesit civil (rritja e pagave në prill të vitit 2014 pritet të ketë ndikim edhe në vitin 2015 pasi që efekti është i plotë për tërë vitin), rritja e remitencave si dhe rritja e kredive konsumuese. Pozicioni i neto eksporteve pritet të përkeqësohet në vitin 2015, duke ndikuar kështu negativisht rritjen ekonomike në vend. Indikacionet për rritje të aktivitetit në sektorët e ekonomisë si bujqësia dhe prodhimi pritet të ndikojnë në rritje të eksportit. Megjithatë, rritja e kërkesës së përgjithshme pritet të ndikojë në rritjen e vlerës së importit të mallrave, duke ndikuar kështu në thellimin e deficitit tregtar. Përkeqësimi i bilancit të mallrave pritet të zbutet lehtë nga rritja e bilancit pozitiv në llogarinë e shërbimeve.

Çmimet në Kosovë vazhdojnë të përcaktohen kryesisht nga çmimet në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht çmimet e ushqimit dhe të naftës. Këto dy kategori të produkteve, të cilat kanë peshën kryesore në shportën e konsumatorit kosovar, janë karakterizuar me rënie të çmimeve në vitin 2014 dhe pritet të mbesin stabile në vitin 2015, andaj edhe presionet inflacioniste pritet të mbesin të dobëta sikurse në vitin e kaluar.

Norma e rritjes së kreditimit për vitin 2015 pritet të ketë ngritje të lehtë, kryesisht si rezultat i kushteve më të mira makroekonomike nga njëra anë, pozitës së mirë të kapitalit të sektorit bankar, lehtësimit të standardeve për aprovimin e kredive nga ana e bankave, pozitës së lartë të likuiditetit dhe nivelit të kënaqshëm të portofolit kreditor. Poashtu, bazuar në pritjet për normë të përshpejtuar të rritjes ekonomike, pritet që edhe kërkesa për kredi të rritet gjatë vitit 2015. Sa i përket depozitave, pritshmëritë për vitin 2015 janë se ato do të rriten me ritëm të ngjashëm me atë të vitit 2014. Bartësit kryesorë të rritjes së depozitave do të vazhdojnë të jenë ekonomitë familjare. Rritja e pagave të sektorit publik (efekti i plotë në vitin 2015) pritet t'i kontribuojë rritjes së depozitave, por që rritja e tillë mund të neutralizohet nga efekti që rënia e normave të interesit në depozita mund të ketë në motivet e depozituesve për të kursyer.

4. Mbikëqyrja e Institucioneve Financiare

4.1. Korniza rregullative dhe procesi i licencimit

4.1.1 Korniza rregullative

BQK-ja, që nga themelimi i saj, e mbështetur në vazhdimësi nga institucione të njohura ndërkombëtare, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, USAID, Thesari Amerikan, KfW, GIZ, Banka Qendrore Evropiane, etj., ka ndërtuar një kornizë rregullative për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare të bazuar në standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare. BQK-ja, gjatë viteve të fundit, ka filluar një proces gradual drejt përafrimit me Principet Bazike për Mbikëqyrjen e Bankave të nxjerra nga Banka për Rregullime Ndërkombëtare (Bank for International Settlements – BIS), Principet Bazike për Mbikëqyrjen e Kompanive të Sigurimeve të nxjerra nga Asociacioni Ndërkombëtar për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (International Association of Insurance Supervisors – IAIS) dhe Direktivat Evropiane, që adresojnë rregullimin e institucioneve financiare, si dhe standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare. Ky është një proces i vazhdueshëm dhe kompleks pasi që kërkon plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe rregullative, si dhe kërkon një qasje adekuate në mënyrë që të studiohen me kujdes rrethanat specifike të Kosovës, për një adaptim të drejtë të këtyre standardeve duke ju përshtatur nevojave të sektorit financiar në Kosovë. Kjo duke marrë parasysh faktin se këto standarde kanë pësuar ndryshime të shumta edhe në vendet e zhvilluara kryesisht në dekadën e fundit, kështu që vazhdimisht kërkohet rishikimi dhe plotësimi i tyre për të reflektuar ndaj zhvillimeve dhe ndryshimeve të vazhdueshme të tregut financiar.

Përpilimi dhe rishikimi i vazhdueshëm i rregulloreve të mbikëqyrjes financiare (banka, institucione mikrofinanciare, institucione financiare jobankare, sigurime dhe fonde pensionale) bëhet nga grupet punuese, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të departamenteve përkatëse, si Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare, Departamentit të Licencimit dhe Standardizimit, Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Pensioneve, Departamentit Juridik, si dhe me mbështetjen e Departamenteve tjera të BQK-së. Gjatë përgatitjes së rregulloreve dhe çdo instrumenti ligjor dhe rregullator, BQK-ja bashkëpunon ngushtë me industrinë, përmes takimeve dhe komunikimit të vazhdueshëm me subjektet e rregulluara, kryesisht përmes shoqatave përkatëse të institucioneve, si Shoqatën e Bankave të Kosovës, Shoqatën e Sigurimeve, Shoqatën e Institucioneve Mikrofinanciare, por në raste të caktuara edhe përmes takimeve të përbashkëta me përfaqësuesit e institucioneve financiare individualisht, përmes të cilave mund të paraqesin opinionet e tyre rreth çështjeve përkatëse. Ky proces ka ndihmuar vazhdimisht në qartësimin e çështjeve specifike që adresohen me rregullore dhe rregullimin e drejtë të tyre, duke marrë parasysh ndikimin e tyre në stabilitetin e sistemit financiar në Kosovë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

4.1.2 Aktet e reja rregullative të mbikëqyrjes financiare, standardizimi dhe rregullativa

Gjatë vitit 2014 BQK-ja ka përgatitur rregulloret në vijim, të cilat janë miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore për adresimin e çështjeve të rëndësishme për mbikëqyrjen e institucioneve financiare duke kontribuar në fuqizimin e mëtejshëm të kornizës së përgjithshme rregullative dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare, si dhe me qëllim të zbatimit të ligjeve përkatëse për mbikëqyrjen e institucioneve financiare:

- Rregullore për Raportet dhe Informatat që kërkohen nga Fondi i kursimeve Pensionale të Kosovës. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet, afatet dhe rregullat e raportimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në BQK (miratuar më 29 maj 2014);

- Rregullorja për Licencimin e Ndërmjetësuesve të Sigurimeve (miratuar më 29 gusht 2014). Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret për licencimin e ndërmjetësuesve të sigurimeve;
- Rregullore për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave (miratuar më 25 shtator 2014) - Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale mbi procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave, që kërkon nga institucionet financiare themelimin e njësisë për të trajtuar ankesat, që vijnë nga klientët e tyre, klientët aktualë dhe ata potencialë, me qëllim të krijimit të një fushëveprimi të barabartë për të gjitha institucionet financiare dhe për të siguruar trajtim të drejtë të klientëve. Kërkesat lidhur me procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave, rritin mundësinë e klientëve që në mënyrë aktive të mbrojnë të drejtat e tyre, të cilat do të thellojnë më tej besimin e tyre në funksionimin e drejtë të tregut financiar dhe do të ndikojnë pozitivisht në prezencën e tyre në tregun financiar dhe në rritjen ekonomike;
- Rregullorja për Licencimin e Kompanive të Sigurimeve (miratuar më 30 tetor 2014) Kjo Rregullore përcakton kriteret, kërkesat, procedurat dhe afatet, që duhet ndjekur për aplikimin dhe marrjen e licencës për çdo kompani të sigurimeve dhe degë të një kompanie të huaj të sigurimeve, të cilat do të referohen në këtë Rregullore si kompani të sigurimeve, përveç rasteve kur në mënyrë specifike adresohet kompania e sigurimeve e themeluar si subjekt i varur apo degë e kompanisë së huaja të sigurimeve;
- Rregullore për Licencimin e Menaxhuesve të Mjeteve për Mjetet e Fondeve Pensionale (miratuar më 30 tetor 2014). Kjo rregullore përcakton kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet, që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e licencës për menaxhuesit e mjeteve për mjetet e fondeve pensionale;
- Rregullore për Pagesën e Pensioneve Individuale të Kursyera (miratuar më 30 tetor 2014). Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve për pagesën e pensioneve për pjesëmarrësit dhe përfituesit e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, si dhe ofruesit e pensioneve plotësuese individuale. Gjithashtu kjo Rregullore përcakton kushtet e pagesave të shumave totale dhe pagesat fazore para se të jenë në funksion kontratat e anuiteteve, si dhe pagesat nëpërmjet kontratës së anuitetit në Kosovë;
- Rregullore për Licencimin e Fondeve Plotësuese Pensionale të Punëdhënësve (miratuar më 29 dhjetor 2014). Kjo rregullore përcakton kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e licencës për Fondet Plotësuese Pensionale të Punëdhënësve;
- Rregullore për Licencimin e Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale (miratuar më 29 dhjetor 2014). Kjo Rregullore përcakton kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e licencës për Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale.

4.1.3 Projektet e vazhduara gjatë vitit 2014 lidhur me zhvillimin e kornizës rregullative

Gjatë vitit 2014 BQK-ja ka vazhduar me disa nga projektet e filluara më parë dhe ka përgatitur një numër të rregulloreve që janë finalizuar në fillim të vitit 2015, por njëkohësisht janë vazhduar proceset afatgjata për plotësimin e kornizës ligjore dhe rregullative të cilat janë në proces edhe përgjatë vitit 2015.

Në kuadër të projekteve në proces dhe aktiviteteve për përgatitjen e instrumenteve ligjore dhe rregullative, BQK ka vazhduar me aktivitetet për finalizimin e draft ligjit për sigurimet e përgjithshme në kuadër të grupit punues të formuar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Ky draft ligj është dërguar edhe në zyrën e komisionit evropian për vlerësim sa i

përket pajtueshmërisë me direktivat e BE-së që adresojnë fushën e sigurimeve. Draft ligji për sigurimet e përgjithshme tani është në fazën finale dhe pritet që të miratohet gjatë vitit 2015.

Gjithashtu është përgatitur edhe drafti i ligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo-bankare i cili është ndarë si ligj i veçantë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me nenet përkatëse që adresojnë këto institucione. Ky ligj gjithashtu është finalizuar si draft nga grupet punuese të BQK-së dhe tani është përcjell për procedurat e mëtejme të aprovimit, i cili pritet të miratohet gjatë vitit 2015.

Në përpjekje të vazhdueshme për të zhvilluar dhe avancuar kornizën rregullative, edhe gjatë vitit 2014, BQK ka vazhduar me plotësimin dhe amandamentimin e rregulloreve për mbikëqyrjen e institucioneve financiare. Disa nga rregulloret e amandamentuar gjatë vitit 2014, të cilat ende janë në proces apo janë finalizuar në fillim të vitit 2015 janë:

- Rregullorja për Kërkesat Minimale të Sigurisë për bankat, e cila adreson kërkesat për pajisjet dhe procedurat minimale që bankat duhet të posedojnë për sigurimin e objekteve të tyre (kjo rregullore është miratuar nga Bordi i BQK-së me 26 mars 2015);
- Rregullorja për Shpërndarjen e Fondeve të Kredisë në para të gatshme, është plotësuar nga grupet punuese dhe është në fazën finale të aprovimit;
- Rregullorja për Ekspozimet e Mëdha është përgatitur dhe është në fazën finale, ku me plotësimet e reja është përafuar me kërkesat e direktivës së BE-së lidhur me adresimin e ekspozimeve të mëdha të bankave;
- Rregullorja për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Veprimtaritë e Institucioneve Financiare Jo-Bankare, gjithashtu është plotësuar si draft final me plotësimet sa i përket kërkesave për kapital, qeverisjes së korporatave, si dhe qartësimin të kërkesave për regjistrimin e këtyre institucioneve, e cila për arsye të volumit dhe specifikave të ndryshme të institucioneve që adreson ka vazhduar edhe gjatë këtij viti dhe tani është në fazën finale të miratimit.

Ndërsa projektet e vazhduara edhe gjatë vitit 2014, për zhvillimin e kornizës rregullative janë, si vijon:

4.1.4 Financimi i banimit në Kosovë

Projekti për Financimin e Banimit ka filluar me qëllim të adaptimit të rregullave të shëndosha të kreditimit të mbuluar me pasuri të paluajtshme, të njohur si kreditë hipotekare.

Gjatë këtij projekti janë konsultuar në vazhdimësi të gjitha institucionet relevante që ndërlidhen me pronën e paluajtshme në Kosovë, përfshirë Agjencinë e Kadastrave, Ministrinë e Ambientit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë dhe donatorët tjerë të projekteve të ndërlidhura të këtyre institucioneve si GIZ, USAID, SIDA dhe partnerë tjerë relevant. Gjithashtu, gjatë këtij procesi janë përfshirë edhe bankat dhe institucionet tjera financiare, si akterë kyç në kreditimin e financimit të banimit, të cilat janë konsultuar në vazhdimësi edhe përgjatë procesit të përgatitjes së rregulloreve përkatëse që adresojnë këtë çështje.

Përmes këtij projekti është kontribuar edhe në përgatitjen e Ligji nr. 04/l-134 për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi përmes takimeve të përbashkëta me përfaqësuesit e Ministrisë së Ambientit dhe grupeve punuese. Gjithashtu, si pjesë e këtij projekti ka qenë edhe mbështetja e ofruar ndaj Bordit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme, të themeluar nga Ministria e Financave, i cili, në bashkëpunim me Odën Ekonomike, organizon trajnimin dhe kryen licencimin e vlerësuesve të pronave të paluajtshme në Republikën e Kosovës.

Si rezultat i këtij projekti janë përgatitur dy rregullore nga Banka Qendrore, të cilat adresojnë dhe rregullojnë procesin e plotë të kreditimit të financimit të banimit, përfshirë kërkesat specifike për vlerësimin e pronave të paluajtshme nga ana e institucioneve financiare me rastin e

kredivë të mbuluara me hipotekë. Rregulloret në fjalë përcaktojnë kërkesat specifike për njoftimin e drejtë të kredi marrësve lidhur me obligimet e tyre në rast të hyrjes në marrëdhënie kontraktuese me bankën apo institucionet tjera financiare kredi dhënëse, për shfrytëzimin e kredivë për financimin e banimit, si dhe kërkesat ndaj institucioneve financiare për vlerësimin adekuat të aftësisë kredi marrëse të klientëve. Në kuadër të projektit është plotësuar edhe rregullorja për adekuatshmërinë e kapitalit për të përcaktuar peshimet adekuat të kredivë hipotekare me rrezik, varësisht nga niveli i mbulesës që ofrohet me hipotekë dhe niveli i përmbushjes së kriterëve specifike të përcaktuara për kualifikimin e kredivë. Kriteret për kualifikimin e kredivë janë përcaktuar me rregulloren për kreditë hipotekare, përfshirë limitet maksimale të këstit të kredisë dhe borxheve totale të kredi-marrësve në raport me të ardhurat mujore të tyre, si dhe kërkesat që lidhen me të drejtat pronësore dhe kërkesat minimale që duhet të përmbaj marrëveshja për kredinë dhe marrëveshja për hipotekën.

Rregullorja për kreditë hipotekare dhe rregullorja për vlerësimin e pronave të paluajtshme fuqizojnë kornizën rregullative për kreditimin e financimit dhe kreditë e mbuluara me pasuri të paluajtshme përmes të cilave krijohen rregulla të qarta për kreditë hipotekare dhe vlerësimin adekuat të hipotekave.

Këto dy rregullore së bashku me plotësimet e rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit sa i përkat adaptimit të peshimeve përkatëse me rrezik të kredivë hipotekare sipas kërkesave të reja, janë miratuar në fillim të vitit 2015. Gjatë vitit 2014 është krijuar edhe një data bazë specifike lidhur me kreditë hipotekare në Kosovë, përmes Departamentit të Statistikave dhe Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankave. Me këtë databazë do të mbahen shënime të detajuara rreth kredivë hipotekare, të cilat mund të përdoren në të ardhmen për vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave ekzistuese dhe nevojave për ndryshimin dhe plotësimin e tyre, varësisht nga ndikimi i tyre në nivelin e portofolit të kredivë hipotekare në Kosovë.

4.1.5 Mbrojtja e konsumatorit për shërbimet financiare

Gjatë vitit 2014 është vazhduar aktiviteti për fuqizimin dhe avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe kornizës institucionale për mbrojtjen e konsumatorit të shërbimeve financiare dhe për ngritjen e nivelit të njohurive financiare të konsumatorëve në Kosovë.

Ky projekt ka filluar në qershor të vitit 2013, në kohën kur edhe është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Bankës Qendrore dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për të vendosur kanalet e komunikimit dhe bashkëpunimit lidhur me fuqizimin e mbrojtjes së konsumatorit të shërbimeve financiare. Si rezultat i kësaj marrëveshje janë mbajtur shumë takime të përbashkëta, ku në mars të vitit 2014 është organizuar edhe një tryezë e përbashkët për njoftimin e publikut rreth ndryshimeve të fundit sa i përket mbrojtjes së konsumatorit të shërbimeve financiare.

Si pjesë e objektivave të këtij projekti kanë qenë edhe përgatitja e disa rregulloreve dhe procedurave për njoftimin e drejtë të konsumatorëve, por edhe për përcaktimin e rregullave të qarta për institucionet financiare sa i përket njoftimit të drejtë të klientëve rreth shërbimeve financiare dhe adresimin adekuat të ankesave të tyre.

Nga data 01 tetor 2014 është në fuqi rregullorja për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave nga institucionet financiare. Kjo rregullore përcakton afatet kohore dhe definon saktë procesin dhe procedurat që duhet të ndjekin konsumatorët dhe institucionet financiare në rast të adresimit dhe trajtimit të ankesave. Gjithashtu, është përgatitur edhe procedura e brendshme e BQK-së për mënyrën e trajtimit të ankesave të konsumatorëve të shërbimeve financiare, në rast të pranimit të tyre direkt nga konsumatorët apo edhe nga departamenti përkatës për mbrojtjen e konsumatorit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Si pjesë e këtij projekti është në proces edhe rregullorja e cila përcakton mënyrën e shpalosjes së shërbimeve financiare për konsumatorin, në mënyrë që t'i sqarohen të drejtat dhe obligimet e tij në rast të shfrytëzimit të një shërbimi financiar nga institucioni financiar. Si dhe është planifikuar që gjatë këtij viti të përgatitet një rregullore e veçantë, e cila adreson rregullat e qarta që duhet të aplikohen me rastin e reklamimit të shërbimeve financiare, në mënyrë që konsumatori të mos keq orientohet duke u tërhequr në shërbime financiare pa qenë mirë i njoftuar për obligimet që merr në rast të shfrytëzimit të tyre.

Për të adresuar objektivat e projektit, janë krijuar edhe format standarde të ankesave për konsumatorët, gjithashtu është plotësuar edhe ueb faqja e BQK-së në mënyrë që konsumatorët të gjejnë informacionin e nevojshëm në rast të ankesave të tyre ndaj institucioneve financiare.

Pasi që kjo fushë ka marr fokus më të madh edhe në vendet e zhvilluara pas krizës së fundit financiare dhe janë bërë shumë ndryshime rregullative vetëm gjatë viteve të fundit, Kosova ka përfituar shumë nga ekipi i ekspertëve të Bankës Botërore dhe është në proces të krijimit të një baze solide për adresimin e çështjes së mbrojtjes së konsumatorit të shërbimeve financiare në Kosovë. BQK gjithashtu ka ndërmarr disa aktivitete për ngritjen e edukimit financiar të konsumatorëve përmes tryezave të përbashkëta dhe prezantimeve të organizuara për nxënësit e shkollave në Kosovë.

4.1.6 Angazhimi rreth lehtësimit të zbatimit të kontratave

Gjatë vitit 2014, BQK-ja ka mbështetur projektin Zbatimi i Kontratave Ligjore (Anglisht: Contract Law Enforcement), duke përgatitur legjislacionin sekondar për zbatimin e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve sa i përket pjesëve të cilat rregullojnë shërbimet financiare. Pasi që neni 1058 i Ligjit 04/L-77 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ka paraparë që dispozitat e ligjit paraprak të vazhdojnë të zbatohen përshtatshëm deri në momentin e rregullimit të tyre me legjislacion sekondar, dhe pasi që këto çështje kanë të bëjnë me shërbimet financiare, kryesisht shërbimet bankare, duke marr parasysh se BQK është autoriteti i vetëm licencues, rregullativ dhe mbikëqyrës i bankave dhe institucioneve tjera financiare në Kosovë, është vendosur që rregulloret që adresojnë çështjet e përcaktuara me këtë nen, të nxirren nga BQK-ja.

Rregulloret e përgatitura përmes këtij projekti janë:

- Rregullore për Kasafortën;
- Rregullore për Letër kredinë dhe Garancionin Bankar;
- Rregullore për Depozitën;
- Rregullore për Llogarinë Bankare;
- Rregullore për Marrëveshjen e Kredisë; dhe
- Rregullore për Deponimin e Letrave me Vlerë.

Është planifikuar që brenda gjysmë vjetorit të parë të vitit 2015 të finalizohen 6 rregulloret e parapara me këtë projekt. Pas hyrjes në fuqi të këtyre rregulloreve, do të shfuqizohen në tërësi dispozitat ligjore të Ligjit parapake për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe çështjet në fjalë do të rregullohen vetëm me rregulloret e nxjerra nga BQK të bazuara në nenin 1058 të Ligjit 04/L-77 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për bankat.

4.1.7 Plotësimi i rregullores për PPP / FT dhe rishikimi i manualit për ekzaminim

Gjatë vitit 2014 është rishikuar edhe rregulla për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Drafti i kësaj rregulloreje me ndryshimet e reja me qëllim të adaptimit të kërkesave të ndryshimeve të fundit të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave është i

finalizuar dhe janë marrë në konsideratë edhe komentet e bankave rreth këtij drafti, i cili aktualisht është në proces të shqyrtimit final nga organet vendimmarrëse. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është rishikuar dhe përgatitur Manuali i Ekzaminimit të institucioneve financiare lidhur me përmbushjen e rregullave dhe zbatimin e rregullores së BQK-së në lidhje me kërkesat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Me ndryshimet e fundit janë adaptuar kërkesat e reja ligjore dhe standardet e reja ndërkombëtare sa i përket fushës së parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me fokus direktivat përkatëse të BE-së.

4.1.8 Rishikimi i Manualit për Licencimin e Bankave dhe Institucioneve tjera Financiare

Gjatë vitit 2014 është kryer edhe rishikimi i manualit të licencimit të bankave në mënyrë që të adaptohen kërkesat e reja të Ligjit për Bankat dhe Rregullores për Licencimin e Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja. Pas plotësimeve të fundit janë sqaruar të gjitha hapat e nevojshme për parashtrimin e kërkesës nga aplikantët e interesuar për të operuar në Kosovë përmes licencimit dhe regjistrimit të institucioneve financiare. Tani këto kërkesa mund të gjenden edhe në ueb faqen e BQK-së, përmes udhëzuesve përkatës dhe broshurave të përgatitura në mënyrë specifike për ti njoftuar drejtë të gjitha palët e interesuara, të cilat janë publikuar në linkun përkatës të faqes zyrtare. Gjithashtu, me ndryshimet e fundit janë specifikuar qartë afatet kohore dhe obligimet e secilës palë në shqyrtimin e drejtë dhe brenda një kohe sa më të shkurt të gjitha aplikacioneve për licencimin dhe regjistrimin e institucioneve financiare.

4.1.9 Rishikimi i Manualit për Likuidimin e Bankave

Në proces është edhe finalizimi i rishikimit të manualit të likuidimit të bankave, në mënyrë që të adresohen kërkesat e reja ligjore dhe të krijohet një kornizë e qartë operationale për adresimin e rasteve kur bankat mund të hasin në vështirësi, në mënyrë që të krijohen procedurat adekuate për adresimin e shpejt dhe të drejtë të tyre. Me anë të ndryshimeve të reja do të krijohet një infrastrukturë e qartë institucionale në kuadër të BQK-së dhe do të specifikohen saktë procedurat, që duhet ndjekur në rast të marrjes nën administrim apo likuidimit të bankave. Këto procedura specifike do të lehtësojnë dhe shpejtojnë veprimet e mundshme të BQK-së në bashkëpunim me akterët relevantë siç është Fondi për Sigurimin e Depozitave, duke qartësuar mënyrën e komunikimit ndërmjet tyre dhe përgjegjësitë e veprimit për secilin autoritet. Kjo do të lehtësojë zgjidhjen e problemeve të mundshme dhe adresimin e drejtë të tyre në të ardhmen, në rastet kur është e nevojshme ndërhyrja e BQK-së për të përmirësuar dhe zgjidhur problemet e bankave.

4.2. Licencimi

Kriteret e licencimit të përcaktuara me legjislacion, synojnë sigurimin e një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar nëpërmjet një procesi të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar, veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar kërkesat ligjore.

Struktura e sistemit financiar në fund të vitit 2014 është si vijim: numri i bankave që operojnë në Republikën e Kosovës është 9, prej të cilave 3 janë degë të bankave të huaja. Përveç këtyre nëntë bankave, 1 degë e bankës së huaj ka vetëm licencë paraprake, 1 zyrë përfaqësimi e bankës së huaj, 13 institucione mikrofinanciare si dhe 47 institucione financiare jo bankare, të ndara

sipas aktiviteteve: 4 me aktivitet të kredidhënies/lizingut, 1 me aktivitet të faktoringut, 6 me aktivitet të shërbimit të transferit dhe pagesave dhe 36 me aktivitet të këmbimit të valutave.

Sa i përket siguruesve, në Republikën e Kosovës, në fund të vitit 2014 operuan si vijon: 13 kompani sigurimesh, prej të cilave 10 kompani sigurimi jo-jetë, ndërsa 3 jetë. Nga 13 kompani të sigurimeve, 9 prej tyre janë me pronësi të huaj, ndërsa 4 prej tyre janë në pronësi vendore. Përveç tyre, 1 kompani sigurimesh ka licencë paraprake.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës bazuar në Ligjin për Banka, IMF dhe IFJB është përgjegjëse për licencimin, regjistrimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave dhe institucioneve financiare.

Gjatë vitit 2014, BQK ka marrë vendime që lidhen me:

- dhënien e licencës paraprake për bankën e huaj për hapjen e degës në Prishtinë;
- refuzimin e aplikacionit për dhënien e licencës bankare;
- aprovimin për hapjen e një zyre përfaqësuese të bankës së huaj;
- aprovimin për regjistrimin e katër institucioneve financiare jobankare
- refuzimin e kërkesës për regjistrimin e një subjekti si institucion financiar jobankar për të kryer aktivitetin e transferit të parave dhe këmbimit valutor dhe refuzimin e kërkesës për shtim të aktivitetit të një institucioni financiar jobankar;
- aprovimin e ndryshimeve për statute të bankave dhe institucioneve financiare;
- aprovimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të bankave;
- aprovimin e shitblerjes së aksioneve të institucioneve financiare;
- aprovimin për hapje, zhvendosje, mbyllje të degëve dhe nëndegëve të bankave;
- aprovimin për hapje, zhvendosje të zyrave / agjenteve të IMF-ve dhe IFJB-ve;
- aprovimin e auditorëve të jashtëm të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve dhe siguruesve;
- dhënien e licencës paraprake për një kompani sigurimi;
- aprovimin për kryetar dhe anëtar të bordeve për sigurues;
- aprovimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të kompanive të sigurimeve;
- aprovimin e auditorëve të brendshëm për kompanitë e sigurimeve;
- aprovimin e agjentëve / operatorëve për kompani të sigurimeve, byronë e sigurimeve dhe fond pensional;
- aprovimin e aktuarëve për kompani të sigurimeve;
- aprovimin e zyrave të reja të kompanive të sigurimeve;
- aprovimin e licencave për ndërmjetësues të sigurimeve;
- aprovime të produkteve të reja të sigurimeve;

- aprovim për shpërndarje dividende;
- aprovime për zhvendosje të zyrave etj.

4.2.1 Aktiviteti i licencimit në sektorin financiar

Dhënia e licencave nga BQK-ja, gjatë vitit 2014 konsistoi në dhënien e licencës paraprake për T.C. Ziraat Bankasi A.S. Ankara, Turqi, për hapjen e degës në Prishtinë, refuzimi i aplikacionit të një kompanie vendore për dhënien e licencës bankare, aprovimin për hapjen e zyrës përfaqësuese të Atlas Bankës AD, Mali i zi, në Prishtinë.

Gjithashtu, janë aprovuar regjistrimet për 4 institucione financiare jobankare, AGC Faktor për të kryer aktivitetin e faktoringut: Euro Toti, Lluk-I dhe Afrimi S, për aktivitet të këmbimit valutor. Gjatë këtij viti aplikacioni i një kompanie të huaj për kryerjen e aktivitetit të transferit të parave dhe këmbimit është refuzuar. Në funksionin e zgjerimit të aktiviteteve gjatë këtij viti BQK-ja ka pasur vetëm një kërkesë nga institucioni Lesna për të shtuar veprimtarinë e shërbimit të pagesave, e cila kërkesë është refuzuar.

Gjatë këtij viti janë aprovuar 4 kërkesa të bankave për ndryshimin e statutit dhe 1 kërkesë e institucionit financiar jo bankar.

Gjatë vitit 2014 pati ndryshime në përbërjen e bordeve të drejtorëve, të komiteteve të auditimit, të menaxherëve të lartë të bankave dhe institucioneve financiare. Janë aprovuar 2 kërkesa për emërim të drejtorëve, menaxhmentit të lartë të bankave dhe institucioneve financiare, ndërsa 6 kërkesa janë refuzuar. Në rastet e aprovimeve të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të bankave, 3 prej tyre janë anëtarë të bordit drejtues, 1 anëtarë i pavarur i komitetit të auditimit, 12 menaxher të lartë të bankave (3 janë kryeshef ekzekutiv, 1 drejtor i degës dhe 8 pozita të tjera ekzekutive).

Në rastet e aprovimit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të institucioneve financiare, 6 janë anëtar bordi të institucioneve financiare jo bankare, 3 anëtarë bordi të institucioneve mikrofinanciare dhe 2 menaxher të lartë (kryeshef ekzekutiv të IFJB dhe IMF).

Gjatë vitit 2014 pati ndryshime në përbërjen e bordeve të drejtorëve, të komiteteve të auditimit, të menaxherëve të lartë të bankave dhe institucioneve financiare. Sipas Ligjeve 04/L-093 për Banka, Institucione Mikrofinanciare si dhe Institucione Financiare Jo bankare si dhe Rregulloren 2001/25 mbi mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit e të ndërmjetësuesve të sigurimit, BQK-ja është e mandatuar për aprovimin e këtyre drejtuesve të institucioneve. Nga 18 anëtarë të bordeve të drejtorëve të paraqitur për aprovim në BQK-ja, 12 janë aprovuar dhe 6 janë refuzuar. Nga anëtarët e bordeve të drejtorëve të aprovuar 3 janë të bankave, 6 të IFJB-ve si dhe 3 të IMF-ve, ndërsa sa u përket atyre të refuzuarve 4 janë anëtarë të propozuar nga bankat, 1 nga IFJB-të si dhe 1 nga IMF-të. Po ashtu gjatë kësaj periudhe BQK-ja ka aprovuar emërimin e 6 kryeshefëve ekzekutivë (njëri nga ta është drejtor i një dege të bankës së huaj) të institucioneve financiare ku 4 nga ta ishin nga bankat, 1 nga IMF si dhe 1 nga IFJB-të. Sa i përket menaxherëve tjerë të lartë ku përfshihen zyrtari kryesor për financa, zyrtari kryesor i operacioneve, zyrtari kryesor për risk të bankës dhe çdo person, përveç drejtorit, i cili i raporton drejtpërdrejt bordit të drejtorëve. BQK-ja ka shqyrtuar 8 raste ku të gjitha kanë qenë nga bankat si dhe janë aprovuar nga ana e BQK-së. Në këtë periudhë BQK-ja po ashtu ka aprovuar edhe 1 anëtar të Komitetit të Auditimit të një banke.

Gjatë vitit 2014, BQK ka shqyrtuar një numër kërkesash të bankave lidhur me degët dhe nëndegët e tyre. BQK-ja në këtë vit ka aprovuar hapjen e 1 dege, 4 nëndegëve, 10 zhvendosje të

degëve dhe nëndegëve, si dhe mbylljen e 25 nëndegëve. Bankat kanë mbyllur 26 nëndegë, kryesisht njësi të vogla pas vlerësimit të performancës dhe efikasitetit të tyre, si dhe për arsye se bankat kohëve të fundit kanë investuar në zgjerimin e shërbimeve të automatizuara në mënyrë që t’ju ofrojnë klientëve mundësi për të kryer transaksionet përmes: e-banking, bankomatëve, terminaleve të shitjes.

Ndërsa, sa i përket aktivitetit të industrisë së sigurimeve, është dhënë 1 licencë parapake për një kompani të sigurimeve (“Scardian”). Janë aprovuar 128 kërkesa dhe janë refuzuar 9 kërkesa të parashtruara. Kërkesat kanë qenë duke filluar nga kryetarë / anëtarë bordi, menaxhment i lartë, deri në nivelin e agjentëve dhe licencimet për aprovime të produkteve.

Në kuadër të kësaj, nga Mbikëqyrja Financiare për sektorin e sigurimeve, gjatë vitit 2014 është aprovuar 1 kryetar bordi; 4 anëtarë të bordeve, 14 drejtorë, prej të cilëve 12 nga këta janë të kompanive të sigurimeve, 1 i Byrosë Kosovare për Sigurime dhe 1 ndërmjetësuesve për sigurime. Gjatë këtij viti janë aprovuar edhe 4 auditorë të brendshëm, që të gjithë të kompanive të sigurimeve dhe 20 aprovime për auditorë të jashtëm. Në kuadër të aprovimeve të auditorëve të jashtëm, 13 ju takojnë kompanive të sigurimeve, 5 ndërmjetësuesve për sigurime dhe pjesa tjetër byrosë dhe fondeve pensionale.

Gjithashtu, janë aprovuar 32 agjentë/operatorë, nga të cilët, 29 të kompanive sigurimeve, 2 të ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe 1 të Byrosë Kosovare për Sigurime; 4 kërkesa për aktuar; 1 përfaqësues ligjor si dhe janë aprovuar 21 zyre të reja.

Gjatë këtij viti, janë dhënë 4 licenca të reja për ndërmjetësues sigurimesh; është aprovuar 1 kërkesë për shpërndarje dividendë; aprovimi i 1 kërkesë për statut; 3 kërkesa për aprovim të ndryshimit të tarifave për produkte; si dhe aprovimi i 12 kërkesave për zhvendosje të zyrave.

Shpërndarja gjeografike e degëve dhe nëndegëve të bankave përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit. Vazhdon të evidentohet përqendrim më i madh i degëve dhe nëndegëve bankare në Regjionin e Prishtinës (35%) ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (25%).

Sa i përket institucioneve tjera financiare, në fund të vitit 2014, kanë operuar 13 institucione mikro financiare, të shpërndara thuajse në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

IMF, në fund të vitit 2014, aktivitetin e tyre e ushtruan në 98 degë/nëndegë të shpërndara brenda territorit të vendit. Gjatë vitit 2014 janë aprovuar hapja e 3 nëndegëve si dhe 9 zhvendosje të degëve dhe nëndegëve të IMF-ve.

Në fund të vitit 2014 numri i institucioneve financiare jobankare, që operuan në Kosovë arriti në 47, prej të cilave 4 me kapital të huaj e 43 me kapital vendor. Sipas aktiviteteve janë të ndara si në vijim: 2 institucione kryejnë aktivitetin e kredidhënies, 2 institucione aktivitet të lizingut, 1 institucion aktivitet të faktoringut, 6 institucione shërbimin e transferit dhe pagesave¹¹ si dhe 36 institucione aktivitetin e këmbimit valutor.

Në përgjigje të kërkesave të subjekteve për kryerjen e aktivitetit financiar të këmbimit valutor është rritur në vazhdimësi, në fund të vitit 2014, numri i zyrave të këmbimit valutor arriti në 36 ose 3 zyra këmbimi valutor më shumë se vitin e kaluar. Gjatë vitit 2014, të gjitha kërkesat e ardhura nga subjektet u finalizuan me dhënien e regjistrimit për ushtrimin e aktivitetit të këmbimit valutor. Për periudhën kohore 2004-2014, vitet 2006, 2007 dhe 2014 shënuan rritjen më të madhe të numrit të zyrave të këmbimit valutor.

¹¹ Katër institucione kryejnë aktivitetin e pagesave dhe transferit, 1 institucion kryen vetëm aktivitetin e transferit dhe 1 institucion kryen vetëm aktivitetin e pagesave;

Gjithashtu, aprovime u dhanë edhe për kërkesat e zyrave të këmbimit valutor të regjistruara, për zgjerimin e veprimtarisë së tyre nëpërmjet hapjes së zyrave të reja (3 zyre).

Për sa i takon shpërndarjes gjeografike të zyrave të këmbimit valutor, ato janë të lokalizuara dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre po thuajse në të gjithë vendin, me përjashtim të Regjionit të Mitrovicës. Përqendrimi më i madh i tyre mbetet në Regjionin e Gjilanit dhe atë të Pejës. Zgjerimi i shtrirjes gjeografike të subjekteve të regjistruara të institucioneve, që kryejnë aktivitetin e këmbimit valutor gjatë vitit 2014 i takojnë Regjionit të Gjilanit (tri regjistrimet e reja gjatë këtij viti i takojnë këtij regjioni).

Gjatë vitit 2014 ndryshimet në pronësinë e bankave dhe institucioneve financiare, për të cilat ndryshime sipas kërkesave ligjore, institucionet i kanë bërë njoftimet përkatëse BQK-së.

4.2.2 Ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare

Si licencues, rregullues dhe mbikëqyrës i institucioneve financiare dhe e autorizuar sipas ligjeve në fuqi, Banka Qendrore e Kosovës, respektivisht Mbikëqyrja Financiare ka rolin kyç në mbrojtjen e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në Kosovë.

Në kuadër të Mbikëqyrjes Financiare funksionon divizioni i cili bën pranimin, sistemimin dhe shqyrtimin e ankesave për pajtueshmerinë e aktiviteteve të institucioneve financiare me ligjet dhe rregullat në fuqi, si dhe standardet që orientojnë mbikëqyrjen financiare duke përcjell dhe monitoruar sjelljen në treg të tyre. Objektivi i këtij divizioni është vendosja e bazave për shpalosjen adekuate ndaj konsumatorëve dhe mbrojtjen e konsumatorëve të shërbimeve dhe produkteve të institucioneve financiare në Kosovë. Ky divizion shqyrton ankesat e adresuara nga policëmbajtësit, depozitorët / huamarrësit dhe shfrytëzuesit e të gjitha shërbimeve dhe produkteve të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja, si dhe furnizon mbikëqyrjen dhe rregullativën me rekomandimet konkrete për praktikën e identifikuar, si jo të favorshme për konsumatorët për adresimin e tyre me veprime të ardhshme.

Aktiviteti i Mbikëqyrjes Financiare në respekt trajtimi të ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare gjatë vitit 2014 përfshinë:

- Vazhdimin e implementimit të projektit për fushën e mbrojtjes së konsumatorëve të shërbimeve financiare që për vitin 2014 përfshinë:
 - a) Aprovimin e rregullores për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave;
 - b) Hartimin e procedurës së brendshme të trajtimit të ankesave në BQK, e cila pritet që të aprovohet gjatë vitit 2015;
 - c) Hartimin e rregullores mbi kërkesat për shpalosje e cila pritet që të aprovohet gjatë vitit 2015;
 - d) Është përpiluar dhe pritet që së shpejti të publikohet broshura në faqen zyrtare të BQK-së, e cila do të informojë saktë konsumatorin për mënyrën e adresimit të ankesave të tyre në Bankën Qendrore.
- Janë shqyrtuar rreth 353 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizikë e juridikë):
 - a) Totali i ankesave për banka, IMF, IFJB e fonde pensionale të adresuara në BQK për vitin 2014 ka qenë 158, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë: kategorizimi në regjistrin e

kredive (9%), bllokimin e llogarive (20%) dhe çështje të ndryshme të ndërlidhura me kredi (33%).

- b) Totali i ankesave ndaj kompanive të sigurimeve të adresuara në BQK për vitin 2014 ka qenë 195. Ankesat më të shpeshta kanë të bëjnë me mos kompensimin me kohë të dëmit material dhe jo material nga TPL (59% e total ankesave), aplikimin e malusit (32% e total ankesave), mos kompensimin e shpenzimeve mjekësore nga sigurimi shëndetësor (14%).

Tabela 4. Numri i ankesave sipas institucioneve

Institucionet	Numri i ankesave	Pjesëmarrja
Bankat komerciale	133	38%
Kompanitë e sigurimeve	195	55%
Institucionet mikro financiare	23	7%
Institucionet financiare jo bankare	1	0%
Fondet pensionale	1	0%
Totali i ankesave	353	100%

Burimi: BQK (2015)


Gjithashtu, duhet të theksohet se një numër i madh i ankesave janë zgjidhur në favor të palëve dhe mbase kjo ka qenë arsyeja e rritjes së volumit të ankesave drejtuar BQK-së.

Nga të dhënat e mësipërme vërejmë se ankesat ndaj kompanive të sigurimeve (55.3% e total ankesave) janë në numër më të madh krahasuar me bankat komerciale apo institucionet e tjera mikrofinanciare e institucionet financiare jobankare. Kjo vjen si rezultat i Rregullores mbi Implementimin e Sistemit Bonus – Malus sidomos implementimi te personat privatë të cilët kanë në pronësi të tyre më shumë se një automjet, si dhe ankesat për mos kompensim të dëmeve qoftë materiale apo jomateriale, më saktësisht ankesat kanë të bëjnë me vonesë në pagesa të dëmeve materiale.

Në tabelën e mëposhtme është i paraqitur edhe numri i ankesave të shqyrtuara nga Divizioni i ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare nëpër vite:

Nga të dhënat e mësipërme vërejmë një trend të rritjes së numrit të ankesave. Siç shihet nga grafiku 9, numri më i lartë i ankesave ishte gjatë vitit 2014, e cila vjen si rezultat i krijimit të infrastrukturës dhe funksionalizimit të Divizionit të ankesave.

Figura 42. Numri i ankesave ndaj institucioneve financiare



Burimi: BQK (2015)

Tabela 5. Numri i ankesave sipas viteve

Industria financiare	Numri i ankesave		
	2014	2013	2012
Bankat komerciale/IMF, IFJB, Fondet pensionale	158	74	36
Kompanitë e sigurimeve	195	153	70
Total	353	227	106

Burimi: BQK (2015)

Në të njëjtën kohë, rritja e numrit të ankesave, ka ardhur edhe si rezultat i vetëdijesimit të shfrytëzuesve financiarë mbi të drejtën e tyre për ushtrimin e ankesës.

4.3. Mbikëqyrja bankare

4.3.1 Ekzaminimet në vend të bankave

Ekzaminimet në vend, si pjesë mjaft e rëndësishme e procesit të mbikëqyrjes së bankave, kanë pasur qëllim shqyrtimin dhe vlerësimin nga afër të profilit të rrezikut të bankave.

Gjatë vitit 2014 janë realizuar gjithsej 11 ekzaminime të bankave, prej të cilave 3 ekzaminime të plota dhe 8 ekzaminime të fokusuara.

Ekzaminimet në vend kanë pasur për qëllim vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të bankave, duke u fokusuar në vlerësimin e rreziqeve bankare si: rrezikun kreditor, likuiditetit, tregut dhe rrezikun operacional, të cilat janë kryer sipas qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik.

Gjithashtu, ekzaminimet kanë përfshirë edhe vlerësimin e kontroleve të brendshme, pajtueshmërinë me kornizën ligjore në fuqi të BQK-së, respektivisht pajtueshmërinë me rregulloret bankare, praktikat bankare, vlerësimin e kapitalit, vlerësimin e politikave dhe procedurave, menaxhmentin, fitimet si dhe ekzaminimin e fushës së teknologjisë informative. Rreziku kryesor në kuadër të sektorit bankar gjatë vitit vazhdon të mbetet rreziku kreditor.

Nga ekzaminimet ka rezultuar se bankat janë të shëndosha dhe stabile si dhe janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore të BQK-së.

4.3.2 Mbikëqyrja e bazuar në rrezik për institucionet bankare

Me qëllim të zbatimit të strategjisë mbikëqyrëse dhe përafrimit të standardeve dhe praktikave mbikëqyrëse të Bashkimit Evropian, gjatë vitit 2014 nga BQK-ja është përpiluar dhe finalizuar metodologjia e re mbikëqyrëse - mbikëqyrja e bazuar në rrezik. Kjo metodologji, ka si qëllim identifikimin e rreziqeve kritike dhe potenciale, me të cilat ballafaqohet një institucion, ku përmes rishikimit të fokusuar nga mbikëqyrja, vlerësohet menaxhimi i këtyre rreziqeve nga ana e institucioneve dhe aftësia financiare e institucionit për të përballuar pasojat potenciale negative. Me qëllim të zbatimit të kësaj metodologjie është përpiluar manuali i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, i cili në të njëjtën kohë edhe është testuar në dy bankat sistemike në sektorin bankar në vend. Si rrjedhojë, ka ndryshuar edhe struktura e raportit të ekzaminimit, duke u bazuar në llojet e rreziqeve bankare si: rreziku i likuiditetit, rreziku kreditor, rreziku i tregut dhe ai operacional, si dhe aplikimit të vlerësimit të bankave sipas sistemit “CAMELS”.

4.3.3 Kalimi nga Bazel I në Bazel II

Mbikëqyrja Financiare ka zgjedhur një qasje graduale drejt përafrimit me standardet ndërkombëtare me fokus të veçantë direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, për mbikëqyrjen e bankave, të cilat rregullojnë veprimtaritë e institucioneve kreditore dhe përcaktojnë kërkesat për kapitalin e tyre. Ky është një proces i vazhdueshëm duke marrë në konsideratë se pas krizës së fundit financiare, standardet ndërkombëtare të kapitalit të bankave,

të njohura si Korniza Ndërkombëtare për Kapitalin (në vijim: Standardet e Basel II), kanë pësuar ndryshime, me qëllim të rishikimit të çështjeve të cilat janë konsideruar si faktor nxitës të krizës financiare, si dhe duke konsideruar zhvillimin dhe nevojat e sistemit bankar të Kosovës.

Në këtë drejtim, BQK-ja gjatë vitit 2012 dhe 2013 ka adaptuar një numër të konsiderueshëm të kërkesave për bankat në pajtim me Standardet e Basel II, sipas metodave të standardizuara, megjithatë, një harmonizim i plotë i rregullativës ekzistuese për mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave me Standardet e Basel II për kërkesat e kapitalit dhe direktivat evropiane është një projekt afatgjatë, i cili me strategjinë e BQK-së është paraparë të finalizohet gjatë periudhës 2015 – 2019.

Lëvizjet kryesore në drejtim të Standardeve të Basel II janë bërë me ndryshimet e Rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave gjatë vitit 2013, me anë të së cilës përcaktohen kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave. Kjo Rregullore ka adaptuar metodën standarde për sa i përket peshimit të mjeteve me rrezik dhe llogaritjes së rrezikun kreditor. Gjithashtu, ka adaptuar metodën e treguesit të thjeshtë dhe atë standarde për rrezikun operacional, me qëllim adresimin më të mirë të nevojave të bankave për kapital për monitorimin e këtyre dy rreziqeve, si dy nga katër rreziqet kryesore të bankave, përfshirë rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e tregut. Me anë të kësaj Rregulloreje kërkohet, që bankat të jenë të mbuluara në çdo kohë me kapitalin minimal të kërkuar, duke plotësuar kërkesat minimale të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit (12 %).

Mësimet e krizës së vitit 2008 nxorën në pah nevojën për rishikimin e Standardeve të Basel II, që sot në termat e një kornize të rishikuar njihen si Standardet e Basel III (ose Direktiva IV dhe Rregullorja e kapitalit, të njohura si “Single Rule Book”). Këto ndryshime kryesisht përfshijnë rishikimin e kërkesave për kapital dhe elementeve përbërëse të kapitalit me qëllim të ngritjes së cilësisë, vendosjen e kërkesave për qëllime të monitorimit të rrezikut të likuiditetit dhe raportit të leverazhit.

Sipas planit të Mbikëqyrjes Bankare për adaptimin e Standardeve të Basel II dhe Direktivat e BE-së, do të vazhdohet me plotësimin e kornizës rregullative për të adaptuar kërkesat e nevojshme të nxjerra nga këto standarde edhe gjatë viteve në vijim, me fokus të veçantë në adaptimin e plotë të shtyllës së parë. Me këto ndryshime parashihet një adaptim i plotë i metodës së standardizuar për peshimin me rrezik të ekspozimeve, duke zgjeruar numrin e klasave të ekspozimit për të reflektuar në zhvillimet e tregut bankar në Kosovë, si dhe duke adaptuar parimet dhe rregullat më të sofistikuara për përllogaritjen e ekspozimeve të peshuara me rrezik, për secilën klasë ekspozimi; parimet dhe metodat e njohjes së teknikave të zbutjes (faktorëve mitigues) së rrezikut të kredisë; si dhe do të adaptohen kërkesat për kapital për mbulimin e rrezikut të tregut dhe kërkesat e autoritetit mbikëqyrës për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit, bazuar në strategjitë për administrimin e rreziqeve.

Si hap tjetër i rëndësishëm i këtij projekti është edhe përshtatja e kërkesave të shtyllës së dytë – Procesit të Rishikimit Mbikëqyrës, si dhe me hyrjen në fuqi të kërkesave të reja për kapital, do të rishikohen dhe përditësohen edhe kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat, të cilat ndikojnë në rritjen e transparencës për palët e interesit dhe të cilat janë të njohura si kërkesat e Shtyllës së III të Standardeve të Basel II, me qëllim të rritjes së disiplinës së tregut përmes kërkesave për shpalesjet dhe rritjen e transparencës.

Në këtë drejtim, në shtator të vitit 2014, BQK-ja ka startuar me projektin specifik për adaptimin dhe implementimin e kornizës rregullative të njohur si Korniza Bazel-it për Kapitalin (Ang. Basel Capital Framework). Gjatë tremujorit të parë është bërë një studim i hollësishëm krahasues i kornizës ligjore dhe rregullative ekzistuese në raport me Standardet e Basel II për të identifikuar fushat të cilat nuk janë në pajtueshmëri, dhe të cilat kërkojnë ndryshime dhe plotësime të nevojshme. Gjatë dy viteve në vijim do të punohet me intensitet të shtuar në

adaptimin e Standardeve të Basel II dhe për të harmonizuar kornizën ligjore dhe rregullative me Direktivat specifike të BE-së rreth mbikëqyrjes së bankave. Duke marrë parasysh se Kosova ka një sektor bankar jo shumë kompleks në krahasim me vendet e zhvilluara, nga aspekti i zhvillimit të shërbimeve financiare dhe ekspozimit ndaj instrumenteve të avancuara financiare, vlerësohet se brenda kësaj periudhe dyvjeçare do të arrihet adaptimi i plotë i kërkesave me rëndësi dhe të aplikueshme për sektorin bankar në Kosovë, të cilat do të ndikojnë në avancimin e mëtejshëm të rregullimit dhe mbikëqyrjes së bankave në Republikën e Kosovës.

4.3.4 Iniciativa e Vjenës

Iniciativa e Vjenës është një nismë me karakter ndërkombëtar ku përveç vendeve të Bashkimit Evropian marrin pjesë edhe vendet e rajonit si: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, si dhe Serbia. Qëllimi i kryesor i kësaj iniciative është avancimi i nivelit të bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes bankare. Për më shumë, vendet e Ballkanit Perëndimor (siç janë specifikuar më lartë) kanë përfaqësuesin e tyre që momentalisht i takon Guvernatorit të Bankës së Maqedonisë, i cili ka zëvendësuar Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë.

Në këtë kontekst është konsideruar e rëndësishme së veçantë të ketë një marrëveshje në mes të vendeve të rajonit, më konkretisht, bankave qendrore / autoriteteve mbikëqyrëse të Ballkanit Perëndimor në njërin anë me Bankën Qendrore Evropiane (ECB) / Autoritetin Bankar Evropian (EBA) në anën tjetër. Janë mbajtur disa takime gjatë vitit 2014 me qëllim të harmonizimit të një drafti e ku në thelb është avancimi i bashkëpunimit me ECB / EBA-n në kontekst të shpërndarjes së informacionit mbikëqyrës. Kjo për faktin që vendet e rajonit kanë një ekspozim shumë të madh të sektorit bankar ndaj vendeve të Bashkimit Evropian. Draft-marrëveshja është dorëzuar te ECB / EBA dhe është në fazën e shqyrtimit.

4.3.5 Mbështetja Emergjente me Likuiditet

Mbështetja Emergjente me Likuiditet – në vijim ELA (anglisht: *Emergency Liquidity Assistance*) – ka të bëjë me krijimin e kornizës mbrojtëse për sektorin bankar në raste kur bankat janë solvente por jolikuide. Ky projekt i nisur në vitin 2014 paraqet një rekomandim të Fondit Monetar Ndërkombëtar në këtë fushë. Angazhimi në këtë fushë është shtrirë në dy drejtime, në atë të zhvillimit të metodologjisë dhe të rregullores. Sa i përket rregullores, ajo tashmë është draftuar / finalizuar dhe do të procedohet për miratim së shpejti. ELA parasheh krijimin e një skeme që do të përbëhet nga tri burime dhe atë: Buxheti i Kosovës, BQK-së si dhe bankat komerciale.

Në kuadër të metodologjisë janë paraparë aspektet specifike konform përgjegjësive, që dalin nga Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Po ashtu, janë definuar formularët e veçantë lidhur me ELA.

4.3.6 Stres Testet nga Mbikëqyrja Bankare

Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare gjatë vitit 2014 ka zhvilluar mikro strestestin për banka individuale. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e hershëm të rreziqeve, pasqyrimin e bankave me gjendje kritike në rast të rënieve ekonomike dhe në drejtimin (fokusimin) e ekzaminimeve në vend.

Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare planifikon që gjatë vitit 2015 të mbajë takime të rregullta në baza tremujore me përfaqësuesit e bankave komerciale sa i përket stres testit. Bankat janë të obliguara konform Rregullores për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor dhe Rregullores për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit të ndërtojnë stres testet e tyre.

Metodologjia e përdorur në stres test i referohet stresimit të kapitalizmit dhe likuiditetit të bankave duke përdorur skenarë të ndryshëm të ndërlidhur me rrezikun kreditor, rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e tregut (rrezikun nga ndryshimi i normave të interesit dhe rrezikun nga ndryshimi i normave të këmbimit). Më detajisht, analiza e ndjeshmërisë është kryer duke marrë në konsideratë:

- i. Rënien në cilësinë e portofolit kreditor;
- ii. Rrezikun e koncentrimit (dështimi i kredimarrësve më të mëdhenj);
- iii. Tronditjet sipas sektorëve të ekonomisë;
- iv. Ndryshimin e normave të interesit;
- v. Rrezikun e tërheqjes sistemike të depozitave;
- vi. Rrezikun e koncentrimit të depozitave të testuar përmes tërheqjes së depozitorëve më të mëdhenj;

Rezultatet e stres testit tregojnë që sektori bankar i Kosovës do të mbetet në përgjithësi i qëndrueshëm edhe pas tronditjeve të supozuara në mjedisin ekonomik (të reflektuar në rritjen e kredive joperformuese, dështimin e kredi-marrësve të mëdhenj etj.).

4.4. Mbikëqyrja e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare

Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar, Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare gjegjësisht Divizioni për Mbikëqyrjen e Institucioneve Mikrofinanciare dhe Jobankare, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare, gjatë vitit 2014 në vazhdimësi ka performuar një mbikëqyrje të bazuar në rrezik të institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare, duke kryer ekzaminime direkte në vend, me fokus përshtatshmërinë e kapaciteteve menaxhuese ndaj rreziqeve të këtij sektori e veçanërisht rrezikut kreditor, që ka qenë pikë referimi e aktivitetit mbikëqyrës, pajtueshmërinë e këtyre institucioneve me legjislacionin e BQK-së dhe politikat e brendshme institucionale, si dhe vazhdimin e monitorimeve nga jashtë kundrejt këtij sektori.

Po ashtu, gjatë ekzaminimeve në institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare është ekzaminuar edhe teknologjia informative, duke vlerësuar rrezikun në fushën e teknologjisë informative, ku fokus i veçantë i është kushtuar sigurisë së përgjithshme të sistemeve të Teknologjisë Informative (TI) si dhe krijimit dhe plotësimit të masave të sigurisë së sistemeve të TI-ve. Bazuar në vlerësimet e dala nga ekzaminimet në fushën e sigurisë së këtyre sistemeve, janë dhënë edhe rekomandime të caktuara për këto institucione.

Gjatë vitit 2014, janë realizuar gjithsej 6 ekzaminime në institucionet mikrofinanciare, prej të cilave 5 ekzaminime të plota dhe 1 ekzaminim i fokusuar. Sa i përket institucioneve financiare jobankare, janë realizuar tridhjetë e shtatë ekzaminime, prej të cilave një ekzaminim i plotë në një institucion financiar jobankar kreditues, 2 ekzaminime të plota në 2 institucione financiare jobankare me aktivitet të transferit të parave dhe shërbimit të pagesave dhe 34 institucione financiare jobankare me aktivitet të këmbimit të valutave, të cilat në kohën përkatëse të ekzaminimit kanë qenë të regjistruara për të operuar në vend.

Nga këto ekzaminime është evidentuar se institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare me gjithë nevojën e zhvillimit të mëtutjeshëm kanë avancuar infrastrukturën e nevojshme në funksion të menaxhimit të tyre si: politikat, procedurat dhe sistemet në identifikimin, njohjen dhe monitorimin e rreziqeve relevante në raport me kompleksitetin e tyre. Gjithashtu nga ekzaminimet e realizuara ka rezultuar se institucionet

mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare përgjithësisht janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore të BQK-së.

Pavarësisht ekzaminimeve të rregullta ky departament ka vazhduar me përcjelljen e përbushjes së rekomandimeve dhe zbatimin e urdhëresave për institucionet përkatëse mikrofinanciare dhe jobankare.

Përveç tjerash, në theks të aktivitetit mbikëqyrës ka qenë ngritja e ndërgjegjësimit të institucioneve financiare jobankare, të cilat merren me aktivitet të këmbimit të valutave, në të cilat institucione kryesisht kanë munguar kapacitetet njerëzore dhe teknike për udhëheqjen adekuate të tyre. Me identifikimet, udhëzimet dhe sugjerimet e nevojshme të BQK-së rreth mbajtjes së të dhënave, përpunimit dhe raportimit të tyre, si dhe çështjeve të tjera relevante karshi këtyre institucioneve është reflektuar pozitivisht pozicioni i tyre konform rregullativës, përkatësisht edhe raportimit në BQK.

Gjithashtu, BQK-ja në raste të identifikimeve të parregullsive serioze, mos transparencës apo mos zbatimit të kërkesave përkatëse ka ndërmarrë masa penalizuese dhe korrektuese ndaj institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare. Masat në fjalë kanë rezultuar përgjithësisht të jenë përmirësuese për institucionet në fjalë dhe sektorin mikrofinanciar dhe jobankar në përgjithësi.

4.5. Parandalimi i pastrimit të parave

Divizioni i parandalimit të pastrimit të parave (PPP) për funksionimin dhe kryerjen e aktiviteteve në përbushjen e mandatit të tij funksional, gjatë vitit 2014, pikë referuese të ushtrimit të aktivitetit kishte Planin Strategjik të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, planin vjetor të mbikëqyrjes financiare, planin vjetor dhe strategjinë dhe planin e veprimit të divizionit për parandalimin e pastrimit të parave.

Divizioni për parandalimin e pastrimit të parave në aspekt të fuqizimit të legjislacionit dhe dokumenteve operacionale ka draftuar rregulloren e re për parandalimin e pastrimit të parave dhe manualin e ekzaminimit/inspektimit. Kjo rregullore është hartuar nga ana e divizionit, duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi, praktikat ndërkombëtare të fushës dhe asistencën teknike të ekspertëve ndërkombëtarë. Ky dokument është shpërndarë për komente te sektori financiar dhe te Njësia për Inteligjencë Financiare.

Në mënyrë aktive, Divizioni ka marrë pjesë edhe në grupin punues ndërinstitutional në lidhje me hartimin e koncept dokumentit për ndryshimin e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

4.5.1 Mbikëqyrja e institucioneve financiare për PPP

Mbikëqyrja në vend e institucioneve financiare është fokusuar në aspektin e mbrojtjes së sistemeve të tyre nëpërmjet zbatimit të standardeve dhe legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Fokusi kryesor i Divizionit brenda kësaj periudhe raportuese ishte që të kryejë ekzaminimin e bankave dhe institucioneve financiare në fushën PPP/FT. Këto aktivitete janë paraparë edhe pa planin strategjik të divizionit dhe qëllimi kryesor ishte marrja e informacioneve në vend në lidhje me nivelin e masave që institucionet financiare kanë ndërmarrë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjatë vitit 2014, janë realizuar gjithsej 14 ekzaminime, prej të cilave 13 të plota dhe një ekzaminim i fokusuar në institucione financiare. Nga këto 14 ekzaminime, 7 prej tyre janë kryer

në banka, 2 në institucione mikrofinanciare dhe pjesa tjetër e ekzaminimeve është realizuar në institucione financiare jobankare.

Ekzaminimi është fokusuar në fushat kryesore, të cilat konsiderohen me rrezik më të lartë për përcaktimin e nivelit të adekuatshmërisë dhe pajtueshmërisë me legjislacionin dhe praktikën më të mira ndërkombëtare¹² për mbrojtjen e sistemit financiar nga mundësia e futjes dhe përdorimit të fondeve me origjinë të dyshimtë.

Vlerësimi i strukturës organizative të institucioneve financiare dhe raportet e menaxhmentit dhe funksionit të pajtueshmërisë brenda institucioneve financiare, ishte ndër çështjet parësore që ishte subjekt vlerësimi në rastet e ekzaminuara. Bankat kanë hartuar politika dhe procedura që krijojnë mundësi për masa efektive në PPP/FT. Bankat në pronësi të huaj, këto politika dhe procedura i kanë krijuar edhe me ndihmën e bankave amë, të cilat janë miratuar nga bordi drejtues. Në përgjithësi politikën dhe procedurat janë të qarta, të përshtatshme dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe praktikën dhe udhëzuesit ndërkombëtar për PPP/FT.

Identifikimi i klientit është njëri ndër aspektet kryesore që kërkon trajtim me kujdes dhe i kushtohet rëndësi e veçantë edhe me standarde ndërkombëtare, të cilat kërkojnë zbatimin e masave për luftë efektive kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Divizioni PPP i Bankës Qendrore gjatë ekzaminimeve në vend, ka trajtuar aspektin e identifikimit të klientit dhe përcaktimit të pronarit përfitues, sipas legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira. Nga ekzaminimi në banka, rezulton në përgjithësi se identifikimi i klientëve është në nivel të mirë.

Institucionet financiare të ekzaminuara kanë ndërmarrë masa në drejtim të shtimit të kapaciteteve humane dhe teknike brenda institucionit, duke rekrutuar personel të posaçëm për pajtueshmëri me PPP/FT dhe duke e pavarësuar nga funksioni i kontrollit të brendshëm.

Po ashtu, institucionet financiare kanë ndërmarrë masa adekuate për rritjen e efikasitetit të monitorimit, procedurës së identifikimit të klientëve dhe hapjes së llogarive të reja dhe përcaktimit të pronarit përfitues.

4.5.2 Bashkëpunimi i brendshëm dhe i jashtëm lidhur me PPP

Bashkëpunimi i veçantë ndër-institucional theksohet me Njësinë për Inteligjencë Financiare në drejtim të hartimit të akteve të ndryshme nënligjore në fushën e PPP/FT dhe në aspekt të shkëmbimit të informacioneve me interes, në pajtim me marrëveshjen për bashkëpunim dypalësh në fuqi. Divizioni i PPP-së ka përfaqësuar BQK-në edhe në projekte të ndryshme, sa i përket prezantimit të të arriturave në drejtim të fuqizimit të mbikëqyrjes së PPP/FT. Në këtë drejtim Divizioni i PPP-së ka raportuar në baza tremujore te Koordinatori Nacional kundër Krimit Ekonomik dhe te sekretariati i Strategjisë Kombëtare për luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare.

Divizioni për parandalimin e pastrimit të parave ishte edhe pjesë aktive në projektin e vlerësimit të financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës në "Projektin Kundër Krimit Ekonomik", në të cilin ka ofruar inputin e vet në mënyrë të vazhdueshme sa herë është kërkuar.

4.6. Mbikëqyrja e sigurimeve

Spektori i sigurimeve në Kosovë është i rregulluar dhe i mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK). Synimi kryesor i BQK është krijimi i një ambienti të sigurt, të shëndoshë dhe stabil me qëllim të mbrojtjes së interesave të policëmbajtëseve, palëve të

¹² Standardet ndërkombëtare të Task Forcës për veprim financiar FATF dhe direktivat e Bashkimit Evropian 3 dhe 4 për "mbrojtjen e sistemeve financiare nga mundësia e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit"

dëmtuara, investitorëve potencial si dhe të sigurojë cilësi dhe transparencë të plotë gjatë gjithë procesit të ofrimit të shërbimeve të sigurimit. Në përputhje me këtë, Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve (DMS) që funksionon në kuadër të BQK-së, ka vazhduar aktivitetin e tij mbikëqyrës në mënyrë që të sigurojë stabilitetin e sektorit të sigurimeve, duke marrë masat e duhura dhe me kohë në zbatimin e një mbikëqyrje efektive dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të sigurimeve.

Objektiv kryesor i BQK-së është mbrojtja e policëmbajtësve dhe palëve të dëmtuara, duke vepruar gjithnjë në zbatim të Ligjeve dhe Rregulloreve të BQK-së, brenda të cilave industria e sigurimeve e zhvillon aktivitetin e saj sigurues, duke i kompensuar me rregull dëmet për klientët e saj.

BQK-ja është angazhuar në adaptimin e praktikave më të mira, duke u bazuar në parimet e Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, si dhe mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, duke kontribuar kështu në rritjen e transparencës së operacioneve ndaj sektorit së sigurimeve dhe njëkohësisht rritjes së transparencës së siguroreseve ndaj publikut.

4.6.1. Monitorimi dhe analizimi i përgjithshëm në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve

Divizioni për Raportim dhe Analiza (DRA), i cili funksionon në kuadër të Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (DMS), procesin e mbikëqyrjes e zhvillon përmes sistemit të monitorimit dhe analizimit të raporteve financiare si edhe të dhënave tjera të raportuara në BQK nga sigurosesit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve, raporteve të auditorëve të jashtëm, raportet e aktuarëve të autorizuar, si edhe informacione tjera të nevojshme me kërkesa të veçanta nga BQK-ja, përfshirë këtu edhe të dhënat e nxjerra nga sistemi online për sigurimet e detyrueshme nga autopërgjegjësia dhe sigurimet kufitare.

Informacionet e pranuar nga sigurosesit përpunohen dhe analizohen nga DRA dhe rezultatet e këtyre analizave përdoren si shtyrje për Rregullimin, mbikëqyrjen dhe ndërhyrjen e BQK-se ndaj siguroreseve kur është e nevojshme me masa të përcaktuara ligjore dhe rregullativë. Rezultatet e analizave financiare përdoren edhe si bazë për të planifikuar inspektimet e ardhshme të përgjithshme dhe të fokusuara në vend (On-Site) që kryhen nga DMV.

Kështu, në analizën financiare të sektorit të sigurimeve si dhe në vlerësimin individual të performancës së siguroreseve, përdoren treguesit e sistemit IRIS (Sistemi Informativ Rregullativ i Sigurimeve) të përshtatura për sigurosesit Jo Jetë në Kosovë. Këta tregues financiarë i shërbejnë evidentimit në kohën e duhur të problemeve që mund të çojnë në përkeqësimin e një ose të disa parametrave të kompanive të sigurimit dhe industrisë në përgjithësi.

Me kujdes të veçantë është mbikëqyrur pozicionin financiar i sektorit të sigurimeve në përgjithësi dhe si rezultat i kësaj mbikëqyrje efektive nga ana e DMS, ka rezultuar me përmirësimin e vazhdueshëm të pozicionit financiar të sektorit të sigurimeve në Kosovë. Përmirësim ky i cili ka reflektuar me mbrojtje më të mirë të interesave të policëmbajtësve dhe të dëmtuarëve tjerë në përgjithësi.

Një vëmendje e posaçme i është kushtuar treguesve financiar lidhur me mjaftueshmerinë e kapitalit, margjinës minimale të solvencës, kërkesave për kapital variabël në emër të riskut sigurues si dhe të treguesve tjerë financiar të likuiditetit dhe profitabilitetit, përfshirë këtu edhe analizimin e projekt buxheteve. DRA-ja po ashtu me kujdes të veçantë e ka rishikuar nivelin e mjaftueshmerisë së provizioneve teknike, të cilat përfaqësojnë detyrimet ndaj të siguruarve, nëse janë të mjaftueshme dhe nëse në çdo kohë mbulojnë me asete likuide.

Divizioni për Raportim dhe Analiza (DRA) gjatë vitit 2014, përveç aktiviteteve të zakonshme, ka kryer edhe këto aktivitete:

Mbi bazën e projekt buxheteve, DMS ka përgatitë analiza krahasuese lidhur me performancën financiare të kompanive të sigurimeve, lidhur me ekspozimet e mundshme të rreziqeve si dhe treguesve tjerë të likuiditetit duke përgatitur raporte të rregullta tremujore mbi paralajmërimin e hershëm (EWT).

DRA ka shqyrtuar biznes planet e kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesëve të sigurimeve të cilët dëshirojnë të hyjnë në tregun e sigurimeve në Kosovë. Vetëm gjatë vitit 2014, DRA ka shqyrtuar dy biznes plane të dy aplikuesve të rinjë për sigurues dhe 2 për ndërmjetësues.

Gjatë vitit 2014, DMS ka shqyrtuar dhe analizuar planet e sanimit për kompanitë e sigurimeve të cilat kanë treguar performancë të dobët financiare. Vetëm gjatë vitit 2014, DRA ka shqyrtuar dhe analizuar planet e sanimit për dy kompani të sigurimeve të cilat kishin treguar performancë jo të mirë financiare.

DRA analizon kërkesat e kompanive të sigurimeve në lidhje me pagesën e dividendës si dhe ka shqyrtuar kërkesat e kompanive të sigurimeve në lidhje me investimet në patundshmëri.

DRA në vazhdimësi ka punuar në shqyrtimin dhe adaptimin e kornizës ligjore. Përveç draftimit të draft rregulloreve, DRA ka përgatitur udhëzues dhe manual në lidhje me shumë çështje të sigurimeve, si p.sh. për DAC, për të arkëtueshmet, etj.

4.6.2 Testi i Paralajmërimit të Hershëm

Testi i Paralajmërimit të Hershëm (TPH) i jep DRA-së mundësinë për të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nivelet relative të rrezikut në fusha të ndryshme të rreziqeve të biznesit të siguruesve. Testi i paralajmërimit të hershëm përgatitet duke përdorur të dhënat sasiore gjithnjë duke ju referuar në mënyrë të veçantë raporteve dhe tendencave të TPH dhe parametrevë financiarë bazë.

Raportet TPH konsiderohen se janë tregues kyç të fillimit të dobësimit financiar tek siguruesit të përgjithshëm. TPH u identifikuan si raporte që janë në gjendje që të parashikonin paaftësinë paguese me probabilitet të arsyeshëm përpara dështimit të siguruesit. Ato japin një kontribut mjaft të dobishëm për matjen e rrezikut të siguruesit.

Çdo test ka një diapazon normal të pranuar i cili mund të mos jetë i njëjtë në çdo vend, pasi varet nga numri i lojtarëve dhe kushteve tjera në treg. Ka pasur raste kur siguruesit të mos jenë brenda diapazoneve normale. Në këto rrethana, mbikëqyrësi mund të përdorë TPH-në për të identifikuar siguruesit që bëjnë përjashtim, d.m.th., siguruesit me rezultate jo të mira në krahasim me vlerat mesatare ose vlerat me ndodhi më të shpeshtë, por qëllimi përfundimtar duhet të jetë që të sillen të gjithë siguruesit të diapazonet normale ose afër tyre.

Në këtë drejtim, DRA ka qenë e angazhuar që përmes këtyre treguesëve të identifikojë siguruesit të cilët kanë dështuar të mirëmbajnë treguesit në linjë me treguesit mesatar. Në rastet kur ka ndodhë që një sigurues të ketë koeficient nën mesataren, atëherë DMS ka ndërmarrë veprime kundrejt këtyre siguruesëve.

4.6.3. Mbikëqyrja në vend e kompanive të sigurimit

Në përputhje me objektivat e BQK-së, respektivisht sigurimit të qëndrueshmërisë së tregut të sigurimeve dhe mbrojtjes e policëmbajtësve, BQK-ja edhe gjatë vitit 2014 ka vazhduar aktivitetin e saj duke realizuar në vazhdimësi ekzaminime në vend të siguruesve. Gjatë këtij viti, janë realizuar gjithsej 12 ekzaminime, prej të cilave tetë ekzaminime kanë qenë të plota, ndërsa katër ekzaminime kanë qenë të fokusuar.

Qëllimi i ekzaminimeve të plota ka përfshirë vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të kompanisë, duke vlerësuar pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së dhe duke vlerësuar

efektshmërinë e funksionimit të kontrolleve të brendshme, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar të kompanisë dhe mbrojtjes së policëmbajtësve. Subjekt i ekzaminimit të fokusuar ka qenë përcjellja e zbatimit të rekomandimeve nga ekzaminimet e kaluara të BQK-së, vlerësimi i menaxhimit të dëmeve si dhe shqyrtimi i pozicioneve tjera me interes.

Ekzaminimet në vend të kompanive të sigurimeve në disa raste kanë evidentuar mos pajtueshmëri me kornizën ligjore të BQK-së, si: mungesë e rolit aktiv qeverisës së bordit drejtues të kompanive, vonesa në trajtimin dhe pagesën e dëmeve, mungesë e sistemit efektiv të kontrolleve të brendshme, nivel i dobët i auditimit të brendshëm, mos respektim i standardeve të IFRS-së për disa pozicione të pasqyrave financiare, praktika jo të mira dhe të shëndosha të menaxhimit të mjeteve të kompanisë, dobësi dhe praktika jo të mira të transaksioneve me palë të ndërlidhura, nënvlerësim i rezervave teknike dhe shkelje të tarifave të produkteve të sigurimit të aprovuara nga BQK-ja. Po ashtu, bazuar në raportimet e rregullta të sigurveve në BQK, janë evidentuar raste të mosrespektimit të kërkesave ligjore në raport me nivelin minimal të kapitalit, solvencës dhe riskut sigurues.

Për të gjitha ekzaminimet e kryera, janë përgatitur raporte në të cilat janë ngritur dhe adresuar çështje të evidentuara gjatë ekzaminimit së bashku me rekomandimet përkatëse. Institucionet e ekzaminuara raportojnë në baza mujore në BQK, për marrjen e veprimeve për eliminimin/përmirësimin e të gjeturave të dala nga ekzaminimet e performuara.

Po ashtu, si rezultat i të gjeturave nga ekzaminimet e realizuara dhe performancës jo të mirë financiare, janë lëshuar vendime nga BQK-ja në të cilat janë shqiptuar gjobitje dhe masat tjera juridike të parapara me legjislacionin në fuqi si: shtimi i mjeteve për plotësim të kërkesave rregullative për kapitalin minimal të kërkuar, nivelin e solvencës dhe riskut sigurues, gjoba monetare, janë kërkuar plane të sanimit, është ndaluar përkohësisht përtëritja e policave ekzistuese të sigurimit apo lëshimi i policave të reja të sigurimit, si dhe për disa kompani është ushtruar monitorim më i përafërt i performancës financiare duke rritur frekuencën e raportimit financiar në BQK.

4.7. Mbikëqyrja e pensioneve

4.7.1 Ekzaminimet në vend të fondeve pensionale

Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar, gjatë vitit 2014 janë bërë ekzaminimet e fondeve pensionale konform planit të paraparë. Mbikëqyrja e pensioneve ka qenë konsistent me praktikën ndërkombëtare në fushën përkatëse. Duke u mbështetur në qasjen e bazuar në rrezik, vëmendje e theksuar i është kushtuar qeverisjes së fondeve, strategjisë së investimeve, efektivitetit të kontrolleve të brendshme, ruajtjes së likuiditetit adekuat dhe rreziqeve të tjera.

Gjatë vitit 2014, janë kryer ekzaminime të plota dhe të fokusuara në fondet pensionale, me qëllim të aplikimit të mbikëqyrjes më të përafërt të fondeve. Gjatë këtij viti, fondet pensionale kanë vazhduar të aplikojnë një qasje më konzervative të strategjisë së investimeve. Për më shumë, gjatë vitit të kaluar janë realizuar gjithsej 4 ekzaminime të fondeve pensionale, prej të cilave tri ekzaminime të plota dhe një ekzaminim i fokusuar.

Ekzaminimet e plota dhe të fokusuara janë realizuar në harmoni me planin vjetor të vitit 2014, të cilat kanë pasur për qëllim vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të fondeve pensionale, duke vlerësuar qeverisjen e fondeve, politikën dhe procedurat, menaxhmentin, performancën e investimeve, efektshmërinë e funksionimit të kontrolleve të brendshme, si dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së me qëllim të mbrojtjes së mjeteve pensionale të kursyera nga kontribuuesit dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të fondeve.

Ndërsa, ekzaminimet e fokusuar në fondet pensionale kanë pasur qëllim përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve nga ekzaminimet e kaluara të BQK-së, si dhe në raste të caktuar ekzaminimi i fushave që janë konsideruar me mangësi. Gjatë ekzaminimit të fokusuar, subjekt vlerësimi ka qenë administrimi dhe monitorimi i pajisjes së pjesëmarrësve me pasqyra të llogarive individuale.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS). Pjesëmarrja në këto aktivitete konsiston në zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit me organizatat e tjera relevante dhe autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve, duke shkëmbyer përvojat dhe njohuritë profesionale gjatë pjesëmarrjes në konferenca dhe trajnime të organizuara nga IOPS-i.


5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

BQK-ja gjatë vitit 2014 siguroi një ofertë kualitative dhe kuantitative të parave të gatshme për sektorin bankar me qëllim të shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme të ekonomisë dhe qytetarëve. Si rrjedhojë, funksioni dhe qëllimi strategjik i BQK-së për sigurimin e një furnizimi të duhur me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi është përmbushur në mënyrë të suksesshme.


Përgjegjësitë e BQK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme kishin të bënin me euron meqë euroja është valuta që përdoret zyrtarisht në Kosovë.

Figura 43. Furnizimi me para të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 44. Pranimi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2014 shënoi një rritje prej 19.7% krahasuar me vitin 2013. Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk patën ndonjë ndryshim të dukshëm nga viti 2013 në vitin 2014. Te kartëmonedhat euro vazhduan të dominojnë kërkesat për furnizime me denominimet – 10, 20 dhe 50 euro, ndërsa kërkesat për vëllimet e denominimeve prej 5, 100, 200 dhe 500 euro mbeten dukshëm më të ulëta. Gjatë vitit 2014 kërkesat për vëllimet e denominimeve të ulëta në vlerë prej 20 dhe 5 euro patën rritje të lehtë krahasuar me një vit më parë kurse kërkesat për vëllimin e denominimit në vlerë prej 10 euro kishte një rënie të lehtë.


Siç është paraqitur në figurat e mëposhtme, gjatë vitit 2014, BQK-ja i furnizoi bankat komerciale dhe institucionet tjera me më shumë se 11.3 milionë copë kartëmonedha euro (në shumë prej mbi 318.9 milionë euro) dhe mbi 2.6 milion copë monedha euro (në shumë rreth 0.31 milion euro).

Figura 45. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2015)

Figura 46. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)




Burimi: BQK (2015)

Furnizimi me monedha euro në vitin 2014 kryesisht u dominua nga monedhat me vlerë të vogël

nga 1 deri në 5 euro cent. Vëllimet e kërkesave për furnizim me denominime të ulëta në vlerë prej 5, 2 dhe 1 euro cent gjatë vitit 2014 shënuan një rritje grupore prej rreth 192% që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë. Vëllimet e kërkesave për furnizim me denominime prej 10 euro cent e deri tek dy euro ashtu si në vitin paraprak ishin të ulëta.


Vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rritje të konsiderueshme prej 7.8% në këtë vit krahasuar me vitin paraprak. BQK-ja pranoi mbi 16.6 milionë copë kartëmonedha (mesatarisht rreth 69,000 copë kartëmonedha në ditë) dhe 1.3 milionë copë monedha euro (mesatarisht rreth 5,600 copë monedha në ditë) si depozita në para të gatshme nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera. Të shprehura në vlerë, këto depozita arritën përafërsisht shumat prej 793.6 milionë kartëmonedha euro dhe 1.2 milionë monedha euro. Struktura e kartëmonedhave euro të pranuar gjatë vitit 2014 siç shihet në grafikun e mëposhtëm nuk pati ndonjë ndryshim të madh nga viti paraprak ndërsa struktura e monedhave të pranuar gjatë vitit 2014 gjegjësisht prerjet e monedhave prej 2 dhe 1 euro patën një vëllim të shtuar të depozitimit krahasuar me monedhat e tjera të cilat shënuan një rënie të lehtë.

Figura 47. Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2015)


Figura 48. Monedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2015)


Edhe në këtë vit, ngjashëm me vitet e kaluara, paratë e gatshme neto¹³ të depozituara ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, duke arritur në rreth 476 milionë euro, ndryshimi i tillë ishte në një masë më të lartë se sa në vitin e mëhershëm që ishte rreth 471 milionë euro. Kjo rritje ishte kryesisht si rezultat i shtimit të depozitimeve me kartëmonedha euro nga sektori i bankar.

Figura 49. Eksporti i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 50. Importi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Me që BQK-ja mban vetëm nivelin optimal të nevojshëm të parave të gatshme për kryerjen e operacioneve, tepricat janë dërguar në eurozonë, ku më pastaj përdoren për kryerjen e pagesave ndërkombëtare si dhe përmes investimeve kthehen në mjete interes-prurëse. Neto dërgesat

¹³ Depozitat minus Tërheqjet.


Figura 51. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2015)


jashtë vendit të parave të gatshme arritën shumën prej 473.9 milionë euro duke qenë më e lartë se sa një vit më herët kur ishin 460.2 milionë euro. Kjo rritje neto e dërgesave erdhi si rrjedhojë e shtimit të depozitimeve të parave të gatshme nga sektori bankar. Ecuritë e eksporteve dhe importeve të parave të gatshme gjatë viteve të fundit janë të paraqitura në dy figurat në vijim.

Figura 52. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithëj të pranuar




Burimi: BQK (2015)

Figura 53. Furnizimi me kartëmonedha të reja (numri i copëve)



Burimi: BQK (2015)

Figura 54. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithëj të furnizuara




Burimi: BQK (2015)

Ashtu sikurse në vitet e kaluara, operacionet me para të gatshme vijuan të kryhen përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat standarde të BQK-së. Gjatë vitit 2014, BQK-ja është pajisur me makineri të procesimit të fjalës së fundit të teknologjisë, makineri këto të testuara nga BQE sa i përket aspektit të konformitetit me rregullat e BQE-së. Të gjitha paratë e gatshme të pranuar nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera u procesuan (afër 16.6 milionë copë kartëmonedha euro dhe 1.3 milionë copë monedha euro) dhe u klasifikuan sipas shkallës së vjetërsimit.

Rreth 4.2 milionë copë kartëmonedha euro (25.4% e numrit të përgjithshëm kartëmonedhave euro të depozituara nga sektori bankar) gjatë vitit 2014 u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat e eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro tejet të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës. Kartëmonedhat që më së

Figura 55. Parate euro te falsifikuara te konfiskuara ne nivel te Kosoves (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2015)

hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat e eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro tejet të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës. Kartëmonedhat që më së

shumti u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi ishin ato të denominimeve 20, 10 dhe 5 euro, për shkak të qarkullimit më të madh të tyre në ekonomi.

Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit të sektorit bankar me kartëmonedha euro plotësisht të reja, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2014, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me më shumë se 4.2 milionë copë kartëmonedha të reja euro (37.5% e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara). Rreth 97% e kartëmonedhave të reja të furnizuara gjatë vitit 2014 ishin kartëmonedha të denominimeve të ulëta (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Mandej, edhe të gjitha kartëmonedhat e përdorura euro që u furnizuan ishin të një cilësie standarde të lartë (cilësia adekuate për bankomatë – ATM standard).

Për sa u përket masave kundër falsifikimit, BQK-ja ka përcjellë rastet e parave të falsifikuara. Në veçanti, vazhdoi të bashkëpunojë me autoritetet për avancimin e raportimit të parave të gatshme të dyshuara si false. Me tutje BQK-ja së bashku me Policinë e Kosovës dhe Laboratorin e Forenzikës publikuan në ueb¹⁴ faqen e BQK-së statistikat mbi paratë e falsifikuara në nivel të Republikës së Kosovës. Më tutje, materiale edukative u publikuan me qëllim të informimit të publikut të gjerë mbi tiparet e sigurisë së kartëmonedhave.

5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe institucione të tjera siç janë bankat dhe institucionet tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore) dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar në nenin 9 të ligjit Nr. 03/L-209 të BQK-së. Në vitin 2014, sikurse edhe viteve të mëparshme, këto shërbime përbëheshin kryesisht nga mirëmbajtjet e llogarive dhe kryerja e pagesave, duke përfshirë çfarëdo forme të kreditimit.

Tabela 6. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)

Llojet e transaksioneve	2010	2011	2012	2013	2014
Transaksionet me para të gatshme	423658	535189.8569	468754.7505	470786.1071	475751.972
Depozita në para të gatshme	648911	760081.605	762595.57	737523.8	794989.238
Terheqje të parave të gatshme	225253	224891.7481	293840.8195	266737.6929	319237.266
Transferet vendor	392587	462866.6305	335266.7231	581796.7298	839345.0219
Transferet vendor ardhës	1568021	1615232.041	1568574.233	1554535.112	1615753.361
Transferet vendor dales	1175434	1152365.411	1233307.51	972738.3825	776408.3396
Transferet ndërkombëtar	-408689	-558777.7251	-366873.1736	-321675.5369	-714099.0529
Transferet ndërkombëtar ardhës	326319	266705.5446	372966.6375	653710.1036	404473.1335
Transferet ndërkombëtar dales	735008	825483.2697	739839.8111	975385.6405	1118572.186

Burimi: BQK (2015)


BQK-ja ka mbështetur avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Ministrisë së Financave dhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Format e pagesave dhe mënyrat e komunikimit u janë përshtatur kërkesave të tyre. Vlen të veçohet elektronizimi i plotë i urdhërtransferëve ndërkombëtarë të Ministrisë së Financave.

Në fund të vitit 2013 dhe në fillim të vitit 2014 u bë përmbyllja e të gjitha fazave të planifikuara të projektit të SWIFT-it dhe të gjitha pagesat ndërkombëtare u realizuan përmes rrjetit SWIFT duke shkurtuar kështu kohën dhe duke ngritur efektivitetin e procesimit.

¹⁴ <http://bqk-kos.org/?id=31>


Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së u kryen në emër të dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe e pagesave vendore të BQK-së janë kryer në emër të dhe për llogari të Thesarit¹⁵.

Figura 56. Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2015)


Figura 57. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)


BQK-ja ka procesuar në emër të klientëve të saj afër 342 mijë urdhërpagesa shkuarëse vendore (një zvogëlim prej 0.7% krahasuar me vitin paraprak) dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 117.2 mijë urdhërpagesa ardhëse (një rritje prej 11.82% krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat shkuarëse vendore kapën shumën prej mbi 776.4 milionë euro (një zvogëlim prej 20.18% krahasuar me vitin paraprak) dhe urdhërpagesat ardhëse vendore kapën shumën mbi 1.61 miliardë euro (një rritje prej 3.94 përqind krahasuar me vitin paraprak). Numri dhe shumën më e madhe e transaksioneve vendore u krye nga BQK-ja me urdhër dhe për Thesarin.

Figura 58. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, numri



Burimi: BQK (2015)

Figura 59. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Sa i përket pagesave vendore dalëse, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato, kurse institucionet e sigurimit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë, të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.

Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kishte të bënte me transferët e fondeve të bankave komerciale. Të dhënat vjetore për pesë vitet e fundit mbi transaksionet ndërkombëtare janë të paraqitura në katër figurat në vijim.


¹⁵ Thesari – Ministria e Financave.

Figura 60. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2015)

Figura 61. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Më 31 dhjetor 2014, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës arritën shumën prej 155.5 milionë euro, ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej 557.8 milionë euro.

Në mesin e llogarimbajtësve të tjerë, bankat komerciale dhe institucionet e sigurimit janë më të rëndësishmit sa i përket nivelit të depozitave në BQK. Depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimeve që mbahen në BQK, kryesisht kanë të bëjnë me obligimet e tyre rregullatore. Ato përbënin 26 për qind të gjithsejt depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2014. Më 31 dhjetor 2014, depozitat e bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit ishin në shumën prej 321.7 milionë euro.

Tabela 7. Niveli i depozitave sipas llojeve të llogarive (në mijëra euro)

Llojet e llogarive	2010	2011	2012	2013	2014
I. Llogaritë rrjedhëse	441,758	677,943	1,146,445	1,266,824	1,173,404
Agjencia Kosovare e Privatizimit	65,089	265,310	549,403	530,328	557,801
Institucionet Qeveritare	48,796	89,326	73,697	12,888	90,481
Bankat Komerciale	203,558	209,700	302,147	327,843	315,932
Institucionet Ndërkombëtare (FMN, BB)	76,990	73,393	169,341	156,479	155,885
TKPK + Institucionet Publike (PTK, KEK, etj)	38,131	20,953	27,339	209,655	20,845
FSDK + Të tjera	1,667	10,770	19,060	24,349	26,385
Kompanitë e Sigurimeve	5,780	7,693	4,983	4,955	5,738
Institucionet Ndërkombëtare (UNMIK, EULEX etj)	1,678	729	406	260	268
Fondet Pensionale Suplementare	68	68	68	68	68
II. Depozitat e afatizuar	597,105	425,453	152,000	133,000	65,000
Agjencia Kosovare e Privatizimit	457,105	320,453	0	20,000	0
Institucionet Qeveritare	140,000	105,000	152,000	113,000	65,000
Bankat Komerciale	0	0	0	0	0
Institucionet Ndërkombëtare (FMN, BB)	0	0	0	0	0
TKPK + Institucionet Publike (PTK, KEK, etj)	0	0	0	0	0
FSDK + Të tjera	0	0	0	0	0
Kompanitë e Sigurimeve	0	0	0	0	0
Institucionet Ndërkombëtare (UNMIK, EULEX etj)	0	0	0	0	0
Fondet Pensionale Suplementare	0	0	0	0	0
III. Letrat me vlerë të qeverisë	84,746.55	0.00	45,995.19	80,950.60	0.00
Institucionet Qeveritare	84,747	0	45,995	80,951	0
Gjithsej gjendja	1,123,609	1,103,395	1,344,440	1,480,775	1,238,404

Burimi: BQK (2015)

Tabela 8. Niveli i depozitave klientëve kryesor (në mijëra euro)

Gjendja e llogarive	2010	2011	2012	2013	2014
Gjithsej gjendja	1,123,609	1,103,395	1,344,440	1,480,775	1,238,404
Institucionet Qeveritare	273,543	194,326	271,692	206,838	155,481
Agjencia Kosovare e Privatizimit	522,193	585,763	549,403	550,328	557,801
Bankat Komerciale	203,558	209,700	302,147	327,843	315,932
Të tjera	124,315	113,607	221,198	395,765	209,190

Burimi: BQK (2015)

5.3. Sistemi i Pagesave

Një prej funksioneve primare të BQK-së është funksionimi i një sistemi efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të pagesave në vend, si shtyllë kyçe e infrastrukturës financiare dhe ekonomisë së një vendi.


Gjatë vitit 2014, Sistemi Ndërbankar i Pagesave është karakterizuar me qëndrueshmëri, siguri dhe efikasitet të lartë ndër-operues, duke realizuar kliringun dhe shlyerjet me kohë dhe në pajtim me standardet dhe procedurat përkatëse. Po ashtu, Regjistri i Poseduesve të Llogarive Bankare ka funksionuar mirë dhe është shënuar rritje në qasjen e përdoruesve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Një ndër aktivitetet me rëndësi në fushën e sistemeve të pagesave, ishte rishikimi dhe harmonizimi i rregullativës përkatëse, duke përforcuar kompetencat mbikëqyrëse të sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregut në industrinë bankare.

5.3.1 Operimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar


Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN) funksionon si një sistem i cili mundëson procesimin ndërbankar të një sërë instrumentesh të pagesave.

Figura 62. Numri i transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2015)

Figura 63. Vlera e transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2015)

Gjatë vitit 2014, është funksionalizuar në tërësi pjesëmarrja e "Isbank" në SEKN si dhe është mundësuar procesi i raportimit elektronik për Departamentin e Tatimit në Pronë përmes Departamentit të Thesarit/MF.


Treguesit statistikorë të aktivitetit të SEKN-së kanë reflektuar me një rritje në vëllim dhe vlerë të transaksioneve, paraqitur si në vijim:

Numri dhe vlera e transaksioneve në SEKN vazhdon të rritet. Janë procesuar rreth 9.1 milionë transaksione me vlerë totale prej afërsisht 6.8 miliardë euro. Rritja e vazhdueshme në vëllim dhe

vlerë të transaksioneve ndërbankare të SEKN-së pasqyron rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besueshmërisë në sistemin bankar.


Krahasuar me transaksionet e SEKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve është rritur për 33.2% dhe vlera e transaksioneve është rritur për 6.14%.

Figura 64. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2015)

Figura 65. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN




Burimi: BQK (2015)

Ndër faktorët që kanë ndikuar në rritjen e numrit të transaksioneve të SEKN-së ishte procesimi i pagave të shërbyesve të administratës publike, pagesave për kategoritë e skemave sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,¹⁶ si dhe pagesat Kos Giro për kompani të shërbimeve publike. Ndërsa, në rritje të vlerës kanë ndikuar kryesisht transaksionet e letrave me vlerë.


Në kuadër të SEKN-së realizohen disa kategori të veçanta të pagesave, si: pagesat e rregullta (individuale dhe masive), pagesa prioritare (individuale dhe masive), Kos-Giro, Debitimi Direkt si dhe shlyerjet e letrave me vlerë. Niveli i rritjes si për nga vëllimi ashtu edhe vlera e këtyre kategorive të pagesave për vitet 2013 dhe 2014 është paraqitur në figurat si në vijim.

Figura 66. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2015)

Figura 67. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2015)

Pagesat e rregullta (individuale dhe masive) përbëjnë rreth 52.63 për qind të vëllimit dhe rreth 56.61 për qind të vlerës së transaksioneve të SEKN-së.

Transaksionet Kos-Giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Transaksionet Kos-Giro janë të destinuar për arkëtimet e standardizuara dhe të automatizuara të entiteteve të mëdha faturuese. Gjatë vitit 2014, numri i pagesave Kos-Giro është rritur për 46.42%, ndërsa vlera e tyre shënoi rritje prej rreth 5.48%.

¹⁶ Në sistemin e SEKN-së, gjatë vitit 2014 janë realizuar pagesat e të gjitha pagave të sektorit publik si dhe gjashtë skemat pensionale të MPMS, përderisa krahasuar me vitin 2013, ishte filluar nga muaji prill me pagesë të pagave dhe që nga korriku, 2013 për pagesa të pensione në SEKN.

Transaksionet prioritare (urgjente) procesohen dhe shlyhen menjëherë gjatë orarit të punës në baza bruto. Ngjashëm me transaksionet e rregullta, transaksionet prioritare kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale ose si transaksione masive. Ato ende përfaqësojnë një pjesë të vogël të transaksioneve të gjithmbarshme të SEKN-së. Në vitin 2014, sa i përket vëllimit, ato përfaqësuan më pak se 1% të transaksioneve, ndërsa sa i përket vlerës, ato përfaqësuan mbi 9.76% të transaksioneve. Ky lloj i pagesave vazhdon të përdoret kryesisht për kryerjen e pagesave urgjente dhe të atyre me vlera më të mëdha.

Debitimi Direkt si instrument dhe skemë e re e pagesave në Kosovë është duke u përdorur në masë të vogël kundrejt instrumenteve tjera të pagesave. Kështu që gjatë vitit 2014, ky lloj i transaksioneve përfaqësonte në total më pak se 1% të vëllimit dhe vlerës së transaksioneve të SEKN-së.

Vlera e përgjithshme e transaksioneve të shlyera në SEKN ka qenë 6,830,312,337€, ku tri institucionet e para me vlerë më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 63.69% të vlerës së përgjithshme, ndërsa të gjitha institucionet tjera zënë 36.31%. Sa i përket numrit të transfereve të iniciuara, nga numri i përgjithshëm i tyre prej 9,052,162, tri institucionet e para me numër më të madh të transfereve të iniciuara zënë 59.74% të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë institucionet tjera zënë 40.26%. Një pasqyrë e detajuar e treguesve të përqendrimit të pjesëmarrjes së institucioneve më aktive në SEKN gjatë vitit 2014, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem, është paraqitur në tabelën 9.

Tabela 9. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e pranuar/hyrëse në SEKN

Sistemi SEKN	Vëllimi	Vlera
Tre banka	63.25%	69.13%
Gjashtë bankat tjera	36.75%	30.87%
Gjithsejt	9,052,162	6,832,448,403

Burimi: BQK (2015)

Sa i përket transfereve të pranuar, tri institucionet me vlera më të mëdha të transfereve të pranuar zënë 69.13% të shumës së përgjithshme, ndërsa gjithë institucionet tjera zënë 30.87%. Ndërsa nga numri i përgjithshëm i transfereve të pranuar, tri institucionet e para zënë 63.25% të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjitha institucionet tjera 36.75%.

Tabela 10. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e pranuar/hyrëse në SEKN

Sistemi SEKN	Vëllimi	Vlera
Tre banka	59.74%	63.69%
Gjashtë bankat tjera	40.26%	36.31%
Gjithsejt	9,052,162	6,832,448,403

Burimi: BQK (2015)

5.3.2 Mbikëqyrja, analizat dhe zhvillimet e sistemeve të pagesave

Ligji për Sistemin e Pagesave në Kosovë autorizon BQK-në për mbikëqyrje të sistemit të pagesave, për të siguruar efikasitetin, besueshmërinë si dhe pajtueshmërinë e tij me dispozitat ligjore, ruajtjen e besimit të publikut në sistemin dhe instrumentet e pagesave si dhe promovimin e konkurrencës së lirë në tregun e shërbimeve të pagesave.

Në kuadër të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave, janë ndërmarrë aktivitete si dhe është rritur dhe zhvilluar funksioni përkatës në linjë me parimet dhe standardet ndërkombëtare. Janë bërë publikime të rregullta të treguesve analitikë për instrumente të pagesave në Kosovë.¹⁷

Po ashtu, gjatë këtij viti janë kryer inspektime të rregullta në banka me qëllim monitorimin e procesimit të pagesave sipas procedurave të përcaktuara me dispozita ligjore.

Sa i përket fushës së analizave në kuadër të sistemeve të pagesave, ka vazhduar publikimi i analizave të rregullta rreth zhvillimeve të sistemeve të pagesave, si dhe materialeve tjera informative me karakter edukimi financiar për publikun. Gjatë këtij viti janë publikuar këto analiza:

- Analiza mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë (në baza tremujore);
- Analizimin e zhvillimeve të skemës së pagesave Kos Giro dhe e Debitimit Direkt;
- Analiza për reduktimin e transkacioneve në para të gatshme;
- Raporte dhe analiza krahasuese mes Kosovës dhe vendeve në rajon mbi zhvillimet e infrastrukturës së sistemeve të pagesave.


Në kuadër të avancimit të bazës ligjore, janë rishikuar dhe miratuar këto rregullore dhe udhëzime:

- a) Rregullore për Sistemin e Numrave Standardë të Llogarive Bankare,
- b) Rregullore mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave,
- c) Rregullore për Pagesat Ndërkombëtare,
- d) Udhëzimi për Operimin e Skemës së Debitimit Direkt dhe
- e) Udhëzimi për Operim të Skemës së Pagesave Kos Giro.

5.3.3 Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave


Sa i përket instrumenteve të pagesave dhe infrastrukturës bankare të shërbimeve të pagesave, vlen të theksohet se paraqitet një zhvillim i qëndrueshëm, i prirë me rritje dhe zgjerim si në aplikim të teknologjive inovative ashtu edhe në përdorim të instrumenteve elektronike.

Figura 68. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2015)

Figura 69. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit




Burimi: BQK (2015)

Bazuar në metodologjinë për raportimin e instrumenteve të pagesave, bankat komerciale kanë vazhduar raportimin e rregullt të statistikave për instrumente të pagesave në Departamentin e Sistemit të Pagesave në BQK.


¹⁷ Parimet për Infrastrukturën e Tregut Financiar, BIS, Prill 2012 (<http://www.bis.org/cpmi/publ/d101a.pdf>).

Figura 70. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2015)

Figura 71. Numri i terminaleve POS




Burimi: BQK (2015)

Nga të dhënat e mbledhura dhe të analizuar gjatë vitit 2014 është krijuar një pasqyrë e gjerë mbi nivelin e zhvillimit të sistemit të pagesave.

Në vazhdimësi, numri i kartelave me funksion pagese është rritur. Rrjeti i terminaleve të bankave në Kosovë po ashtu është në rritje. Në dhjetor të vitit 2014, janë raportuar 678,090 kartela me funksion debiti, 121,652 kartela me funksion krediti dhe 13,284 kartela me parapagim. Këto kartela kanë mundur të përdoren në 498 terminale ATM (bankomat) dhe 9,349 terminale POS (pika të shitjes) të vendosura nëpër Kosovë.


Në krahasim me vitin paraprak, numri i terminaleve ATM është rritur për 0.4% dhe numri i terminaleve POS me 3.1%.

Figura 72. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2015)

Figura 73. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2015)

Viti 2014 u karakterizua me një tendencë në rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Numri i pagesave e-banking brenda vendit u rrit për 49.5%, ndërsa vlera e tyre u rrit për 58%. Numri i pagesave në POS terminale është rritur për 25.5%, ndërsa vlera e tyre është rritur për 24.04%. Po ashtu edhe tërheqjet në ATM terminale u karakterizuan me rritje. Numri i tërheqjeve në ATM gjatë vitit 2014 është rritur për rreth 7.29% , ndërsa vlera e tërheqjeve është rritur për 6.41% .

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2014, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve ishte rreth 1.92 milion, që paraqet një rritje prej 3.35% krahasuar me fundin e vitit 2013. Rreth 98.37% e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.63 % janë të jorezidentëve.

Nga totali i llogarive, në fund të vitit 2014, rreth 157.7 mijë llogari kishin qasje “online” nga interneti për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë, duke shënuar një rritje prej 20.1% në krahasim me vitin 2013.

Tabela 11. Numri i llogarive

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2012	2013	2014	2012	2013	2014
Llogaritë e klientëve (1+2)	1,824,266	1,855,383	1,917,513	97,089	131,365	157,761
1-Llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.40%	98.62%	98.37%	97.00%	97.10%	97.22%
a-Individuale (%)	93.20%	93.25%	93.18%	78.70%	80.11%	79.66%
b-Kompani (%)	6.80%	6.75%	6.82%	21.30%	19.89%	20.34%
2-Llogari të jo-rezidentëve (c+d) (%)	1.60%	1.38%	1.63%	3.00%	2.90%	2.78%
c-Individuale (%)	96.50%	96.35%	96.60%	94.90%	92.50%	91.99%
d-Kompani (%)	3.50%	3.95%	3.40%	5.10%	7.50%	8.01%

Burimi: BQK (2015), Raportimet e bankave sipas “Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave”

Bazuar në të dhënat statistikore zhvillimi i infrastrukturës ka një ritëm më të shpejt krahasuar me vendet e rajonit. Inkurajues mbetet trendi i shpejt i rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Sa i përket krahasimit të Kosovës me vendet në rajon, shihet se trendi i shpejtë i zhvillimit gjatë viteve të fundit ka ndikuar, që sot Kosova të ketë përmirësuar pozitën e saj krahasuar me vendet fqinje.

Tabela 12. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave¹⁸

Përshkrimi	Banorë	ATM për milion banorë	POS për milion banorë	Kredit Kartelat për milion banorë	Debit Kartelat për milion banorë	E-Banking për milion banorë
Kosova	1.82	273	4,984	60,073	354,422	72,179
Shqipëria	2.89	284	1,961	22,295	256,446	39,422
Republika Çeke	10.52	418	9,099	153,011	834,348	-
Turqia	75.63	555	30,328	751,490	1,324,408	-
Slovenia	2.06	862	17,279	54,650	1,228,244	-
Bullgaria	7.28	803	9,719	110,207	952,494	-
Hungaria	9.91	487	9,162	136,330	766,442	-
Bosnja	3.84	356	5,313	54,442	406,843	31,907
Mali i Zi	0.62	539	17,921	79,498	560,600	77,766
Kroacia	4.26	968	21,648	84,538	1,596,006	-
Maqedonia	2.06	451	18,042	152,119	577,159	227,232

Burimi: BQK (2015) dhe bankat qendrore apo autoritetet mbikëqyrëse të shteteve përkatëse


5.4. Menaxhimi i Mjeteve

Sipas Politikës së Investimeve të aprovuar nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së, objektivat kryesore të përcaktuara gjatë menaxhimit të mjeteve janë: siguria, likuiditeti dhe kthimi në investime.

Përgjatë vitit 2014, të gjitha mjetet janë investuar në instrumente financiare që hyjnë në kategorinë e instrumenteve të sigurta, likuide dhe me vlerësim kreditor superior.

Kategoritë e instrumenteve financiare në të cilat janë investuar mjetet janë:

Figura 74. Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së



Burimi: BQK (2015)

¹⁸ Të dhënat në tabelë janë nga viti 2013 pasi që shumica e vendeve në rajon të dhënat për vitin 2014 nuk i kanë publikuar ende.


- depozitat e afatizuara bankare me afat maturimi deri në një vit, përkatësisht euro-depozita bankare të afatizuara me banka komerciale dhe qendrore të shteteve të Eurozonës;
- bono të thesarit të shteteve të Eurozonës me afat maturimi deri në një vit dhe;
- obligacione shtetërore të shteteve të Eurozonës me afat maturimi deri në tre vite.

Sipas kategorive të mjeteve të përshkruara më lartë, gjatë vitit 2014 BQK ka mbajtur një shpërndarje adekuate në raport me gjendjen e tregut të Eurozonës, përkundër vështirësive në tregun financiar si rezultat i ndërhyrjes së Bankës Qendrore Evropiane (BQE) përmes politikës monetare nga qershori i vitit 2014, ku normat në depozita u vendosën në nivele negative. BQK ka arritur të realizojë investime me kthime pozitive duke i respektuar objektivat primare të Politikës për Investime.

Figura 74 paraqet raportin e shpërndarjes së mjeteve nga portofolio e BQK-së sipas tipit të instrumentit. Trendi i shpërndarjes së portfolios është relativisht i pandryshueshëm në gjashtëmuajorin e parë të vitit, përveç muajit qershor që u karakterizua me paqëndrueshmëri të lartë të normave në tregun ndërbankar të parasë si rezultat i veprimeve të BQE-së të përshkruara më lartë. Ndërsa, pjesa e dytë e vitit është karakterizuar me pjesëmarrje të njëjtë me bono të thesarit dhe obligacione qeveritare përgjatë muajve. Në këtë raport përjashtim kemi në muajin dhjetor, ku paraqitet rënie e investimeve në letrat me vlerë. Kjo pjesëmarrje më e ulët në investimin e letrave me vlerë gjatë këtij muaji është si rrjedhojë e kushteve të pa favorshme të tregut i cili nuk ka ofruar norma pozitive të kthimit për bono thesari dhe obligacione të emetuara me afat maturimi deri në tre vite sipas Politikës së Investimeve të BQK-së.


Sa i përket depozitave, shihet që në gjashtëmuajorin e parë kemi pjesëmarrje më të lartë të depozitave me banka qendrore dhe banka komerciale të cilat kanë shënuar ngritje të pjesëmarrjes, duke përfunduar vitin me pjesëmarrje prej 57% nga totali i mjeteve e investuara në portofolio.

Figura 75. Shuma e përgjithshme e mjeteve në portfolion e investimeve e shprehur në milion euro në çdo fundvit




Burimi: BQK(2015)

Figura 76. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit



Burimi: BQK(2015)

Figura 77. Norma e kthimit në depozita të investuara nga BQK dhe norma EURIBOR 1-mujor



Burimi: BQK(2015)

Shuma e mjeteve nën menaxhim të BQK-së është zvogëluar për 18% gjatë vitit 2014 në krahasim me vitin paraprak.

Në figurën 76 pasqyrohet portfolio investuese sipas kategorive të instrumenteve financiare për vitin 2014 krahasuar me vitet paraprake, ku trendi i shpërndarjes më të madhe të mjeteve të plasuar nëpër kategori të ndryshme investuese.

5.4.1. Performanca e portfolios për vitin 2014

Viti 2014 është karakterizuar me vazhdimësi të krizës financiare në Eurozonë. Kriza e çmimeve të naftës ka rënduar edhe më shumë trendin disinflacionist të çmimeve në Eurosistem, duke detyruar Bankën Qendrore Evropiane (BQE) të reduktojë dy herë normat kryesore të financimit, për të kthyer inflacionin drejt nivelit të dëshiruar prej rreth 2%. Më 11 qershor, për herë të parë në histori të saj, BQE ka vendosur normë negative të interesit në depozita si instrument i rregullimit të politikës monetare. Ndërsa, më datë 10 shtator norma negative në depozita u thellua edhe më tej nga -0.10% në -0.20% si dhe norma kryesore e rifinancimit në 0.05%. Kjo ndikoi drejtpërsëdrejti në zvogëlimin e normave të interesit në tregun ndërbankar të Eurozonës dhe rritjen e çmimeve të obligacioneve të denominuara në euro.

Figura 77 paraqet lëvizjen e kthimeve nga investimet në portfolion e BQK-së në raport me tregun ndër-bankar të Eurozonës, respektivisht norma EURIBOR 1-mujore (Norma Mesatare e Huadhënies ndër-bankare për valutën Euro) e cila konsiderohet normë referuese për depozitat e afatizuara të BQK-së në bankat qendrore dhe komerciale të shteteve të Eurozonës. Pika referuese përcaktohet kundrejt të dhënave nga horizonti kohor mesatar i portfolios investuese (33 ditë).

Figura 78 paraqet kthimin më të favorshëm të realizuar në investimet në letrat me vlerë krahasuar me depozitat bankare, e cila vërehet për dy periudhat gjashtëmujore të vitit 2014. Normat e kthimit të portfolios në gjashtëmujorin e dytë janë prekur direkt nga ndërhyrja e BQE-së më 11 qershor 2014, me ç'rast në mënyrë të dukshme janë zvogëluar normat kryesore të interesit.

Investimet në letra me vlerë siç pasqyrohen në Figurën 79 vendosen në periudha më të gjata krahasuar me investimet në depozita bankare. Pavarësisht këtij fakti, mesatarja e ditëve deri në maturim për letrat me vlerë mbetet e ulët, në më pak se tre muaj. Kjo nënkupton që i është kushtuar rëndësi e veçantë edhe likuiditetit që është nga objektivat primare të Politikës së Investimeve të BQK-së.

Figura 78. Norma e kthimit të investimeve në portfolio dhe rreziku për dy periudhat gjashtëmujore të vitit 2012





Figura 79. Horizonti kohor mesatar i shprehur në ditë deri në maturim për dy kategoritë e plasmaneve




5.4.2 Menaxhimi i Rrezikut

Investimi i mjeteve bëhet në letrat me vlerë të emetuara nga shtetet më kredibile të Eurozonës dhe në institucionet bankare me vlerësim kreditor superior sipas vlerësimeve nga Agjencitë Kreditorë Ndërkombëtare si Standard & Poor's dhe Moody's.

Rreziqet financiare të cilat menaxhohen gjatë investimit të mjeteve financiare nga ana e BQK-së janë: rreziku kreditor, rreziku i normës së interesit, rreziku likuiditetit dhe rreziku operacional.

- **Rreziku kreditor** - Portfolio e investimeve është shpërndarë në mënyrë që të mbahet rreziku kreditor në nivel të ulët. Të gjitha investimet janë realizuar në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve P-2/A-2 (Moody's/S&P) dhe përmes shpërndarjes të investimeve që është përcaktuar sipas limiteve të shprehura në përqindje për shtete dhe institucione bankare.


Figura nr. 80. Struktura e Letrave me Vlerë sipas afatit të maturimit



Burimi: BQK (2015)

- **Rreziku i normës së interesit** - është matur duke krahasuar normën e kthimit nga investimet në portfolion e BQK-së me normën EURIBOR 1 mujor (norma mesatare e huadhënies ndërbankare për valutën Euro) si normë krahasuese. Devijimi standard nga norma e interesit për vitin 2014 është 0.07% që nënkupton se norma mesatare e interesit varion për +/-0.07% që konsiderohet si rrezik minimal.

Figura 81. Struktura e pjesëmarrësve në ankande



Burimi: BQK (2015)

- **Rreziku i likuiditetit** - investimet janë bërë në përputhje me horizontin kohor të përcaktuar me Politikën e Investimeve. Instrumentet në të cilat është investuar janë kryesisht instrumente me afat të shkurtër si depozita bankare, bono thesari dhe obligacione shtetërore.
- **Rreziku operacional** - ky rrezik ekziston në të gjitha aktivitetet dhe për të minimizuar rrezikun operacional, investimet janë realizuar me saktësi duke ju nënshtruar kontrollit efikas për çdo transaksion.

5.4.3 Letrat me vlerë të Qeverisë

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për Borxhet Publike Nr. 03/L-175, Neni 2, paragrafi 1.1. dhe 1.2. vepron si agjent fiskal për Ministrinë e Financave (MeF)

Sipas Kalendarit të Emetimeve të Letrave me Vlerë të Qeverisë, në vitin 2014 janë mbajtur 21 ankande përmes platformës elektronike: 4 ankande për bono thesari me afat maturim 91 ditë, 7 ankande për bono thesari me afat maturimi 182 ditë, 6 ankande për bono thesari me afat maturimi 364 ditë dhe 4 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi dy vite.

Në figurën 80 paraqitet struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë e shprehur në përqindje sipas afatit të maturimit.

Pjesëmarrës në tregun e Letrave me Vlerë të Qeverisë kanë qenë të gjithë Akterët Primar, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës si Pjesëmarrës Primar dhe pjesëmarrësit tjerë përmes Akterëve Primar ku pjesëmarrja e tyre në përqindje është paraqitur në figurën 81.


Në vitin 2014 u emetuan për herë të parë obligacionet qeveritare me afat maturimi prej dy vite. Krahasuar me vitin paraprak, norma mesatare vjetore e kthimit për bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë në vitin 2014 ka shënuar rënie nga 0.57 në 0.56 %. Për bonot e thesarit me afat maturimi 182 ditë është shënuar rritje nga 1.27 në 1.34 %. Për bonot e thesarit me afat maturimi 364 ditë është shënuar rënie nga 1.99 në 1.72 %. Norma mesatare e kthimit për obligacionet qeveritare për vitin 2014 ishte 2.76%. Norma mesatare vjetore e kthimit për të gjitha bonot e thesarit në vitin 2014 ka qenë më e lartë prej 1.29% krahasuar me 1.01 % sa ishte në vitin 2013 (figura 82).

Në figurën 83 janë paraqitur të gjitha ankandet ku shihet se kërkesa më e lartë ishte për bono thesari njëvjeçare dhe për obligacione qeveritare dy vjeçare. Gjatë vitit 2014 është funksionalizuar zhvillimi i tregut sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës


Regjistri i kredive paraqet një shtyllë të rëndësishme të infrastrukturës financiare në segmentin e raportimeve kreditore.

Figura 82. Normat mesatare vjetore të kthimit sipas afatit të maturimit për vitin 2013 dhe vitin 2014




Burimi: BQK(2015)

Figura 83. Ankandet e bonove të thesarit dhe obligacioneve qeveritare në vitin 2014



Burimi: BQK (2015)

Figura 84. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2015)

Që nga janari 2006, BQK-ja ka në menaxhim të saj sistemin e Regjistrimit të Kredive (RKK), i cili funksionon si një aplikacion i bazuar në internet, në kohë reale dhe ka për qëllim mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave kreditore të personave fizik dhe juridik. Qëllimi kryesor është që përmes shpërndarjes së informatave mbi historikun e kredive si dhe atyre aktuale të ndikohet në përmirësimin dhe avansimin e procesit vlerësues për klientët kreditorë si dhe të përkrahet funksioni mbikëqyrës i Bankës Qendrore.

Nga një perspektivë e përgjithshme ekonomike, Regjistri i Kredive lehtëson kredidhënien sa i përket vëllimit dhe kostove si dhe kontribuon në stabilitetin financiar në përgjithësi duke ndihmuar kredidhënësit për një vendimmarrje të drejtë, brenda një kohe më të shkurtër në mënyrë më të saktë dhe më objektive.

Në bazë të rregullores së Regjistrimit të Kredive, anëtar në sistemin e RKK-së janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga Banka Qendrore për të qenë ofrues të kredive: të gjitha bankat dhe institucionet mikro-financiare të licencuara si dhe ato institucione financiare jo-bankare dhe kompani të sigurimeve të licencuara për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore.


Aktualisht janë të regjistruar rreth 1200 përdorues aktiv të institucioneve kredidhënëse. Gjatë vitit 2014, Regjistri i Kredive ka regjistruar 314 përdorues duke u bazuar në kërkesat e paraqitura nga institucionet kredidhënëse.

Institucionet kredidhënëse qasen në sistemin e RKK-së me qëllim të hulumtimit mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditor ku sipas statistikave që dalin nga sistemi i RKK-së, numri i hulumtimeve gjatë vitit 2014 kap shifrën prej 639,100 hulumtime.

Një pasqyrë mbi këtë aktivitet, në baza vjetore, për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014 është paraqitur në figurën 84.


Të gjithë ofruesit e kredive janë të obliguar të raportojnë në Regjistrin e Kredive të gjitha aplikacionet për kredi dhe kreditë e lëshuara për klientët e tyre në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga Banka Qendrore.

Figura 85. Numri i kredive të reja




Burimi: BQK (2015)

Figura 86. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2015)

Figura 87. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve



Burimi: BQK (2015)

Gjatë vitit 2014, nga ana e institucioneve kredidhënëse, në sistemin e regjistrit të kredive janë raportuar 187,985 kredi të reja.

Raporti i numrit të kredive të reja për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014 është paraqitur në vijim përmes figurës 85.

Në figurën 86, 87, dhe 88 janë paraqitur ekspozimet kreditore në bazë të klasifikimeve të raportuara në sistemin e RKK-së për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014.


Subjekt i të dhënave në sistemin e RKK-së paraqitet çdo person fizik apo juridik që ndërrmer një obligim kredie. Me obligim kredie nënkuptohet çdo hua, kredit kartelë, garancion, lizing ose produkt tjetër me natyrë kreditore.

Subjektet e të dhënave përpos rolit si kredimarrës mund të paraqiten edhe në role tjera sikur bashkëkredimarrës, garantues, apo edhe si aksionar dhe drejtor të entitetit juridik të cilit i lëshohet obligimi kreditor.

Figura në vazhdim paraqet numrin e kërkesave për raportin individual kreditor të kredimarrësve (fizik/juridik) për vitet 2011, 2012, 2013, dhe vitin 2014.


Regjistri i Kredive ka kontribuar drejtpërdrejt në të dhënat e mbledhura nga Banka Botërore (BB) për qëllim të raportit Doing Business 2015.

Figura 88. Struktura e kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 89. Numri i i kërkesave për raporte kreditore



Burimi: BQK (2015)

Tabela 13. Rangimi i vendeve të rajonit bazuar ne indikatorin “Getting Credit”

Vendi	Rangimi
Mali i zi	4
Republika e Kosovës	23
Shqipëria	36
Maqedonia	36
Bosna dhe Hercegovina	36
Serbia	52
Kroacia	61
Slovenia	116

Burimi: BQK (2015)

Sipas raportit ‘Doing Business’, të publikuar nga Banka Botërore, fusha që i përket Regjistrit të Kredive “getting credit” për vitin 2014 është vlerësuar në pozitën e 23-të. Krahasuar me vitin e kaluar, ky indikator për vitin 2014 ka shënuar rritje për pesë pozita.

Me këtë vlerësim indikator “getting credit” përsëri vlerësohet si më pozitiv nga të gjithë indikatorët tjerë të raportit DB 2015 për Republikën e Kosovës. Ndërsa krahasuar me vendet e rajonit, indikator “getting credit” për Kosovën qëndron në pozitën e dytë pas Malit të Zi.

5.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar

Gjatë vitit 2014, BQK ka vazhduar të përpilojë publikimet periodike, përfshirë Raportin e Stabilitetit Financiar, Raportin e Zhvillimeve Makroekonomike, Vlerësimin Tremujor të Ekonomisë si dhe Raportin e Informatave Mujore të Sistemit Financiar.

Një ndër publikimet më të rëndësishme vazhdon të jetë Raporti i Stabilitetit Financiar, i cili pasqyron qëndrueshmërinë e sistemit financiar duke analizuar zhvillimet e përgjithshme ekonomike së bashku me zhvillimet në aktivitetin, performancën dhe qëndrueshmërinë e të gjithë komponentëve të sistemit financiar të vendit. Raporti i Stabilitetit Financiar, i cili në të kaluarën është publikuar një herë në vit, që nga viti 2014 ka filluar të publikohet dy herë brenda vitit.

Rritja e frekuencës së publikimit është bërë edhe te Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike, i cili paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse rreth zhvillimeve makroekonomike në vend. Ky raport, që nga viti 2014, ka filluar të publikohet dy herë në vit. Gjatë vitit 2014, ky raport është pasuruar edhe me pjesën e projeksioneve makroekonomike, gjë e cila reflekton suksesin e arritur në ndërtimin e modelit për parashikimet makroekonomike. Për t'i siguruar publikut çasje sa më të shpejtë në informacionet rreth zhvillimeve në ekonominë e vendit, BQK ka vazhduar të publikojë në baza të rregullta Vlerësimin Tremujor të Ekonomisë. Për më tepër, në vitin 2014 ka filluar edhe publikimi i Raportit të Informatave Mujore të Sektorit Financiar, i cili paraqet një përmbledhje të indikatorëve kyç për të gjithë komponentët e sektorit financiar të Kosovës dhe publikohet çdo muaj.

BQK ka vazhduar të realizojë Anketën e Kreditimit Bankar me bankat komerciale duke mbledhur kështu informacion të rëndësishëm për faktorët me ndikim në aktivitetin kredidhënës të bankave në Kosovë si dhe pritjeve për aktivitetin kredidhënës në periudhën e ardhëshme. Informacionet nga kjo anketë, e cila realizohet dy herë në vit, përveç që kanë ndihmuar kuptimin më të mirë të zhvillimeve në sektorin bankar, shërbejnë edhe si input i rëndësishëm për parashikimin e rritjes ekonomike dhe të agregatëve tjerë makroekonomik.

Gjatë këtij viti, është arritur për herë të parë të përpilohet Raporti i Mbingarkueshmërisë me Borxh i cili pritet të publikohet së shpejti. Ky raport bazohet në të dhënat e regjistrimit të kredive si dhe në të dhëna shtesë të kërkuara nga bankat dhe pasqyron në hollësi faktorët me ndikim në cilësinë e kredive si dhe vlerëson nivelin e ngarkueshmërisë me borxh të klientëve kreditor. Ky raport do të shërbejë si burim i rëndësishëm informacioni për BQK-në në procesin e vlerësimit të stabilitetit financiar dhe poashtu do t'i shërbejë edhe bankave në procesin e hartimit të politikave të tyre. Raporti, përveç analizës, do të nxjerrë edhe një numër të rekomandimeve që kanë për synim adresimin e dobësive të identifikuara në raport.

Progres i rëndësishëm është shënuar edhe drejtë formulimit të politikës makroprudenciale, në kuadër të projektit me BQE-në, ku kemi arritur ti vendosim konturat kryesore të kësaj politike. Aktivitet i rëndësishëm është shënuar edhe në përpilimin e rregullores për Mbështetje Emergjente me Likuiditet dhe metodologjisë për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondeve në këtë skemë.

5.7. Aktivitetet në fushën e statistikave

Funksioni statistikor i BQK-së është avancuar me implementim të metodologjisë së re ndërkombëtare për statistikën e sektorit të jashtëm, harmonizimin e mëtejshëm të statistikave

sipas *acquis comunitare*, rritjen e mbulueshmërisë, zgjerimin e gamës me statistika të reja, diseminimin e të dhënave në Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankë Botërore (BB), Eurostat si dhe me avancim të mëtejshëm të sistemit të përpunimit të të dhënave.

Në aspektin e metodologjisë, statistikat e bilancit të pagesave (BP) dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN) në shtator 2014 u publikuan sipas metodologjisë së re të rekomanduar me manualin e ri “*Manuali mbi Bilancin e Pagesave dhe Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare (BPM6), botimi i gjashtë*”, i FMN-së. Implementimi i *BPM6* është bërë në të njëjtën kohë me vendet e Bashkimit Evropian. BQK paraprakisht ka publikuar informata dhe shpjegime të nevojshme lidhur me kalimin nga versioni *BPM5* në *BPM6*. Janë krijuar tri nënmeny të reja në kuadër të menysë “Statistikat” për qëllime të informimit rreth ndryshimeve që ka sjellë implementimi i metodologjisë së re statistikore. Gjithashtu, janë konvertuar të dhënat për vitet paraprake sipas formatit *BPM6*.

Progres i rëndësishëm është bërë edhe në harmonizimin e metodologjisë të statistikave të sektorit të jashtëm (SSJ) me kërkesat e Eurostatit (*acquis comunitar*). Për dallim nga kërkesat raportuese që rekomandon FMN, nga Eurostatit kërkohet nën-ndarje me e madhe sipas instrumenteve financiare dhe sipas shteteve/regjioneve. Një mision i Eurostatit ka vizituar BQK-në në Maj 2014 për të rishikuar nivelin e përmbushjes së kriterëve të kërkuara me *acquis comunitar* nga BQK në prodhimin e statistikave të sektorit me jashtë, me fokus në statistikat e tregtisë ndërkombëtare në shërbime. Misioni ka vlerësuar lartë progresin e bërë nga BQK në këtë fushë. Përveç kësaj, misioni ka ndihmuar BQK-në në përgatitjen e një plani për avancim të mëtejshëm të SSJ në përpjekje për harmonizim të plotë me statistikat e vendeve të BE-së. Në këtë kontekst, BQK ka bërë implementimin e disa detyrave të parapara me këtë plan, përfshirë draftimin e “Metodikës së përpilimit të statistikave të BP dhe PIN”, kodimin e të dhënave në databazat aktuale për të mundësuar gjenerimin e të dhënave për raportim në Eurostat, etj. Njëherit, BQK ka dizajnuar një pilot-projekt që ka si objekt harmonizimin e statistikave në shërbime ndërkombëtare sipas *vademecum* dhe ka kërkuar mbështetje financiare në kuadër të programit “IPA 2012 Multi-Beneficiary Programme on Statistical Cooperation”. Kërkesa është aprovuar në parim nga GOPA dhe pritet të nënshkruhet në fillim të vitit të ardhshëm. Realizimi i këtij projekti do t’i ndihmojë BQK-së në harmonizimin më të shpejtë të statistikave sipas standardeve evropiane si dhe shpërndarjen e të dhënave në Eurostat. BQK për vitin 2015 ka prioritet të lartë fillimin e raportimit të rregullt në Eurostat dhe Bankën Qendrore Evropiane sipas standardeve që vendet e BE-së aplikojnë.

Në përpjekje për të përmirësuar kualitetin e statistikave, BQK ka zgjeruar listën e mbulueshmërisë duke futur në raportim korporatat jofinanciare të reja. Kryesisht janë ftuar për raportim korporata me pronësi të huaj, të dhënat e të cilave janë të nevojshme për përpilimin e statistikave të investimeve të huaja direkte në Kosovë dhe borxhit të jashtëm. Gjithashtu, është bërë përmirësim i theksuar në shkurtimin e kohës së publikimit nga (t +35 ditë) në (t + 30 ditë) dhe në rritjen e periodicitetit nga tremujore në mujore. Gjatë vitit 2014, statistikat e bilancit të pagesave janë përpiluar në bazë eksperimentale në periodicitetin mujor. Publikimi në bazë mujore do të bëhet që nga muaji mars 2015, me të dhëna për vitin 2014 dhe muajin janar 2015. Njëherit do të përmirësohet edhe afati i publikimit nga t+90 ditë në t+60 ditë.

Me rritjen e kërkesës për informata të reja, BQK ka zgjeruar gamën e produkteve statistikore duke prodhuar më shumë informata për normat e interesit, investimet e huaja direkte, bilancin tregtar dhe për statistikat e borxhit të jashtëm. Statistika të reja janë përpiluar për: normat e interesit në kredi dhe depozita sipas afateve, institucioneve financiare, sektorëve të ekonomisë; importet e mallrave, sipas klasifikimit mallra për konsum, mallra të ndërmjetme dhe mallra kapitale; statistikat për borxhin e jashtëm që ofrojnë informata shtesë sipas sektorit të

huadhënësve. Këto statistika janë në përputhshmëri të plotë me standardet statistikore ndërkombëtare dhe gjatë vitit të ardhshëm do zgjerohet gama e publikimeve.

Gjatë vitit 2014, BQK-së ka bërë një avancim në sistemin e procesimit të të dhënave. Sistemi i ri ofron mundësi më të mëdha për nxjerrje të informatave në mënyrë më të shpejtë dhe më të detajizuar. BQK është në proces të zhvillimit të një softueri të ri, i cili do të përdoret nga DS dhe departamentet tjera të BQK-së për procesimin dhe analizimin më efikas të serive statistikore. Softueri i ri do të mundësojë importimin, procesimin, ruajtjen dhe nxjerrjen e statistikave në mënyrë më efektive. Meqë softueri do të përdoret nga më shumë departamente, do të rritet mundësia për të kontrolluar konsistencën në të dhëna.

Bashkëpunimi me FMN-në, Eurostatin dhe institucionet vendore ka vazhduar. Të dhëna të rregullta periodike janë dërguar në FMN për qëllime publikimi. Në kuadër të bashkëpunimit me Eurostatin dhe Bankën Qendrore Europiane (BQE), BQK ka marrë pjesë në takimet e rregullta në *Komitetin për Statistikat Monetare, Financiare dhe Statistikat e Bilancit të Pagesave* të organizuara nga Eurostatin dhe BQE. Për më tepër, BQK ka bashkëpunuar edhe me bankat qendrore të vendeve të rajonit, organizatat tjera ndërkombëtare dhe institucione të tjera relevante në fushën e statistikave. Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, BQK është anëtare e Këshillit Statistikor të Kosovës, i cili është organ kolegjal për të dhënë këshilla për përgatitjen dhe zbatimin e programit të statistikave zyrtare si dhe për zhvillimin e përgjithshëm të sistemit statistikor të Republikës së Kosovës. BQK është koordinatore e vendit për Sistemin e Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme (angl. General Data Dissemination System - GDDS) të FMN-së. Të dhënat për indikatorët kryesor të Kosovës janë publikuar sipas afateve të parapara (muajore, tremujore, dhe vjetore) në kuadër të faqes së BQK-së.

6. Zhvillimet e Brendshme

6.1. Auditimi i Brendshëm

Duke marrë parasysh dinamikën e zhvillimit evolutiv të fushës së auditimit dhe nevojën për zhvillimin e mëtutjeshëm, Auditimi i Brendshëm (AB) i është qasur një procesi të ri të ndryshimit. Është rishikuar i gjithë procesi i deritashëm më qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve të Funkzionit të AB-së.

Kanë vazhduar përpjekjet për të përmirësuar më tutje metodologjinë e raportimit më qëllim të rritjes së efikasitetit. Fokusi i orientuar ishte në drejtim të ndjekjes së praktikave dhe metodologjisë që kanë Funkzionet e AB-së në institucionet e vendeve të tjera për të zhvilluar një proces të raportimit më të lehtë, cilësor dhe sa më në kohë.

Gjatë këtij viti është rishikuar dhe kompletuar Korniza ligjore e AB-së. Në kuadër të kësaj janë përgatitur Statuti i AB-së dhe Kodi i Etikës për auditorët e brendshëm dhe të njëjtat janë aprovuar nga Bordi i BQK-së. Janë përcaktuar objektivat strategjike të AB-së, të cilat me pas janë integruar në Strategjinë gjithëpërfshirëse të BQK-së. Është përgatitur Udhëzuesi për Sigurimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Auditimit.

Planit Vjetor të Auditimit i ka paraprirë përgatitja e Universit të Auditimit për periudhën trevjeçare 2014-2016. Universi paraqet gjithë përfshirjen e aktiviteteve të auditimit, Departamentet/Divizionet dhe fushat që auditohen brenda periudhës trevjeçare. Në Plan janë përfshirë proceset të cilat mund të ekspozojnë rrezikshmëri dhe prioritet më të lartë, në veçanti që ndërlidhen me ruajtjen e pasurisë dhe reputacionit të BQK-së.

Auditimet e kryera gjatë vitit kanë mbuluar funksionimin e kontrolleve të brendshme, menaxhimin financiar, proceset administrative dhe sigurinë e sistemeve mbështetëse të Teknologjisë Informative.

Përveç auditimeve të planifikuara, AB ka kryer edhe auditime rasti (ad hoc) me kërkesë të Menaxhmentit të Lartë. Në vazhden e përcjelljes së Portofolios së Investimeve në Bankat Korrespondente të BQK-së, AB gjatë vitit 2014 ka përgatitur 47 raporte speciale në baza javore.

Janë kryer 4 auditime të pavarura të rekonsilimit të llogarive të Qeverisë dhe janë përgatitur raporte tremujore të cilat janë dërguar në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Është avancuar përdorimi i veglave softuerike me qëllim që proceset të auditohen në mënyrë më efektive dhe më efikase.

Gjatë vitit 2014, Funkzioni i AB-së i është nënshtruar dy proceseve të vlerësimit të jashtëm, njëri nga Banka Botërore (raport jo zyrtar) si rezultat i kërkesave të Menaxhmentit për të përmbushur kërkesat e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të auditimit të brendshëm. Vlerësimi tjetër është bërë nga Banka Qendrore Evropiane në kuadër të projektit të analizës së nevojave për plotësimin e parakushteve për anëtarësim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Në kuadër të veprimeve për themelimin e programit për sigurim dhe përmirësim të cilësisë, Shefi i AB-së ka nxjerrë Udhëzuesin për Sigurimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Auditimit, i cili ka filluar të aplikohet për të gjithë auditorët e brendshëm nga Janari 2015.

Stafi i AB-së edhe gjatë vitit 2014 ka vazhduar implementimin e standardit për zhvillim të vazhdueshëm profesional. Këtij qëllimi i ka kontribuar pjesëmarrja në disa ngjarje të rëndësishme të kësaj fushe, siç janë: vizita zyrtare, forume, konferenca dhe seminare të ndryshme.


6.2. Burimet njerëzore

Në fund të vitit 2014, numri i të punësuarve në BQK ka qenë 200 të punësuar. Nga gjithsej numri i të punësuarëve, 96 veta ose 48% janë femra dhe 104 vetë ose 52% janë meshkuj.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vlerëson personelin si një ndër resurset me rëndësi të veçantë dhe vazhdimisht angazhohet për mbështetjen e tyre që t'u sigurojë njohuri të duhura, aftësi dhe ekspertizë adekuate për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive sipas standardeve më

të larta për arritjen e potencialit të plotë të tyre përmes kurseve, seminareve, edukimeve, etj.

Figura 90. Struktura sipas edukimit



6.3. Aktiviteti ligjor

Konform kornizës ligjore në fuqi, aktiviteti ligjor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2014, është fokusuar në implementimin dhe avancimin e kornizës ligjore ekzistuese, duke aprovuar ndryshimin e rregulloreve ekzistuese si dhe duke nxjerr një varg rregulloresh të reja, gjithmonë në pajtim me ligjet në fuqi, legjisacionin e BE-së dhe në përshtatje me dinamikën e zhvillimeve më të reja në sektorin financiar.

Në funksion të avancimit të kornizës ligjore në fuqi, gjatë këtij viti, organet vendimmarrëse të BQK-së kanë miratuar një numër të akteve nënligjore të cilat paraprakisht janë shqyrtuar dhe konfirmuar në aspektin juridik para procedimit për miratim.

Në pajtim me autorizimet dhe objektivat ligjore, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në vazhdimësi do të fokusohet në mbarëvajtjen e një kornize ligjore e rregullative në harmoni me legjisacionin në fuqi, legjisacionin e BE-së, standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, e të gjitha këto në drejtim të zhvillimit të mëtutjeshëm të sistemit financiar.

6.4. Teknologjia Informative

Gjatë vitit 2014, BQK ka përfunduar krijimin e qendrës moderne për vazhdimësi të punës, duke rritur kështu besueshmërinë e sistemeve të informacionit me sinkronizim në kohë reale në mes dy qendrave, asaj kryesore dhe të vazhdimësisë së punës. Ky projekt nënkupton konfigurimin e të gjitha sistemeve harduerike sipas standardeve të fundit për teknologji dhe vazhdimësi të punës. Po ashtu gjatë vitit, Departamenti i Teknologjisë Informative ka rishikuar dhe plotësuar një numër aktesh të rregullativës së brendshme në fushën e teknologjisë së informacionit.

6.5. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut

Në pajtim me objektivat ligjore, detyrat dhe orientimet strategjike për avancimin e funksioneve të brendshme, BQK ka themeluar funksionin e Menaxhimit të Rrezikut.

Ky funksion është profilizuar të identifikojë kategoritë e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet BQK, të zhvillojë kornizën e menaxhimit të rreziqeve, politikatat, procedurat, udhëzimet, indikatorët dhe metodologjitë e identifikimit, matjes, vlerësimit, trajtimit dhe monitorimit të rreziqeve. Menaxhimi i Rrezikut është përcaktuar si funksion i parashikimit të ngjarjeve të

pafavorshme dhe pasigurive që kanosin pasuritë, të ardhurat, reputacionin dhe vazhdimësinë e punës. Rangu i aktiviteteve për menaxhimin e rreziqeve është hartuar të sigurojë pajtueshmëri me kuadrin ligjor, rritjen e efikasitetit të operacioneve dhe lehtësimin e arritjes së objektivave të përcaktuar me ligj.

Angazhimi për periudhën raportuese në kuadër të funksionit të Menaxhimit të Rrezikut është artikuluar kryesisht drejt rritjes së ndërgjegjësimit të njësive organizative për atë që ky funksion nuk është aktivitet i veçuar, i ndarë nga aktivitetet kryesore dhe proceset institucionale, por është pjesë integrale e të gjitha proceseve organizative, i shtrirë nga planifikimi strategjik drejt planeve dhe aktiviteteve operative. Kjo fazë është karakterizuar me promovimin e një qasjeje integrale që secili departament dhe njësi organizative të pozicionohet si pjesë e pandashme e aktiviteteve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut.

Në këtë kronologji angazhimi, është shqyrtuar përshtatshmëria e kuadrit ligjor aplikativ, praktikave dhe metodologjive të zbatuara në Menaxhimin e Rrezikut. Janë vlerësuar politikat dhe rregulloret ekzistuese, përshtatshmëria e kontroleve të brendshme, mjedisi i kontrollit, aktivitetet e kontrollit, procesi i vlerësimit të rreziqeve dhe sistemi i informimit të menaxhmentit.

Pas shqyrtimit të përshtatshmërisë së praktikave ekzistuese, zhvillimi i funksionit të Menaxhimit të Rrezikut është shtjelluar në planin strategjik të BQK-së duke paraparë plotësimin e gjithë kuadrit të nevojshëm rregullativ dhe metodologjik, si pasqyrim i zotimit të BQK-së për të vënë në epiqendër të aktiviteteve të saj Menaxhimin efektiv të Rrezikut drejt realizimit të objektivave. Në rrafshin operacional është hartuar për aprovim Politika për Menaxhimin e Rrezikut duke përcaktuar parimet dhe udhëzimet e nevojshme për Menaxhimin e Rrezikut. Kjo politikë vë themelet për zhvillimin dhe avancimin e mëtejme të kuadrit rregullativ dhe shërben si platformë e përgjithshme në fushën e menaxhimit të rrezikut brenda parimeve të së cilës duhet të konvergjojnë praktikat e të gjitha njësive organizative në fushën e Menaxhimit të Rrezikut.

Perspektiva e funksionit të Menaxhimit të Rrezikut është e orientuar drejt sendërtimit të një platforme bashkëpunimi të përafërt dhe bashkërendimit të aktiviteteve të kontrollit me Auditimin e Brendshëm si dhe komunikimit reciprok mes njësive organizative dhe funksionit të Menaxhimit të Rrezikut.

7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

7.1. Marrëveshjet, promovimi dhe përfaqësimi ndërkombëtar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet e rëndësishme financiare ndërkombëtare, duke përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Bankën Qendrore Evropiane, si dhe me bankat homologe dhe me institucionet e tjera relevante të vendeve të rajonit me të cilat BQK-ja ka marrëveshje bashkëpunimi.

Gjatë vitit 2014, Banka Qendrore është përfaqësuar në ngjarjet relevante që janë zhvilluar në sferën ndërkombëtare, duke përfshirë takimet vjetore në sesionin pranveror dhe atë vjeshtor të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore.

Sa i përket aktiviteteve dhe ngjarjeve më të rëndësishme të zhvilluara gjatë vitit 2014, duhet të përmendim këtu pjesëmarrjen e BQK-së në Programin e bashkëpunimit teknik të BQE-së me bankat qendrore të regjionit të Ballkanit Perëndimor, i cili ka për qëllim përgatitjen e bankave qendrore të vendeve të regjionit për inkuadrim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Guvernatori i BQK-së ishte anëtar i Komitetit Drejtues të këtij programi dhe ka marrë pjesë në tri takimet e zhvilluara në Tiranë, 17 prill 2014, Frankfurt, 29 shtator 2014, dhe Prishtinë, 27 mars 2015. Guvernatori i BQK-së i ka kryesuar dy takimet e fundit dhe me rastin e takimit të zhvilluar në Frankfurt është takuar edhe me anëtar të lartë të personelit dhe Bordit Ekzekutiv të BQE-së.

BQK-ja ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Bankën Qendrore të Malit të Zi. Përmbajtja e kësaj ka të bëjë me çështjet bilaterale lidhur shkëmbimin e informacionit, licencimin dhe mbikëqyrjen bankare, fuqizimin e luftës kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, menaxhimin në situata të krizave dhe aranzhime të tjera teknike. Kjo është marrëveshja e parë e bashkëpunimit mes Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Bankës Qendrore të Malit të Zi. Kjo marrëveshje u arrit gjatë kohës së mbajtjes së Samitit të Ministrave të Financave dhe Guvernatorëve të Bankave Qendrore të vendeve të regjionit, i cili u mbajt në Mal të Zi nga 12 deri më 14 qershor 2014. Tema e këtij samiti ishte “E Ardhmja Financiare e Regjionit”.

Një ngjarje e rëndësishme në fushën e marrëdhënieve me jashtë është edhe fillimi i programit të edukimit financiar dhe shënimi i Javës Ndërkombëtare të Parasë, me ç’rast BQK-ja i është bashkuar institucioneve anekënd globit që shënojnë këtë ngjarje të rëndësishme. Në kuadër të kësaj ngjarjeje, BQK-ja ka ndarë çmime për punimet më të mira të nxënësve, të cilët kanë shfaqur krijimet e tyre në temën “Si të kursejmë”. Në vitin 2014, BQK-ja ka vazhduar me ndarjen e çmimeve për studentë për punimet më të mira të dorëzuara në konkursin e hapur “Ekonomistët e rinj”.

Gjatë vitit 2014, në bashkëpunim me Universitetin e Lubjanës, Fakultetin Ekonomik, u organizua konferenca e përbashkët ndërkombëtare me temën “Perspektiva Ekonomike e Evropës Juglindore në periudhën pas krizës”. Kjo konferencë pati për fokus diskutimi trendët aktualë dhe perspektivat afatmesme ekonomike të vendeve të Evropës Juglindore, duke u fokusuar në pengesat e rritjes së tyre ekonomike dhe modifikimet në modelin e zhvillimit ekonomik në periudhën pas krizës.

Në fund të vitit 2014, me rastin e 15-vjetorit të themelimit të saj, BQK organizoi një konferencë solemne, në të cilën morën pjesë përfaqësues të institucioneve të larta vendore dhe udhëheqësit e institucioneve financiare të vendit. Po ashtu, konferencën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe përfaqësues të qeverive të huaja dhe institucioneve ndërkombëtare të akredituara në

Republikën e Kosovës. Në këtë konferencë jubilarë, Guvernatori prezantoi zhvillimet kyçe të BQK-së gjatë periudhës 15-vjeçare dhe njoftoi pjesëmarrësit në lidhje me gjendjen dhe ecuritë e fundit në sistemin financiar në Kosovë, duke nënvizuar qëndrueshmërinë dhe performancën pozitive të shënuar gjatë viteve të fundit. Po ashtu aty u theksuan përpjekjet e BQK-së për të adoptuar standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në funksion të avancimit të përgjithshëm institucional dhe aderimit të ardhshëm në SEBQ.

7.2. Asistenca teknike

Gjatë vitit 2014, BQK-ja ka vazhduar të jetë e përkrahur nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët ndërkombëtar si me projektet ekzistuese, ashtu edhe me iniciativat e reja, kryesisht të ofruara nga Thesari Amerikan, USAID, Fondi Zhvillimor Gjerman, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe Banka Qendrore Evropiane. Këto institucione kanë përkrahur me ekspertizën e tyre ngritjen e kapaciteteve të brendshme të BQK-së në mbikëqyrjen e institucioneve financiare, avancimin e kornizës ligjore për mbikëqyrje efektive të institucioneve financiare, fuqizim të funksioneve të reja në BQK, institucionalizim të praktikave ndërkombëtare dhe ngritje të kapaciteteve njerëzore për implementim të duhur të kornizës ligjore. Përkrahja e këtyre institucioneve është realizuar në projektet e veçanta ashtu siç është reflektuar në fusha të ndryshme të funksioneve të BQK-së.

Gjithashtu, BQK është mbështetur nga Thesari Amerikan në politikat e përgjithshme zhvillimore dhe në projekte të veçanta. Gjatë vitit 2014, mbështetja e Thesarit Amerikan ka ndikuar në zhvillimin e Projektit për Financimin e Banimit, që ka për qëllim adaptimin e rregullave të shëndosha të kreditimit të mbuluar me pasuri të paluajtshme, të njohur si kreditë hipotekare. Mbikëqyrja bankare dhe Mbikëqyrja e sigurimeve kanë përfutur nga ekspertiza e këshilltareve të Thesarit Amerikan duke ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të brendshme për mbikëqyrje efektive të sistemit financiar. Vlen të theksohet këtu edhe përkrahja e vazhdueshme e për avancimin e kornizës ligjore dhe operacionale në fushën e parandalimit të shpëlarjes së parave për rolin të cilin BQK-ja është e mandatuar me ligj.

BQK është mbështetur nga ekipi i projektit të USAID për Zbatimin e Kontratave Ligjore (Anglisht: Contract Law Enforcement), përgatitjen e legjislacionit sekondar për zbatimin e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve sa i përket pjesëve të cilat rregullojnë shërbimet financiare.

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vazhduar të mbështesë BQK-ne në fushën e mbikëqyrjes bankare, konkretisht përgatitjen e kornizës adekuate për implementimin e mbikëqyrja bankare të bazuar në rrezik. Gjithashtu, ka mbështetur funksionin e stabilitetit financiar dhe analizave ekonomike me pasurimin e projeksioneve ekonomike dhe ndërtim të modelit për parashikime makroekonomike.

Banka Botërore ka vazhduar përkrahjen e sajë përmes ekipit të ekspertëve të angazhuar për fuqizimin dhe avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe kornizës institucionale për mbrojtjen e konsumatorit të shërbimeve financiare dhe për ngritjen e nivelit të njohurive financiare të konsumatorëve në Kosovë. Gjithashtu edhe Projekti Fuqizimi i Sektorit Financiar dhe Infrastrukturës së Tregut financiar nga kredia e dakorduar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), që është pjesë e Bankës Botërore, vazhdon të implementohet me dinamikën e planifikuar. Ky projekt fokus të veçantë ka: (i) Financimin e kostos që ndërlidhet me implementimin e Strategjisë së BQK-së për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Pagesave dhe krijimin e Sistemit për Barazim të Pagesave në Kohë Reale bazuar në Strategjinë e Sistemit Kombëtar të Pagesave, (ii) Ndërtimin e Qendrës për Vazhdimësinë e Funksionimit për BQK-në me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së punës kur ndodhin rastet e katastrofave (nga faktorë të pakontrollueshëm) me qëllim të rimëkëmbjes së operacioneve të teknologjisë informative, që siguron të dhënat e azhuruara nga të gjitha

sistemet kritike të BQK-së, si dhe (iii) Sigurimin e financimit të kapitalit fillestar për Fondin për Sigurim të Depozitave të Kosovës (FSDK).

